



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 170/22

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 18. 07. 2022

VUÇITRN - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 45.1 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

### J u f t o n

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **28 korrik 2022 (e enjte) me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:


### **R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 qershor 2022;
2. Shqyrtim i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar - qershor 2022;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-statutit të Komunës së Vushtrrisë;
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021;
5. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar – qershor 2022;
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për themelimin e komisionit për përzgjedhjen e këshillave lokale;
8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirim të ekonomive familjare nga pagesa e kycjes në rrjetin e ujësjellësit;
9. Shqyrtimi i Propozim – vendimi për transferin e mjeteve financiare të komunës;
10. Shqyrtimi i kërkesës së Pranvera Hysenit për përkrahje financiare;
11. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.81/21 i datës 16.04.2021, për dhënin në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh;
12. Shqyrtim i planit për vlerësimin e rrezikut në territorin e Komunës së Vushtrrisë;
13. Të ndryshme.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN

<b>PËR/ZA/TO:</b>	<b>Kuvendin e komunës</b>
<b>NGA/OD/FROM:</b>	<b>Melihate Basholli Latifi</b> <i>Melihate Basholli</i> <b>Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë</b>
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	<b>Sekretarisë së kuvendit</b>
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 15.7.2022</b>

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 54, paragrafit 5 të Statutit të Komunës dhe nenit 5, paragrafit 1, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 15 korrik 2022 ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
2. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar – qershor 2021.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për themelimin e komisionit për përzgjedhjen e këshillave lokale.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirim të ekonomive familjare nga pagesa e kyçjes në rrjetin e ujësjellësit.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të përmirësohet për shkak të disa gabimeve teknike dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Shqyrtimi i kërkesës së Pranvera Hysenit për përkrahje financiare.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
7. Shqyrtimi i Planit për vlerësim të rrezikut për territorin e Komunës së Vushtrrisë.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
8. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar - qershor 2022.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për transferin e mjeteve financiare të komunës.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
10. Rishqyrtimi i vendimit nr. 81/21 i datës 16.4.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

*Me respekt!*



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL  
NGA MBLEDHJA E –V- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË  
VUSHTRISË, MBAJTUR MË 30 QERSHOR 2022**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:15. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:*

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Galip Avdiu, Gresa Muli, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Shkelzen Xhaferi, Sylejman Mehulli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

**Mungoi:** Gentiana Rama, Spasoje Stefanoviq, Nasuf Aliu dhe Faton Hyseni.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 31 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe i autorizuari i Kryetarit të komunës, z. Alban Tahiraj, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit** - lexoi para anëtarëve të kuvendit dispozitat e Rregullores të punës së kuvendit, lidhur me diskutimet, si dhe kërkoi që të respektohen këto dispozita ligjore ashtu që të jemi racional në kohë në mbledhjen e kuvendit. Njëkohësisht ajo paraqiti para kuvendit pikat e rendit të ditës që janë dërguar si materiale në pikën në të ndryshime, për t'i inkorporuar në punimet e mbledhjes.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** – pasi i përshëndeti të pranishmit, dhe duke ju referuar kryesueses së kuvendit e cila kërkon seriozitet në punë, vlerësoi se ajo do të duhej që vet të jetë serioze, pasi që në mbledhjen e fundit të KPF-së si rekomandim ka qenë edhe pika e rendit të ditës

që lidhet me Diskutimin për anulimin e konkurseve për emërimin e drejtorëve dhe zëvendës-drejtorëve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë. Ky rekomandim ishte aprovuar me shumicë votash në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe ka qenë obliguese që ekzekutivi të përgatitë materialin dhe kryesuesja e kuvendit ka pasur obligim që këtë pikë ta inkorporojë në rendin e ditës për këtë mbledhje të kuvendit. Mosrespektimi i vendimeve që dalin nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe mosprocedimi i tyre në kuvend, është një praktikë jo e mirë dhe jodemokratike dhe që nuk lë mënyrë dhe mjetë dhe formë pa shfrytëzuar për t'i ikur debatit dhe përgjegjësisë. Në këtë mbledhje nuk është prezent kryetari dhe nënkryetari i komunës, si dhe drejtoresha e arsimit, për më keq dhe më tepër sot nuk është respektuar një vendim i Komitetit për Politikë dhe Financa i cili është aprovuar me shumicë votash dhe për procedim në kuvend, për këtë ekzistojnë dëshmitë siç është video-incizimi i mbledhjes së KPF-së e për të cilën i bën ftesë MAPL-së që ato dëshmi t'i shqyrtojë dhe të konstatojë se çfarë shkeljesh po ndodhin në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë. Pastaj përsërit se kjo nuk është në rregull është jodemokratike, dhe për më tepër është antiligjore dhe e papranueshme, sepse nuk mund të shtypet debati nuk mund t'i ikni përgjegjësisë. Nëse keni kësi lloj qasjesh për arsim, atëherë ky është lajm i keq për mësimdhënësit, nxënësit, prindërit dhe për interesin qytetar në përgjithësi. Në fund tha se për grupin kuvendar të LVV-së kjo qasje është e papranueshme dhe se këtë çështje si grup kuvendar do ta iniciojnë edhe në instancat tjera për zbardhur deri në fund dhe për të parandaluar qasjen e shkeljeve flagrante që po ndodhin në fushën e arsimit në Komunën e Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit** – tha se askush nuk është duke i ikur debatit, porse fakti se kryetari i komunës dhe drejtoresha e arsimit ndodhen jashtë shtetit, është menduar dhe koordinuar që debati për arsimin dhe çështjet e konkurseve, të debatohen në ndonjërin nga mbledhjet e radhës kur të jetë prezent kryetari i komunës dhe drejtoresha e arsimit.

**Albanez Tahiraj, i autorizuari i Kryetarit të komunës** - pasi përshëndeti të pranishmit, sqaroi se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk ka pasur vendim, por ka qenë një rekomandim i cili nuk është inkorporuar fare në rendin e ditës. Për më tepër është propozuar si rekomandim që të futet në rend të ditës në mbledhjen e kuvendit, por procedurëlisht, rendi i ditës dërgohet sipas propozimit të kryesueses së kuvendit dhe kryetarit të komunës, por pika e njëjtë paraprakisht nuk është propozuar për t'u futur në rend të ditës, Kjo mund të sqarohet dhe dëshmohet nga incizimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe nga procesverbali.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** – njoftoi se nuk është e vërtetë që nuk është votuar në mbledhjen e KPF-së, për pikën-rekomandimin për debat për anulimin e konkurseve në arsim, dhe kjo mund të dëshmohet edhe nga përfaqësuesit e LDK-së që kanë qenë prezent në mbledhje, por edhe nga incizimi i mbledhjes dhe procesverbalit. Më tej ai kërkoi nga kryesuesja e kuvendit që mos t'i ndërpritet fjala gjatë diskutimit nga i autorizuari i kryetarit të komunës, për faktin se ai është në kuvend si rezultat i votës qytetare, për t'i mbrojtur interesat e përgjithshme, ndërsa i autorizuari i kryetarit të komunës nuk është aty nga votat e qytetarëve. Në fund kërkoi nga kryesuesja e kuvendit që të futet në rend të ditës pika rekomandimi i KPF-së për debat lidhur me anulimin e konkurseve në arsim.

**Ismet Gashi, udhëheqës i Zyrës ligjore**-sqaroi se sa i përket propozimit të përfaqësuesit të LVV-së lidhur me votimin në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, është gjithçka e qartë, është propozuar dhe aprovuar rekomandimi. Mirëpo duhet pasur parasysh se rendin e ditës për mbledhjet e kuvendit e propozon kryesuesja e kuvendit në bashkëpunim me kryetarin e komunës sipas dispozitave të Statutit të komunës, Ajo pikë është propozuar që të futet në rend të ditës, mirëpo nuk është obliguese që të jetë në rend të ditës, sepse kuvendi e ka themeluar Komitetin për Politikë dhe Financa dhe ky i fundit nuk mund ta detyrojë në veprim pasi që është trup i kuvendit.

Ndërsa e drejta e anëtarit të kuvendit për propozim për pikë të rendit të ditës është e patjetërsueshme edhe pa rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** – sqaroi se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, është votuar rekomandimi që të ketë debat lidhur me konkurset e anuluar në Drejtorinë e Arsimit, si pikë e rendit të ditës në këtë mbledhje të kuvendit. Këtë çështje ai e ka mbështetur dhe do ta mbështet çdo çështje që lidhet me interesin e përgjithshëm qytetar. Andaj si përfaqësues i LDK-së e mbështet propozimin që të diskutohet për çështjen e atyre konkurseve në cilëndo mbledhje të kuvend, me qëllim që të sqarohet çështje për të cilën pretendohet se ka pasur shkelje.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se në mbledhjen e KPF-së është votuar propozimi i përfaqësuesit të LVV-së për debat lidhur me konkurset, por nga opinioni i marr nga Zyra ligjore konstatohet se nuk është obliguese që rekomandimet e votuara në KPF, detyrimisht të dërgohen edhe në kuvend. Pavarësisht kësaj është e drejtë e secilit anëtar të kuvendit të propozojë pikë për futje në rendin e ditës para aprovimit të rendit të ditës. Më tej sugjeroi përfaqësuesit në KPF, që në të ardhmen propozimet e tyre të bëhen në mbledhjet e KPF-së që të jenë për diskutim dhe shqyrtim në po ato mbledhje dhe më tej të procedohen për mbledhjet e kuvendit. Në fund kërkoi nga të gjithë që të jenë konstruktiv dhe diskutimet e tyre të orientohen në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** – pasi përshëndeti të pranishmit tha se sot kur para vetës kemi konkursin në arsim të anuluar jashtë çdo procedure ligjore, pas përfundimit të intervistës me shkrim dhe me gojë, ku pritej vetëm shpallja e rezultateve i njëjti anulohet. Në vendimin për anulim nga ana e kryetarit thuhet se ka pasur shkelje nga ana e komisionit, shtrohet pyetja: cilat janë këto shkelje?, a janë marrë masa nga ana e kryetarit për këto shkelje të pretenduara?, a do të ndërrohet komisioni? Sot para vetës kemi edhe anulimin e blerjes së shërbimeve përmes prokurimit, çuditërisht edhe këtu kjo procedurë anulohet pasi që komisioni për vlerësim ka dhënë opinionin e vet dhe ka mbet vetëm shpallja e rezultateve. Pse u anulua kjo procedurë?, apo personat që ju deshën pushtetit nuk i plotësuan kushtet dhe u anulua edhe kjo procedurë në mënyrë të kundërligjshme?. Kryetari i komunës anuloi vendimin e qeverisjes së kaluar që qytetarët të mos paguajnë 80 euro për kyçje individuale? Nuk e keni idenë se ku qëndron realizimi i projektit, madje nuk keni as informata lidhur me këtë projekt! Mbi 7000 kyçje kanë përfunduar deri në fund të vitit 2021, ndërsa sa kyçje individuale kemi prej që e keni marrë ju qeverisjen? Asnjë! Ende nuk keni filluar asgjë! Mbi 90% e qytetarëve kanë kryer obligimet e pagesës duke qenë edhe bashkëpunues gjatë realizimit të punimeve në terren e për çka ne jemi falënderues ndaj tyre, mirëpo tash me këtë vendim tuajin a do të ktheni mjetet qytetarëve që kanë paguar apo keni liruar vetëm një pjesë të qytetarëve që ende nuk kanë paguar. Po krijoni ndasi dhe përçarje në mes të qytetarëve! Sot kur jemi pikërisht në mes të vitit është me interes për ne dhe për qytetarët që po na dëgjojnë se cila është shkalla e realizimit të buxhetit?, sa është realizuar apo a do të realizohet deri në fund?, cilat janë projektet që kanë filluar nëse kemi ndonjë të tillë? Pas gjithë kësaj kohe ne nuk po shohim asgjë, dhe me këtë trend të qeverisjes ju siguroj që suficiti i këtij viti do të jetë më i madh sesa suficiti i katër viteve të fundit të qeverisjes së LDK-së. Sa e dobët është kjo qeverisje tregojnë edhe vendimet e sotme për të cilat kërkoni që të votohen për të tretën herë, rishqyrtim të njëpasnjëshëm të pothuajse të gjitha vendimeve që po sillen në kuvend. Kjo mënyrë e veprimit do të ndikojë direkt në vlerësim të performancës së komunës. Jam i bindur se nëse qeverisja komunale do ishte konsultuar me profesionistë që i ka komuna një gjë e tillë nuk do të ndodhte. Të nderuar kolegë asamblistë, të respektuar qytetarë që po na ndiqni drejtpërdrejtë, ka muaj që jemi zhytur në një krizë të madhe ekonomike, rritje astronomike të çmimeve të produkteve esenciale - bukës, vajit, naftës, lëndëve djegëse për ngrohje për sezonin e dimrit, e siç po shihet kriza po shkon vetëm duke

u thelluar e me këtë edhe jeta duke na u vështirësuar. Në këto rrethana, në vend se të gjithë të angazhohemi të jemi në krye të detyrave e përgjegjësive tona e më së shumti kryetari me kabinetin e tij, sepse për këtë është votuar, për të kryer këto punë pati premtuar në fushatë dhe normalisht këtë e presin qytetarët tani prej tij. Por në vend se të jetë në krye të përgjegjësive të veta, e të ballafaqohet me sfida, kryetari si duket ka vendos që mos merakoset. Sot Kryetari ka vendosur që të ik nga përgjegjësia që e ka. Nuk kam si ta quaj ndryshe përveç mungesë e guximit për t'u ballafaquar me realitetin e që po duket të jetë një realitet jo aq i këndshëm për një kryetar komune. Këtë më së miri e dëshmojnë këto dy seancat e fundit, në njërën mungon grupi kuvendar i PDK-së e në tjetrën kryetari i komunës.

**Behar Duraku, anëtar i kuvendit** – pasi i përshëndeti të pranishmit parashtrori, një kërkesë dhe një pyetje, kërkesa ka të bëjë për Drejtorinë e Inspektiveve lidhur me rrugën “Adnan Shyti” që të dërgon tek palestra sportive, te stacioni i vjetër ku disa qytetarë janë ankuar për atë pjesë që është shumë e ngulfatur nga parkimet e automjeteve dhe një kamioni që është i prishur dhe qëndron me vite në trotuar dhe disa shitës aty, ku kanë bllokuar trotuarin në tërësi dhe si rrjedhojë po pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve, dhe për vet qytetin ajo pjesë po paraqet pamje të shëmtuar kur dihet se aty ka aktivitete të ndryshme në palestrën sportive e po ashtu në qendrën rinore që është aty. Pra kërkesa është që si Drejtori e Inspektiveve të dilet në vendin e ngjarjes dhe të shikohet ajo pjesë dhe të lirohet trotuari për lëvizje të lirë të qytetarëve. Ndërsa pyetja tjetër ka të bëjë me drejtorinë e Urbanizmit lidhur me disa rrugë në fshatrat Gllavatit Stroc, Bivolak dhe Beçuk, të cilat kanë qenë projekte dyvjeçare ku vitin e kaluar janë përfunduar me zhavorr dhe për këtë vit ka mbetur vetëm asfalti, mirëpo kanë kaluar 6 muaj të këtij viti dhe nuk ka ende asnjë hap në këtë drejtim, prandaj ju drejtohem juve drejtoreshë e nderuar si ka mbet puna për këto rrugë dhe kur priten të fillojnë? Ju faleminderit!

**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit** - kërkoi nga Drejtoria e Shëndetësisë të jepen informacione, lidhur me arrestimet e fundit që kanë ndodhur, të zyrtarëve që punojnë në QMF-1, pasi që kjo ngjarje ishte shqetësuese për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, dhe po ashtu kërkoi një menaxhim më të mirë nga ana e drejtorisë, pasi që analizat laboratorike që pretendohet se po kryhen në laborator nuk janë duke u kryer me arsyetimin se nuk janë duke punuar pajisjet, apo se nuk ka material dhe kjo bie në përgjegjësinë e Drejtorisë së Shëndetësisë.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** – pasi i përshëndeti të pranishmit tha se kryetari i komunës më datë 21.6.2022, ka shfuqizuar vendimin komunal me të cilin ekonomitë familjare ngarkoheshin me taksë komunale prej 80 euro, ndërsa bizneset me 150 euro, për kyçje në rrjetin e ujësjellësit. Vendimi i atëhershëm me numër protokollit 1085/19 i datës 12.9.2019, është përcjell edhe me dy aneks-marrëveshje: e para Marrëveshje mirëkuptimi në mes K.R.U. ujësjellësit <Mitrovica SH.A> dhe Komunës së Vushtrrisë, në këtë aneks-marrëveshje ndër të tjera në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje thuhet: kyçjet individuale që do të realizohen nga Komuna e Vushtrrisë për K.R.U. “Ujësjellësi” do të participohen nga qytetarët nga 80 € sipas vendimit të komunës, më tej pika 1.2. K.R.U. “Ujësjellësi” SH.A. në Mitrovicë, nuk do të aplikojë ngarkesë ose tarifë për kyçje në bazë të Rregullores të Autoritetit Rregullativ të Ujërave dhe pika 1.3 ekonomitë familjare dhe bizneset që nuk participojnë në këtë projekt të komunës K.R.U. “Mitrovica” SH.A. në Mitrovicë, do ta aplikon tarifën e kyçjes në bazë të Rregullores së ARU-së. Andaj nga këto dhe përkufizime tjera ligjore pyetja e tij për kryetarin e komunës është, se kur e ka marrë këtë vendim a është konsultuar dhe a i ka njoftuar me shkrim palët nënshkruese të marrëveshjes nga e cila rrjedhin obligimet e dyanshme, d.m.th. a është njoftuar kryeshefi ekzekutiv dhe kryetarët e këshillave të fshatrave, të cilët kanë kryer një punë të madhe dhe të mundimshme në këtë drejtim. Sa do të jetë kostoja financiare e këtij vendimi dhe kah do të sigurohen këto mjete. Meqenëse Drejtoria e Shërbimeve

Publike ka qenë bartëse e këtij projekti, parashtrori pyetje për drejtorin e kësaj drejtorie: sa fshatra janë kyçur në rrjetin e ujësjellësit, në sa fshatra ka përfunduar në tërësi shtrirja dhe kyçja në rrjetin e ujësjellësit, sa është numri i ekonomive familjare dhe i bizneseve që janë kyçur në rrjetin e ujësjellësit nëpër secilin fshat, sa është numri i ekonomive familjare dhe i bizneseve që kanë participuar në secilin fshat, sa është shuma e mjeteve financiare që janë inkasuar në llogarinë e komunës nga ky projekt. Aktualisht a është duke vazhduar projekti i zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit në komunën tonë dhe nëse po në cilat fshatra po punohet, a ka afat kohor kur do të përfundojë ky projekt me rëndësi jetike për qytetarët, sepse edhe sot ku jemi në mesin e vitit në temperatura shumë të larta, ka shumë defekte në furnizim me ujë të pijshëm

**Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së**-paraqiti sqarime lidhur me pyetjet e parashtruara nga anëtarët e kuvendit, duke shtuar se është politikë e kryetarit të komunës që ta heq tarifën për kyçje në rrjetin e ujësjellësit me qëllim të lehtësimit të jetës së qytetarëve.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** – tha se në bazë të marrëveshjes së komunës dhe Kompanisë së Ujësjellësit, është përcaktuar se nëse qytetarët dhe bizneset nuk mbulojnë taksën prej 80 € për kyçje, atëherë kompania do të aplikojë një taksë tjetër që do të jetë më e lartë dhe kësaj një vendim i tillë popullist i kryetarit të komunës vetëm sa do t'i dëmtojte edhe më tepër interesat e qytetarëve.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** – pyeti anëtarët e komisionit të aksionarëve të N.P.L. “Përparimi” lidhur me vendimin e tyre për shkarkimin e bordit të kësaj ndërmarrjeje, nën arsyetimin se ky i fundit ka dështuar në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiive ligjore të tyre. Në këtë rast ai pyeti se sa mbledhje i ka mbajtur Komisioni i Aksionarëve të kësaj ndërmarrjeje, dhe njoftoi se është mbledhja e parë dhe në këtë mbledhje ka ndodhur shkarkimi i bordit, dhe në këtë rast ka dyshime se ka shkelje ligjore nga komisioni e jo bordi. Pastaj ai vlerësoi se si ka mundësi që ndërmarrja “Përparimi” të jetë e suksesshme, e në të njëjtën kohë të shkarkohet bordi i saj menaxhues, kjo është në ikontradiktë njëra me tjetrën. Në këtë kontekst shtoi se Komisioni i aksionarëve ka dështuar në ofrimin e raportit vjetor të punës, përderisa bordi e ka bërë një gjë të tillë.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit** – tha se është për keqardhje funksionimi i qeverisë aktuale komunale, dhe se ajo është qeveria më e dobët që ka udhëhequr ndonjëherë në Vushtrri. Krejt dështimet e kësaj qeverie janë duke u mbuluar me disa vendime populliste, siç është ai për anulimin e konkursit në arsim, anulimi i vendimit për taksën për ujin prej 80 €, mandej kthimi i vendimeve nga niveli qendror siç është ai për bartjen e të hyrave komunale, mandej vendimi për lokacionin e tregut, i cili është kthyer në rishqyrtim për disa herë më radhë. Lidhur me anulimin e konkursit në arsim vlerësoi se kryetari i komunës ka bërë shkelje ligjore dhe për këtë do të përgjigjet penalisht.

**Albanez Tahiraj, i autorizuari i Kryetarit të komunës** - tha se propozimi për diskutim për konkursin në arsim mos të ezaurohet, pasi është propozuar të futet në rend të ditës. Më tej njoftoi se kryetari i komunës është në një vizitë zyrtare në Francë me ftesë të ambasadës së kësaj të fundit ku po marrin pjesë disa komuna të Republikës së Kosovës. Lidhur me konkursin asgjë nuk ka se çfarë të fshehet, sepse kryetari i komunës është me qytetarin dhe ajo po shihet për çdo ditë. Lidhur me shkarkimin e bordit të N.P.L “Përparimi” shtoi dhe njoftoi se Komisioni i aksionarëve ka marrë vendimin meritore, për të cilin tani nuk dëshiron që të interferojë, për faktin se vendimi ka këshillën juridike për ankesë dhe për mundësinë e hapjes së konfliktit administrativ.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** – tha se bordi i kaluar i ndërmarrjes “Përparimi”, ka qenë bord politik, dhe këtë përbërje edhe përkundër respektit ai e kishte kundërshtuar. Ai tha se ndryshimi dhe marrja e pushtetit nënkupton marrjen edhe të përgjegjësiive. Ky shkarkim që ka ndodhur është dashur të bëhet edhe më herët sepse nuk mund të qeverisësh me njerëzit që nuk ke bashkëpunim.



Më tej shtoi dhe konsideroi se bordi aktual i kësaj ndërmarrjeje ka dështuar në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve ligjore.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** – tha se bordi aktual i shkarkuar i ndërmarrjes “Përparimi” nuk është bord politik por profesional, dhe se këtë do ta dëshmojë koha, pasi që i njëjti do të kthehet prapë me anë të ankesës pasi që kemi shkelje ligjore.

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit** – tha se kjo ndërmarrje është e suksesshme dhe se komisioni i aksionarëve ka mbajtur vetëm një mbledhje dhe në fund është befasuar kur është marrë vendimi për shkarkimin e bordit, vendim për të cilin ai ka qenë kundër.

**Albanez Tahiraj, i autorizuari i Kryetarit të komunës** - kërkoi nga parafolësi i tij të jetë më serioz, dhe ta thotë të vërtetën pasi që tema është serioze. Ai më tej shtoi se nuk ka qenë mbledhja e parë e komisionit atëherë kur ka ndodhur shkarkimi i bordit dhe kjo konstatohet nga procesverbali i mbledhjes paraprake, për të cilën kishte votuar edhe përfaqësuesi i LDK-së. Pastaj shtoi se mes komisionit dhe bordit të ndërmarrjes kishte pasur komunikim zyrtar përmes shkresave, i njëjti nuk ka ofruar materialet e kërkuara që dëshmon se ky bord nuk i ka përmbushur obligimet që dalin nga ligji. Në këtë kontekst shtoi se nuk dëshiron të interferojë në këtë proces pasi që ekziston e drejta e ankesës, dhe pas përfundimit të këtij procesi gjithçka që ka ndodhur do të informohet kuvendi.

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit** – njoftoi se në Komisionin e aksionarëve kishte pyetur kryesuesin e komisionit se a kanë dërguar bordi ndonjë raport, plan ekonomik dhe se a kanë kryer obligimet sipas ligjit, dhe përgjigjja ka qenë negative se asgjë nuk është punuar, andaj ai kishte vlerësuar se nëse është kështu situata, atëherë duhet urgjentisht të shkarkohet bordi i N.P.L “Përparimi”.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** – tha se nuk i takon të autorizuarit të kryetarit të komunës që t’ju ndërhyjë anëtarëve të kuvendit duke ju dhënë leksione, dhe shtoi se edhe në mbledhjen e KPF-së kishte kërkuar nga DSHP-ja dhe DUMM-ja që ta sjellin listën e rrugëve që do të ndërtohen këtë vit, ashtu siç ka qenë premtimi i kryetarit të komunës.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** – kërkoi nga kryesuesja e kuvendit që të respektohet rregullorja e punës, dhe të futemi në diskutime për rendin e ditës dhe jo të zgjatemi në diskutimet shterpe e të padobishme.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit** – pasi i përshëndeti të pranishmit, shtoi se po diskuton në mënyrë të përsëritur për çështjen e nevojës të sjelljes në kuvend të Propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit me numër protokolli 81/21 për zonën ekonomike në fshatin Lumadh. Në mbledhjen e kaluar pasi që i ishte ndërprerë fjala kryesuesja e kuvendit kishte premtuar se kjo çështje do të dërgohet në kuvend këtë mbledhje, por prapë e shohim se nuk është sjellë në rend dite. Çështja e zonës ekonomike është aseti më i madh i qytetarëve, nëse e marrim nga aspekti zhvillimor-ekonomik në rend dite nuk është proceduar alfa dhe omega (A-Ω) e zhvillimit ekonomik të komunës. Duke u bazuar në nenin 18 të Rregullores të punës së kuvendit, e drejta e anëtarit të kuvendit për të propozuar pikë të rendit të ditës të drejtë të cilën ai nuk e ka shfrytëzuar, me qëllimin më të mirë që të respektohen në tërësi procedurat ligjore të procedimit të kësaj çështjeje në kuvend, duke kaluar dhe shqyrtuar fillimisht në Komitetin për Politikë dhe Financa. Në fund duke ju referuar diskutimit të shefit të grupit kuvendar të LDK-së z.Adnan Lahut, vlerësoi se ai foli për zhvillim ekonomik, ndërsa ai ka zbatuar një vendim të zonës ekonomike, i cili është i dëmshëm për komunën dhe qytetarët e Vushtrrisë, këtë gjë e ka konstatuar MAPL dhe Agjencia Kundër Korrupsionit, e cila ka kërkuar që ky vendim të shfuqizohet dhe e njëjta të njoftohet për hapa që ka ndërmarr Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë. Andaj kërkoi nga kryesuesja e kuvendit që këtë pikë ta sjellë në kuvend në mbledhjen e radhës, në të kundërtën ai do t’i përdorë format

tjera ligjore, duke e propozuar vetë këtë pikë në rend dite për shqyrtim dhe shfuqizimin e këtij vendimi.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit**- ngrit shqetësimin e qytetarëve që tani në këto ditë të nxehta vere, për 4 ditë rresht ka pasur pengesa në furnizim me ujë të pijshëm, andaj ju bëri thirrje institucioneve lokale, të ndërmarrin veprime të shpejta. Pastaj ceku çështjen e ndarjes së subvencioneve për OJQ-të, ku kemi shumë ankesa për ndarjen e tyre dhe ndërhyrjes nga ekzekutivi. Në këtë kontekst pyeti për disa organizata që janë përfituese të subvencioneve dhe këto organizata janë të panjohura për qytetarët dhe për shoqërinë civile, por edhe për vetë atë si ish-drejtoreshë. OJQ-të në fjalë janë: <Creative center>, <Art natyra>, <EVDS>, <SBZHD>, <STR>, <ORGA>, < Vicina vizion>, <Rinia aktive e Vushtrrisë>, <Qendra për rini të avancuar>, <Koha në duart tona>. Lidhur me këtë pyeti drejtoreshën e kulturës se a janë këto organizata të Komunës së Vushtrrisë, dhe se këto organizata a e kanë një vit nga data e regjistrimit në ministrinë kompetente, siç kërkohet me Rregulloren e Ministrisë së Financave.

**Nexhmedin Rashica, drejtor i DSHPS** - paraqiti sqarime për pyetjen e anëtares së kuvendit, ku njoftoi se ka pasur arrestime të zyrtarëve të laboratorit të QKMF-së dhe për këtë janë informuar më datë 15.6.2022. Nga informata zyrtare del se për një kohë të gjatë ka pasur hetim të laboratorit dhe zyrtarëve kompetent sa i përket analizës me urinë. Si Drejtori e Shëndetësisë, kanë ndërmarrë veprim, duke i suspenduar këta tre zyrtarë për një periudhë prej gjashtëmuajsh deri në një vendim të plotfuqishëm të organeve të drejtësisë. Pastaj vlerësoi se nuk mund të jap përgjigje për fajësinë dhe pafajësinë e tyre sepse është punë e organeve gjyqësore, ndërsa zëvendësimi i këtyre zyrtarëve është bërë. Sa i përket analizave laboratorike, material për analiza ka në sasi të mjaftueshme, ndonjëherë ka probleme me realizimin e analizave për shkak të mosfunksionimit të pajisjeve laboratorike dhe kjo varet nga kompania për sërvisimin e këtyre pajisjeve.

**Fortuna Krasniqi, drejtoreshë e DUMM-së** - njoftoi se Drejtoria e Urbanizmit në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike kanë themeluar një komision të përbashkët për vlerësimin e gjendjes së rrugëve në Komunën e Vushtrrisë, dhe për këtë është duke u bërë priorizimi i nevojave për ndërtimin e rrugëve.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –propozoi që në propozim-vendimin për lirimin nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike, t'i shtohet edhe hapësirave publike që janë me qira, përndryshe ky është një propozim-vendim mjaft i qëlluar duke marrë për bazë krizën ekonomike.

Në vazhdim, kuvendi në mënyrë të veçantë i votoi pikat e dërguara në të ndryshme,

Pas votimit me vota “unanime” u futen në rend të ditës pika 10 dhe 11.

Në rend të ditës u shtua edhe pika 12, Rishqyrtimi i vendimit nr.100/22, i datës 28.4.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri, me 21 vota “për”, 4 vota “kundër”, të tjerat abstenim.

Kuvendi pas votimit me 11 vota “për”, 12 vota “kundër”, të tjerat abstenim nuk e aprovoi për inkorporim në rendin e ditës propozimin për diskutim lidhur me anulimin e konkursit në arsim.

**Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me 23 vota “për” 6 vota “kundër” të tjerat abstenim aprovoi këtë:**

## REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 maj 2022;
2. Shqyrtimi i Raportit të sistemit të menaxhimit të performancës dhe grantit të performancës për vitin 2020;
3. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2023-2025;
4. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (KKV) nr.03/2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat;
5. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2020/2021;
6. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të ndërtimeve pa leje;
7. Shqyrtimi i Informatës për punën e Drejtorisë për Administratë, gjatë periudhës janar – qershor 2022;
8. Rishqyrtimi i vendimit nr. 95/22 i datës 28.4.2022 për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2021;
9. Rishqyrtimi i vendimit nr. 96/22 i datës 28.4.2022 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022;
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lirimin nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike;
11. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane;
12. Rishqyrtimi i vendimit nr.100/22 i datës 28.4.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtri;
13. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 maj 2022

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime” aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 maj 2022.**

2. Shqyrtimi i Raportit të sistemit të menaxhimit të performancës dhe grantit të performancës për vitin 2020

**Islam Latifi, zyrtar i DSHP-së** - tha se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në bashkëpunim me komunat dhe donatorët, kanë përmbyllur procesin e vlerësimit për Sistemin e Menaxhimit të Performancës dhe Grantit të Performancës, sipas performancës së komunave dhe kanë publikuar raportin për vitin 2020. Ky raport përmban sistemin i cili ka 19 fusha dhe 119 tregues dhe Grantin e Performancës i cili bazohet në 28 tregues, ndërsa Komunën e Vushtrrisë e ka renditur në pozitën e 10, me një përqindje mesatare 50.00%. Raportimi i të dhënave dhe vlerësimi i tyre për herë të parë u realizua përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale. Në këtë sistem kishin qasje të gjithë zyrtarët raportues të komunave, koordinatorët e performancës, kryetarët e komunave dhe zyrtarët vlerësues të ministrisë. Krahas raportimit, sistemi ofroi mundësinë e bashkëngjijtes së dokumenteve referuese për të dhënat e raportuara, me qëllim të dokumentimit të të dhënave, si dhe një proces komunikimi në mes të komunave dhe Ministrisë, duke lënë gjurmë në secilën fazë të vlerësimit të të dhënave. Të dhënat

e ofruara shërbejnë për të parë trendet e zhvillimit të komunave nga viti në vit, në mënyrë që prioritetet vijuese të shtrihen në mbështetje të sektorëve më pak të organizuar. Veç kësaj, rezultatet e raportit shërbejnë si mjet vetëkontrolli për punën e administratës komunale, për të rritur kapacitetet dhe për të reflektuar në përgjegjshmërinë e zyrtarëve publik. Për më tepër, raporti informon qytetarët për pritjet e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve nga institucionet dhe të zgjedhurit e tyre lokal. Raporti nxjerrë përfundimet e përgjithshme për shkallën e të arriturave të komunave dhe jep rekomandimet përkatëse për përmirësimin e shërbimeve në bazë të rregullave juridike në fuqi apo standardeve të kërkuara qeverisëse. Komuna e Vushtrisë nuk është kualifikuar për grant të performancës për shkak të mospërbushjes të të gjitha kritereve minimale të përcaktuara në Rregullat e Grantit për Performancë. Një prej kritereve që nuk është plotësuar, është shkalla e ulët e shpenzimit të buxhetit të investimet kapitale, e cila nuk e arrin vlerën apo kriterin e përcaktuar prej 75%. Shkalla e shpenzimit të buxhetit të investimet kapitale për Komunën e Vushtrisë për vitin 2020 është vlerësuar 74%. Pra raporti që e keni para jush përveç përshkrimit të qëllimit të këtij sistemi, përmban në vete edhe informatat për trendet e performancës të Komunës së Vushtrisë ndër vite, konkluzione për arritjet më të larta dhe më të ulëta, si dhe rekomandimet se ku duhet të kemi përkushtim më të madh për rritjen e performancës në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike, si dhe gjetjeve nga ky hulumtim, Komunës së Vushtrisë i rekomandohet që të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Sa më shumë përfshirje të të punësuarve me aftësi të kufizuara si dhe sipas përkatësisë gjinore, në institucionet komunale;
- Rritjen e sipërfaqeve të shesheve publike dhe hapësirave të gjelbra në m<sup>2</sup> për kokë banori;
- Rritja e % së vendbanimeve për furnizim me ujë të pijshëm;
- Ligjshmëria e kontratave për shërbime të veçanta;
- Rritjen e % të vendbanimeve me trajtim të ujërave të zeza;
- Rregullimi i numrit të popullatës e cila përfiton nga skema sociale;
- Hartimi i Planit Lokal për Veprim në Mjedis;
- Raportimi i planit vjetor të Planit të integritetit para kuvendit komunal;
- Diskutimi në kuvend i Raportit të auditorit të brendshëm;
- Përbushja e standardeve minimale të konsultimeve publike, si dëgjimet për KAB dhe buxhet komunal;
- Miratimi me kohë i buxhetit vjetor;
- Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit;
- Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim;
- Sipërfaqja e territorit të komunës, e mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme);
- Konstituimi i Këshillave të vendbanimeve-fshatrave.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 16 vota “për” të tjerat “abstenim”, aprovoi raportin e sistemit të menaxhimit të performancës dhe grantit të performancës për vitin 2020.**

### **3. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2023-2025**

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** – tha se KAB-i për vitet 2023-2025, paraqet dokumentin bazë, për planifikimin e buxhetit për vitet vijuese dhe është dokument strategjik ekonomik që ngërthen në vete totalin e mjeteve financiare në dispozicion të komunës, planifikimin ekonomik, projektet kapitale dhe prioritetet e nevojat e komunës. Asgjë të re dhe kreative të përcaktuar në objektiva nuk ka në këtë dokument. Fillimisht Ministria e Financave ka përcaktuar disa objektiva e që dihet që ky dokument është hartuar në bazë të atyre objektivave, por që nuk janë cekur qartë dhe konkretisht këto objektiva nga komuna jonë. Po ashtu ky dokument duhet të ofrojë kornizë gjithëpërfshirëse, reale, planifikim të investimeve kapitale, shpenzime të qarta, pra me fjalë tjera duhet të ofrojë një disiplinë financiare. Për tatimin në pronë, si një komponentë mjaft e rëndësishme e komunës, parashtrori disa pyetje: cilat janë masat që do të përdoren që përqindja e inkasimit të tatimit të rritet, a ka borxhe nga vitet e kaluara, dhe cila është forma që do të veprojnë në rritjen e këtij inkasimi, e cila nuk është specifikuar në këtë dokument. Në faqen 9 të këtij dokumenti thuhet se organizatat buxhetore, pas një analize paraprake duhet të parashikojnë shpenzimet e shpronësimit për çdo objekt individual, në kuadër të kostos totale të projektit, por në qarkoren e parë buxhetore dhe në planifikim asnjëherë vit pas viti nuk kemi një projeksion për borxhet e mundshme të padive për detyrimet kontraktuale nga kontrata kolektive e që nga viti 2020 kemi paguar dhe do të paguajmë edhe në të ardhmen dhe theksohet se Komuna e Vushtrrisë iu ka borxh mësimdhënësve në disa shuma të caktuara, por duhet të jemi të qartë dhe ta dimë se këto shuma nuk janë në llogari vjetore sepse variojnë në çdo vit në çdo muaj, por edhe çdo ditë. Në faqen 21 të KAB-it thuhet se gjatë kësaj periudhe pritet implementimi i projekteve kapitale bazuar në një listë prioritetesh të projekteve me ndikim përmirësimin e rrjetit të transportit dhe përmirësimin e rrjetit të energjisë elektrike, për këtë pyeti se cilat janë këto projekte që përmirësojnë transportin dhe rikujtojnë se rrejtja e energjisë elektrike nuk është kompetencë e komunës edhe pse ky rrjet pothuaj në thuaj shumicën e fshatrave është i vjetruar dhe paraqet rrezik për qytetarët tanë. Në këtë kontekst pyeti se cilat janë masat që do të ndërmerren në bashkëpunim me KEDS-in për përmasimin e rrjetit të vjetruar të energjisë elektrike.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** – tha se kjo kornizë duhet të korrigjohet në faqen 7, paragrafi i fundit, ku është përshkruar gjendja, respektivisht aktivizimi i zonës ekonomike në fshatin Lumadh, sepse në këtë rast hartuesi i referohet kësaj zone sikur ajo të mos ishte ndërtuar fare, e që në të vërtetë korrigjimi duhet të jetë me sa vijon: Komuna e Vushtrrisë në bashkëpunim me ministrinë e linjës ka ndërtuar zonën ekonomike-Parkun Industrial në Lumadh, në sipërfaqe prej afërsisht 40 hektarë. Sepse në tekst thuhet se komuna, përkatësisht Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, mund të fillojë procedurat për ngritjen e kapaciteteve teknike për tërheqjen e investitorëve në këtë zonë ekonomike dhe se edhe kjo preambulë duhet të ndryshohet për faktin se gjendja aktuale e zonës duhet të përshkruhet ashtu çfarë është në realitet. Pastaj thuhet se është shumë e nevojshme që të konsultohen bizneset ekzistuese për nevojat dhe kapacitetet e tyre, edhe kjo frazë duhet të hiqet nga teksti, për shkakun se ka përfunduar procesi i dhënies së pronës në shfrytëzim dhe kjo duhet të trajtohet sipas gjendjes faktike, pavarësisht verdikëve të ardhshme. Në fund njoftoi se pranimi teknik i kësaj zone ekonomike është bërë dhe se tani komuna duhet të intensifikojë përpjekjet për të ndodhur sa më shpejt investimet në atë zonë.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** – tha se kur bëhet fjalë për KAB-in, si dokument strategjik komunal, atëherë duhet ndalur tek vizioni i qeverisjes nëse ai vizon ekziston apo nëse ai mbahet ashtu siç është pretenduar, e që fatkeqësisht ai nuk është i vërtetë. Në faqen 36 të këtij dokumenti në mes tjera thuhet: - vizioni për arsimin, po ashtu marrin pjesë në përzgjedhjen e stafit dhe drejtorëve të shkollave për të siguruar që profesionistët dhe të kualifikuarit janë të punësuar për të mësuar qytetarët tanë të rinj dhe njëherazi i mbajmë shënimet e nevojshme komunale të arsimit dhe statistikave për të matur nivelin e cilësisë së arsimit që ofrohet nga komuna. Gjithashtu komunikojmë hapur me publikun për të gjitha çështjet që lidhen me politikave të arsimit dhe të procesit përbrenda komunës. Andaj vlerësoi se kjo është qasje e kësaj qeverie se si paraqitet vizioni në letër dhe fushatë politike, ndërsa e vërteta është se kjo qeveri nuk e ka guximin që të diskutojë për politikave të arsimit, për procedurat e rekrutimit, duke i ikur debatit dhe duke ju shmangur përgjegjësisë. Andaj i bëri thirrje qeverisë komunal të përputhë vizionin e saj në letër me vizionin partiak dhe qeverisës, dhe të komunikojë me publikun dhe kuvendin për politikave të arsimit dhe jo të shmanget. Pastaj tek vizioni për shëndetësinë ndër të tjera thuhet: - kemi një vizion interesant ku thuhet se ofrojmë edhe kujdesin shëndetësor emergjent, ndërsa kujdesi emergjent ofrohet nga niveli sekondar shëndetësor, por kjo si duket është një inovacion, dhe nëse kjo është arritur nga Drejtoria e Shëndetësisë, atëherë e përgëzon drejtorin e kësaj drejtorie, por kjo dihet se nuk mund të arrihet sepse kjo çështje është e rregulluar me ligj. Në faqe 33 ndër të tjera thuhet se: përveç kësaj, ne po ashtu do të punojmë për të siguruar nivelet e duhura të higjienës që nga kryerja e inspektimeve sanitare për ujën e pijshëm, bizneset prodhuese, përpunimin ose shitjen e ushqimit dhe atyre kompanive që merren me trajtimin e mbeturinave. Ky vizion nuk përshtatet me kompetencat, pasi që Drejtoria e Shëndetësisë nuk i kryen këto shërbime. Tek projektet kapitale në shëndetësi siç është hapja e puseve në QMF dhe AMF, shtoi se komuna është zotuar se do të shtrijë ujësjellësin në çdo lokacion, atëherë cila është arsyeja e hapjes së këtyre puseve, dhe po ashtu kërkoi të di se në cilat QMF dhe AMF do të hapen këto puse të ujit. Zyrat administrative në QKMF, për çfarë qëllim do të funksionojnë këto zyra, vetëm nëse shfrytëzohen për lëshimin e certifikatave.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** – duke u përgjigjur në diskutimin e anëtarit të kuvendit z. Ilmi Azemi, shtoi se ai paraqiti një rezumë sikur parku industrial ka kaluar të gjitha fazat e aprovimit, por siç dihet deklarimi i kryetarit të komunës dhe qeverisjes komunale është se ky projekt është kthyer në pikën zero. Andaj grupi kuvendar i LVV-së e përkrah këtë dokument ashtu siç është procedura, pa korrigjimet e propozuara nga anëtarit i kuvendit z. Ilmi Azemi.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** – tha se diskutimi i kolegut të tij parafolës është për keqardhje, pasi që ai e di mirë se zona ekonomike është ndërtuar dhe është në fazën finale, dhe në KAB përshkruhet sikur ky projekt fare nuk ka filluar. Andaj propozimi i tij ishte që ky dokument të korrigohej sa i përket të dhënave që janë shpërfaqur që nuk janë të sakta dhe jo të faktuara.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** – tha se e kupton se ky projekt në aspektin fizik të fjalës është përfunduar, por sa i përket përzgjedhjes së përfituesve ka pasur konflikt interesi, dhe për anëtarin e kuvendit Ilmi Azemi kjo është e dhimbshme sepse i njëjti ka interes personal.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit** – tha se në aspektin fizik parku industrial është ndërtuar, ndërsa akoma nuk ka përfunduar në aspektin teknik e ligjor.

**Remzi Ahmeti, drejtor i DBF-së** - paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me KAB-in, duke shpalosur vizionin e zhvillimit ekonomik të Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2023-2025. Po ashtu njoftoi për masat që i ka ndërmarrë Drejtoria e Financave për rritjen e inksimit të tatimit në pronë.

**Abit Abiti, ZKF** - paraqiti sqarime lidhur me vizonin dhe politikat ekonomike komunale, si dhe për objektivat strategjike që duhet të inkorporohen në buxhetin e komunës për vitin 2023 e që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Komunës së Vushtrrisë. Po ashtu ai dha sqarime sa i përket çështjeve të ngritura nga anëtarët e kuvendit. Lidhur me projektin zona ekonomike në Lumadh, kërkoi të ketë votim të veçantë, pasi pati kërkesa për korigjim të përkufizimit tekstual të dokumentit, sa i përket këtij projekti.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 17 vota “për”, 12 vota “kundër” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim aprovet Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 2023/01, e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me të cilën caktohen kufijtë buxhetor të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2023-2025.

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025 e Komunës së Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hynë në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesja e Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (KKV) nr.03/2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi Rregulloren për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (KKV) nr.03/2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat.**

5. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2020/2021

6. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të ndërtimeve pa leje

7. Shqyrtimi i Informatës për punën e Drejtorisë për Administratë, gjatë periudhës janar – qershor 2022

8. Rishqyrtimi i vendimit nr. 95/22 i datës 28.4.2022 për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2021;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 19 vota “për”, tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim bëhet shpërndarja e tejkalimit të planit të të hyrave vetanake për vitin 2021 në kategoritë ekonomike të cekura si më poshtë:

- Mallra dhe shërbime .....306,354.13 €
- Shpenzime komunale.....9,994.73 €

- Subvencione dhe transfere.....593,966.26 €
- Investime kapitale.....227,973.92 €

**Totali i mjeteve të tejkaluara.....1,138,289.04 €**

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operationale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.95/22 i datës 28.4.2022.

5. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**9.** Rishqyrtimi i vendimit nr. 96/22 i datës 28.4.2022 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 14 vota “për”, 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022 në kategoritë si në vijim:

- Mallra dhe shërbime .....675,131.31 €
- Shpenzime komunale.....14,504.93 €
- Subvencione dhe transfere.....693,700.00 €
- Investime kapitale.....1,190,675.47€

**Totali i mjeteve të bartura.....2,574,011.71 €**

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operationale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.96/22 i datës 28.4.2022.

5. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



**10.** Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lirimin nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës komunale, shfrytëzimi i hapësirave publike para lokaleve, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e gastronomisë për më pak se një vit, nga data 3.1.2022 deri më datën 28.12.2022.

2. Qëllimi i këtij vendimi është përkrahja e këtyre veprimtarive, të cilat operojnë në gjendje jo të mirë ekonomike.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe Drejtoria për Inspektime.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**11.** Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane

**Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore** - paraqiti sqarime lidhur, lidhur me këtë draft-rregullore, duke shtuar se emërtimi dhe përkufizimi territorial i lagjeve urbane duhet të bëhet me vendim të veçantë të kuvendit sipas dispozitave të statutit të komunës.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” fillimisht aprovoi vendimin për përkufizimin dhe emërtimin e lagjeve urbane:**

1. Me këtë vendim bëhet përkufizimi dhe emërtimi i lagjeve urbane të qytetit të Vushtrrisë si në vijim:

1.1. “Lagjja Qendra”;

1.2. “Lagjja Kalaja”;

1.3. “Lagjja Ura e Vjetër e Gurit”;

1.4. ”Lagjja Vicianë”;

1.5. “Lagjja Silnica”;

1.6. “Lagjja Dardania”, dhe

1.7. “Lagjja Iliria”.

2. \*Lagjja Qendra\* kufizohet me rrugët: “Faruk Beqiri”, “Enver Musa”, “Zenullah Begu”, segmenti i rrugës “Vesli Klark”, “Hasan Prishtina” dhe sheshin “Adem Jashari”, kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë: “Shefki Dallku”, “Hys Popova”, “Burim Muli”, “Arsim Muzaqi”, “Sulejman Vokshi”, “7 Shtatori”, “Muharrem Berisha”, “Ahmet Selaci”, “Jakup Badivuku”,

“Galip Badivuku”, “Shemsi Istrefi”, “Rexhep Tërllobuqi”, “Aziz Zhilivoda”, “Rrahmon Selaci”, “Isa Boletini”, “Faruk Sunguri”, “Bislim Bajgora” dhe rruga “Basri Beqiri”.

**3. \*Lagjja Kalaja\*** kufizohet me rrugët: “Xhavit Mulaku”, “Dëshmorët e Kombit”, sheshin “Adem Jashari”, rruga “Hasan Prishtina”, “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, “Ana Lin” dhe “Rrustem Hyseni Historiani”, kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë: “Ekrem Mulaku”, “Murat Rashica”, “Gjon Buzuku”, “Bedri e Nebih Uka”, “Burhan Badivuku”, “Bedri Bajgora”, “Hamdi Ferati”, “Ukshin Kovaçica”, “Ismajl Parduzi”, “Shahin Krasniqi”, “Rexhep Musa”, “Kruja”, “Ali Pashë Tepelena”, “Ridvan Qazimi”, “Marin Berleti”, “Pandeli Sotiri”, “Udha e Shkronjave”, “Hoxhë Kadri Prishtina”, “Shem Nallbani”, “Gëzim Rama”, “Xhevat Jusufi”, “Sali Zeka”, “Ismajl Qemajli”, “Halit Çuka”, “Zeqir Kamerolli”, “Ramadan Fazliu”, “18 Prilli”, “Ferat Novolani”, “Luan Haradinaj”, “Arsim Rrustolli”, “Haxhi Zeka”, “Ali Buqinca”, “Çameria”, “Enver Rrustolli”, “17 Qershori”, “Jeronim De Rada”, “Nazmi Ispahiu”, “Qamil Zeqiri”, “Shefqet e Shefki Popova”, “Hakif Zejnullahu”, “Avni Rrustemi”, “Jakup Ceraja”, “Aziz Mehmeti”, “Mursel Billata”, “Hajzer Jashari”, “Edmond Hoxha”, “Shemsi Ahmeti”, “Bahri Ferizi”, “Naser Hajrizi” dhe rruga “2 Korriku”.

**4. \*Lagjja Ura e Vjetër e Gurit\*** kufizohet me rrugët: “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, “Vesli Klark”, segmentin e rrugës “Kadri Zeka”, “Nazmi Aliu”, “Viciana”, “Adnan Shyti”, “Hamdi Gashi”, “Rasim Pasoma” dhe segmentin e rrugës “Mbretëresha Teutë”, kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë: “Blerim Zuqaku”, “Avni Saraçi”, “Bedri Pejani”, “Xhevat Uka”, “Ferit Mulaku”, “Bahtir Perçuku”, “Mensur Gërguri”, “Rushit Stroci”, “Martirët Grabanica”, “Hamdi Gashi”, “Qamil Haziri”, “Sahit Avdulli”, “Hazir Kolla”, “Lulzim Jashari”, “Shaban Tahiri”, “Durrësi”, “Ramadan Kastrati”, “Hasan Tiku Shabani”, “Mustafë Januzi”, “Mehmet Bivolaku”, “Paria e Drenicës”, “Vehbi Hetemi”, “Hazir Gjaka”, “Ismet Haliti”, “Agim Islami”, “Sefer Duboci”, “Asllan Xhemajli” dhe “Vëllezërit Tahiri”.

**5. \*Lagjja Viciana\*** kufizohet me rrugët: “Tahir Sinani”, “Çanakkala”, “Mehdi Zabeli”, segmentin e rrugës “Lumni Surdulli” dhe “Niman Ferizi”, rrugën “Faruk Beqiri” dhe “Xhavit Mulaku”, kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë: “Indrit Cara”, “Daut Imeri”, “Martirët e Lirisë”, “Dëshmorët e Kombit”, “Shaban Polluzha”, “Ajet Gërguri”, “Shkolla e Parë Shqipe”, “Kongresi i Manastirit”, “Ferat Muja”, “Sadri Kapiti”, “Selmon Kostanica”, “Qemajl Shaqiri”, “Dituria”, “Avni Klinaku”, “Qerim Qerimi”, “Ahmet Uka”, “Balli Kombëtar”, “Agim Zeqiri”, “Bajram Latifi”, “Eset Ibrahimimi”, “Shaban Krasniqi”, “Hajriz Musa”, “Liman Bajram Hasani”, “Helge Onsrud”, “Toplica”, segmenti i rrugës “Lumni Surdulli”, rruga “Ejup Kasumi”, “Kadri Dushi”, segmenti i rrugës “Vëllezërit Melenica”, rruga “Ibish Dervishi”, “Jeton Tërrstena”, “Enver Tahiri”, “Shaban e Xhevat Musa”, “Sherif Dibrani”, “Gani Muli”, “Musa Hajdini”, “Ekrem Isufi”, “Selim Bislimi”, “Sherif Kolla”, “Rafet e Burim Rrahmani”, “Isuf Mehana”, “Halit Salihu”, “Hamdi Hajrizi”, “Hamdi Krasniqi”, “Jashar Jashari”, “Burim Hoxha”, “Mehdi Haziri”, “Rexhep Podvorica”, “Abit Kolla”, “Mehdi Musliu”, “Musë Hajrizi”, “Xhemajl Mehmeti”, “Dardania”, “Mehmet Akifi”.

**6. \*Lagjja Silnica\*** kufizohet me rrugët: “Enver Musa”, segmentin e rrugës “Lumni Surdulli”, “Zenullah Begu”, “Kadri Zeka”, “Hamit Hyseni” dhe “Niman Ferizi” “Lidhja e Lezhës”, kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë: “Sejdi Beqiri”, “Rifat Galica”, “Mursel Istrefi”, “Mehmet Konjuhi”, “Koshtova”, “Mujë Ulqinaku”, “Mustafë Shyti”, “Halit Mikullovc”, “Shaban

Mlinaku”, “Fazli Shabani”, segmenti i rrugës “Lidhja e Lezhës”, rruga “22 Maji”, “Bajram Miftari”, “Mic Sokoli”, “Bajram Curri”, “Zymer Haliti”, “Rrahim Syla”, “Zymer Haziri”, “Adem Ademi”, “Fehmi Tahir Istrefi”, “Bekim Zenuni”, “Mursel Hyseni”, segmenti i rrugës “Isak Halili”, rruga “Hamit Zuqaku”, “Mehmet Xhema”, “Isë Mehmeti”.

**7. \*Lagjja Dardania\*** kufizohet me rrugët: “Tahir Sinani”, “Çanakkala”, “Rrustem Hyseni Historiani”, segmentin e rrugës ”Ukshin Hoti”, rrugën “31 Maji”, segmentin e rrugës ”Mehmet Kasumi”, rrugën “Vëllezërit Feka”, “Greva e Minatorëve” dhe segmentin e rrugës “Bahri Kuqi”, kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë: “Patrioti”, “Halit Konjuhi”, “Zëri i Kosovës”, “Qazim Ademi”, “Hoxhë Brezhnica”, “Njazi Badivuku”, “Miftar Shaqiri”, “Bedri Krasniqi”, “Avni Feka”, “Sahit Krasniqi”, “Remzi Aliu”, “Fatmir Krasniqi”, “17 Shkurti”, “Behxhet Aliu”, “Martirët e Zogajve”, “Muharrem Parduzi”, “Bekim Berisha Abeja”, “Shala”, “Rexhë e Fadil Selmani”, “Ragip Musliu”, “Rasim Istrefi”, “Qazim Jashari”, “Xajë Jashari”, “Shefqet e Behxhet Cimili”, “Lutfi Musiqi”, “Lah Izmaku”, “Fexhrije Veseli Gërxhaliu”, “Sami Lahu”, “Shefki Grabanica”, “Zenun Gjocaj”, “Hajzer Neziri”, “Rifat Banjska”, “Muhamed Rashica”, “Sadri Klinaku”, “Sherif Galica”, “Bajram Gashi”, “Vëllezërit Muzaqi”, “Fehmi Tërrnava”, “Nazif Ismajli”, “Xhemajl Hyseni”, “Shkodra”, “Abaz Jashari”, segmenti i rrugës “Rahman Krasniqi”, rruga “Hajrë Hajra”, “Tivari”, “Fetah Hyseni”, “Hoxhë Beqir Rashica”, “Naip Rashica”, “Rizah Rashica”, “Avni e Bedri Rashica”, “Naman e Zylfije Konoviku”, “Zylfije Krasniqi”, “Avdyl Mehmeti”, “Aziz Halili”, “Musli e Selim Drevinja”, “Basri e Ali Hyseni”, “Hasan Rashica”, “Igballe Prishtina”, “Istref e Rexhep Haziri”, “Fadil Beqiri”, “Adnan Bunjaku”, “Osman e Shaban Bunjaku”, “Faik Konica”, “Enver e Zymer Prronaj”, “Deli e Ali Rashica”, “Musli Gërguri”, “Hysen e Xhevdet Hyseni”, “Vëllezërit Zeqiri”, “Zeqir Rashica”, “2 Maji”, “Idriz Kurti”, “Halim Behrami”, “Hazir Muli”, “Hashim Kolla”, “Hazir Gërguri”, “Kadri Bajra”, “Fatmir Ejup Gërxhaliu”, “Qazim Ferati” dhe “Xhemajl Gërxhaliu”.

**8. \*Lagjja Iliria\*** kufizohet me segmentin e rrugës: “Bahri Kuqi” dhe “Mbretëresha Teutë”, rrugën “Ana Lin”, kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë: “Driton Merovci”, “Selim Muzaqi”, “Gjergj Fishta”, “Selman Miftari”, “Arsim Tahiri”, “Ferat Hasani”, “Sadri Jetullahu”, “Brukseli”, “Beshir Krasniqi”, “Fitim Dibrani”, “Sadik Idrizi”, “Sinan Haziri”, “Lutfi Islami”, “Abedin Ferizi”, “Trepça”, “Idriz Hasani”, “Mustafë Çuka”, “Nysret Zymberi”, segmenti i rrugës “Boletini”, rruga “Azem Bejta”, “Shotë Galica”, “Adem Demiraj”, “Sefedin Morina”, “Jonuz Jashari”, “Sabri Behrami”, “Imer Sheshivari”, “Demir Halili”, “Naim Zahiti”, “Muhamet Idrizi”, “Ejup Munishi”, “Nazmi Hyseni Popova”, “Hajriz Halili”, “Milaim Salihu”, “Mursel Krasniqi”, “Veli Xhafa”, “Mehmet Pashë Zogu”, “Ilaz Kodra”, “Isë Mërnica”, “Shefqet Karakashi”, “Halit Merovci”, “Hilmi Rrustemi”, “Selim Mërnica”, “Jakup Saraçi”, “Shaip Azemi”, “Ramë e Imrane Blakaj”, “Bajram Aliu”, “Rifat Krasniqi”, “Ahmet Hajra”, “Beqir Hyseni”, “Mirusha”, “Nezir Imeri”, “Haxhi Ibrahim”, “Ismail Galica”, “Selim Ferati” dhe segmenti i rrugës “Sekine Maxhuni”.

**9.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Administratës, si dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

**10.** Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7 ) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

**Në vazhdim kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi Rregulloren për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane.**

**12. Rishqyrtimi i vendimit nr.100/22 i datës 28.4.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri**

**Fortuna Krasniqi, drejtoreshë e DUMM-së** - tha se në saje të vlerësimeve të bëra nga Ministria e Mjedisit, del se kjo e fundit ka kërkuar nga kuvendi që të heqë nga certifikata pronësore destinimin e një pjese të parcelës, ku kultura figuron si shtëpi-ndërtesë, dhe destinimi të jetë tokë ndërtimore sipas instruksioneve ligjore të kësaj ministrie të linjës. Nga kjo kërkoi nga kuvendi që ta përmbushë obligimin ligjor për rishqyrtim dhe rivotim të këtij propozim-vendimi sipas vlerësimeve të bëra.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** – tha se sikur Drejtoria e Kadastrit t’i kishte kryer punët si duhet nuk do të kishte ardhur deri tek kthimi mbrapsht i këtij vendimi, por shihet se kjo drejtori nuk ka qenë në krye të detyrës dhe janë dal joprofesional. Po ashtu ai përsëriti se lokacioni i ndarë për treg është i papërshtatshëm dhe nuk i përmbush kushtet për një projekt të tillë.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** – tha se si rezultat i mospunës së Drejtorisë së Kadastrit, ky vendim po kthehet si i kundërligjshëm për disa herë më radhë, andaj grupi kuvendar i LDK-së nuk do ta përkrah këtë propozim-vendim sepse kemi të bëjmë me zhvillime joserioze nga ekzekutivi komunal.

**Albanez Tahiraj, i autorizuari i Kryetarit të komunës** - njoftoi se në kuadër të takimit të kryetarëve të komunave të Republikës së Kosovës, me kryeministrin, shumica e kryetarëve të komunave kanë ngritur shqetësimin e tyre për kthimin mbrapsht të vendimeve të kuvendit të komunave për çështje teknike si vendime të kundërligjshme. Tutje shtoi se nuk mund të sfidohen afatet ligjore me shkresa zyrtare të ministrive siç po ndodh shpesh gjatë vlerësimeve ligjore që po bëjnë këto të fundit. Lidhur me vendimin që është objekt shqyrtimi në këtë mbledhje, shtoi se korrigjimi i kulturës, ka mund të bëhet me anë të një shkrese zyrtare nga ana e ministrisë së linjës dhe fare kjo pikë mos të rishshikohet dhe rivotohet në kuvend.

**Në fund të debatit, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 15 vota “për”, 6 vota “kundër” dhe 5 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim plotësohet dhe ndryshohet vendimi i Kuvendit të komunës me Nr. të protokollit Nr.100/22, i datës 28.4.2022 sipas vlerësimeve ligjore të dhëna nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lidhur me certifikatën e pronësisë në të cilën figuron që lloji i shfrytëzimit është Tokë Ndërtimore Shtëpi-Ndërtesë, ndërsa tani shfrytëzimi i këtyre parcelave është tokë ndërtimore. Parcela kadastrale P-70202016-00505-0 është bërë ndarja fizike dhe tani figuron si parcelë kadastrale P-70202016-00505-1, si dhe pjesë nga parcela P-70202016-00504-0. Lokacioni i ndërtimit dhe sipërfaqja e përgjithshme mbetet e njëjtë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi: obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Shërbime Publike, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: certifikata e pronës dhe kopja e planit.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

### 13. Të ndryshme

**Fakete Dushi, anëtare e kuvendit** - ngriti shqetësimin e banorëve të fshatit Shallic, lagjja “Dibrani”, të cilët kanë problem me rrjetin e energjisë elektrike, ku pajisjet elektrike të amvisërisë, nuk funksionojnë si pasojë e tensionit të ulët të energjisë, kështu që kërko që të merren masa. Po ashtu ajo parashtrroi një kërkesë të banorëve të fshatit Maxhunaj për ndërtimin e rr.”Shaip Imeri”.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** - pyeti drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë, lidhur me projektin subvencionimi me kultivatorë dhe freza, i cili ka qenë projekt nga mandati i kaluar dhe i tillë ka vazhduar edhe këtë mandat, dhe është pyetje e qytetarëve se deri ku ka shkuar ky projekt pasi që i njëjti nuk ka përfunduar akoma.

**Ergin Sunguri, drejtor i DEBPZHR-së- u** përgjigj në pyetjen e anëtarit të kuvendit z. Agron Perçuku.

**Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së- u** përgjigj në pyetjen e anëtares së kuvendit znj. Fakete Dushi.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** - pyeti lidhur me projektin furnizim me kultivatorë, nga mandati i kaluar se a i janë paguar mjetet operatorit ekonomik që është dashur ta bëjë furnizimin. Nëse nuk janë realizuar mjete, të njëjtat a kanë shkuar në suficit dhe në këtë rast a është dëmtuar financiarisht komuna.

**Ergin Sunguri, drejtor i DEBPZHR-së- u** përgjigj në pyetjen e anëtarit të kuvendit z. Sylejman Mehulli.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - pyeti lidhur me projektin zgjerim i rrjetit të ujësjellësit, familjet të cilat kanë participuar për kyçje në rrjet, a do t’ju kthehen mjetet financiare, kur dihet se në disa fshatra kanë paguar mjetet në masë mjaft të madhe e disa në masë më të vogël. Ndërsa sipas tij në një fshat janë grumbulluar mjetet financiare për kyçje në rrjet, kurse të njëjtat nuk janë derdhur në llogarinë e komunës.

**Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së- u** përgjigj në pyetjen e anëtarit të kuvendit z. Ymer Haradinaj.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** - pyeti të autorizuarin e kryetarit të komunës lidhur me manifestimin “Ditët e Hasan Prishtinës” zyrtarët e komunës që kanë bërë vizita jashtë vendit a kanë marrë kompensim financiar.

**Albanez Tahiraj, i autorizuari i Kryetarit të komunës** - sqaroi se kompensimi dhe vizitat janë realizuar konform legjislacionit në fuqi.

**Mbledhja përfundoi në ora: 14:00.**

**Bastri Duraku**

**Melihate Basholli-Latifi**

---

**Procesmbajtës**

---

**Kryesuese e Kuvendit**

	<b>Republika e Kosovës</b> Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police	
	Drejtoria Rajonale e Policisë / Mitrovicë Regionalna Policijska Direkcija / Regional Police Directorate Stacioni Policor Vushtrri Policijska Stanica Vučitern / Police Station Vushtrri	

**MEMORANDUM ZYRTAR - SLUŽBENI MEMORANDUM - OFFICIAL MEMORANDUM**

<b>PËR: ZA: TO:</b>	Zonja Melihate Basholli Kryesues i kuvendit komunal Vushtrri	<b>Data: Datum: Date:</b>	14.07.2022
<b>PËRMES: PREKO: THROUGH</b>	Drejtëpërdrejtë	<b>Nr. i Referencës: Br. Referencije: Reference No:</b>	04/1-02 VSH-K / 114/ 2022
<b>PREJ: OD: FROM:</b>	Kapiten Reshat Kovaçi Komandant i Stacionit Stacioni Policor Vushtrri		
<b>LËNDA: PREDMET: SUBJECT:</b>	Informatë mbi gjendjen e sigurisë në zonën e përgjegjesisë së komunës së Vushtrrisë për gjashtë mujorin e vitit 2022		

**E nderuara Kryesuese zonja Melihate BASHOLLI**

Gjashtë mujori i këtij viti karakterizohet me një situatë të qetë dhe stabile të sigurisë në gjithë zonën e përgjegjesisë. Puna dhe angazhimi i zyrtareve të Stacionit Policor Vushtrri ka vazhduar në ofrimin e sigurisë për qytetarët e komunës sonë dhe mundë të konstatojmë se çdo gjë kanë qenë normale pa ndonjë shqetësim të madh për qytetarët. Angazhimet tona kanë qenë më të shumta për shkakë që gjendja e pandemisë ka qenë në rënie dhe angazhimet që kemi pas për gjatë vitit 2021 rreth pandemisë kanë qenë në prioritet për shkakë të rënies së rasteve me Covid -19. Puna jonë ka qenë kryesisht e fokusuar në parandalimin e veprave kriminale si në qytet ashtu edhe në fshatra ku ka pas patrullime të shtuara gjatë gjithë kësaj periudhe kohore. Numri i rasteve në këtë gjashtë mujor ka qenë me një ngritje relativisht të vogël nga 549 në gjashtëmujorin e par të vitit 2021 në 563 raste në gjashtë mujorin e këtij viti, ku një numër i konsiderueshëm i këtyre rasteve janë aksidente të trafikut ku kemi 106 rast nga totali i rasteve.

- **Siguria Publike**

Puna dhe aktiviteti i zyrtarëve Policor është i drejtuar në ofrimin e sigurisë së qytetarëve dhe pronës si dhe parandalimin e gjitha veprave kriminale ,këto angazhime janë të përditshme me shtime të patrullimeve si në qytet ashtu edhe në fshatra. Për veç angazhimeve të rregullta policore në patrullimet si në qytet edhe në fshatra ka pas angazhime dhe patrullime sidomos në orët e mbrëmjes si masë parandaluese kundër veprave penale kundër pasurisë. Kemi zbatuar plane te ndryshme operative me qëllimin e ofrimit te sigurisë me te madhe te qytetareve . Janë angazhuar njësi policore edhe nga Drejtoria rajonale ne pune parandaluese ne terren. Patrullime të shtuara rreth vendeve ku ka frekuentime te të rinjve në lokale sidomos në rrugët :„ Dëshmorët e Kombit”, “Pandeli Sotiri” dhe “Galip Badivuku” dhe përgjatë bulevardit Adem Jashari dhe Hasan Prishtina .

Edhe këtë periudhë po na përcjell problemi i qenve endacak të cilët janë shqetësim i madh për qytetaret.

Nga fillimi i sezonit veror kane filluar edhe ankesat e qytetareve ne lidhje me zhurmat ne lokale gjate orëve te mbrëmjes, veprimet tona i kemi drejtuar ne vetëdijesim dhe ne ndëshkim.

Gjendja ne zonat e banuara me komunitete te përziera është e qete dhe e sigurte ne përjashtim te disa rasteve te vogla qe janë zbuluar dhe proceduar ne prokurori apo ne gjykata kompetente. Ne majin qershor kemi pasur tri lajmërime te rrejshme për bomba te vendosura ne shkollat ku arsimohen fëmijët e komunitet serb te cilat kane kaluar pa ndonjë shqetësim te madh te qytetareve.

### **Disa nga Veprat penale me serioze**

Rastet e dhunës në familje mbeten një shqetësim serioz si tek ne ashtu edhe në mbar vendin sepse ka rritje të rasteve të dhunës në familje, ne anën tjetër zyrtaret nga stacioni policor çdo viktime te dhunës ne familjet i ka ofruar trajtim te dinjitetshëm dhe konformë ligjeve te aplikueshme. Rritjet te këtyre rasteve ne krahasim me periudhën e njëjtë te vitit 2021 qëndrojnë ne këtë relacion 22/47

Edhe në këtë gjashtë mujor, veprat penale kundër trupit dhe jetës kemi një situatë për afërsisht të njëjti me vitin e kaluar ku te lëndimet trupore të rënda kemi 6/4,te lëndimet e lehta kemi një ngritje 40/43 .

Rastet kundër pasurisë kemi rënie : vjedhje e rëndë 64 / 51,Vjedhje 75/58 , megjithatë kemi pasur tri raste te grabitjes te cilat kane ndodhur pa përdorimin e armeve te zjarrit .

Si raste problematike të shoqërisë janë rastet e përdorimit të narkotikëve nga të rinjtë me që rast kemi pas plane Operative në luftimin dhe parandalimin e kësaj dukurie ku kemi proceduar penalisht një numër te madh te personave te dyshimte, nga gjithsej 2 raste te trajtuara ne vitin 2021 kemi rritur aktivitetin tone dhe kemi iniciuar gjithsej 35 raste qe kane te bëjnë me narkotik. Puna jone do te vazhdoj ne luftimin e kësaj dukurie me te njëjtën intensitet.

Armbajtje pa leje sidomos te rastet Përdorimi dhe Posedimi i armeve vazhdon te jete i madh dhe shqetësues. Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore kemi 20/28 raste në rritje e Posedimit të armës si dhe rastet e përdorimit të armës 8/12 ,ku janë konfiskuar 20 armë dhe 67 municione.

- **Trafiku**

Siguria në Trafik mbetet për të dëshiruar edhe pse kemi angazhime dhe plane Operative rreth sigurisë në trafik edhe pse kemi me pak aksidente te evidentuar gjate këtij gjashte mujori se sa ne vitin paraprak (134/106) prap mbetet numër i madh i aksidenteve, qe ngrisin shqetësim dhe detyrë e shtuar për në parandalimin dhe vetëdijesimin e pjesëmarrësve në trafik , gjatë gjithë kohës kemi pika kontrolli si për parandalimin e shpejtësisë ku përdorim Radarin dhe aparatet e alkooltesteve për matjen e sasisë së alkoolit, kemi shqiptuar një mori tiketa për përdorimin e telefonave gjatë vozitjes ,fëmijët në ulësen e par ,vendosjen e rripit të sigurisë e tjerë . Gjatë këtij gjashtëmujori kemi shqiptuar numër te madh te tiketave në trafik (2163 /2349) me qëllim të vetëm, vetëdijesimin dhe parandalimin e aksidenteve që po kanë pasoja si në lëndime ashtu edhe në dëme materiale . Me përmirësimin kohës kemi filluar edhe me njësitin e Bicikletave ku kryesisht merren me trafikun në qytet .

- **Siguria në shkolla**

Tek siguria në shkolla kemi një nivel të mirë të sigurisë në shkolla ku zyrtarët e angazhuar rreth shkollave po bëjnë një punë të mirë në ofrimin e një ambienti sa me te sigurt për nxënësit dhe personelin e shkollave. Bashkëpunimi i mirë mes drejtoreshave të shkollave dhe zyrtarëve kanë dhen rezultate në sigurinë e mirë që kemi në gjitha shkollat e qytetit. Puna e zyrtarëve të angazhuar ka pas në fokus parandalimin e incidenteve në shkolla dhe rreth tyre, përdorimit të narkotikëve dhe bartjeve të armëve . Në kuadër të angazhimeve rreth shkollave kemi zbatuar edhe një plan kontrolli në shkolla në muajin maj qe ka pas për qëllim eliminimin e çdo dukurie negative tek nxënësit. Gjithashtu kemi zhvilluar ligjëratat vetëdijësuese në shumë shkolla për ndërgjegjësimin e tyre rreth dukurive negative në shoqëri . Besoj se me bashkëpunimin e mirë që kemi me shkolla gjendja e sigurisë do jetë gjithnjë më e mirë .

- **Bashkëpunimi institucional dhe me qytetar**

Stacioni Policor edhe ketë gjashtë mujor ka pas një bashkëpunim të mirë me gjitha institucionet ,ju kemi asistuar shumë institucioneve në kërkesat e tyre drejtuar Policisë si Komunës ,Gjykatave ,KEDS-it Përparimi, me përmbaues etj. Gjatë këtij gjashte mujori kemi zhvilluar takime me Këshillin Komunal për Siguri ne Bashkësi qe udhëhiqet nga Kryetari i Komunës se Vushtrrisë dhe qe ne këtë këshill është një numër i madh i anëtareve te cilët japin kontributin e tyre ne këshilla dhe ne identifikim te problemeve qe i preokupojnë qytetaret. Kemi realizuar edhe takime në nivel të KLSP-ve në Prilluzh dhe Banjsk që funksionojnë në zonën tone te përgjegjësive.



- Polica e Kosovës, respektivisht Stacioni Policor Vushtrri edhe gjatë viti 2022, do të vazhdojë me përkushtimin të lartë të angazhohet në përmbushjen e objektivave Policore për të krijuar një ambient , sa më të sigurt dhe të qetë për të gjithë qytetarët.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUCITRN

<b>DATË</b>	18.7.2022
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Kuvendin e Komunës
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Ilmi Azemi,  Kryesues i komisionit për hartimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Aktpërcjellës

Të nderuar anëtarë të kuvendit,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur, Draft-Statutin e Komunës së Vushtrrisë, i cili është hartuar nga komisioni i themeluar nga Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë.

Statuti i komunës gjendet në fazën finale të shqyrtimit publik dhe të njëjtin ju dërgojmë për shqyrtim dhe aprovim.

**Me respekt!**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUCITRN

**Ekstrakt**

**nga takimet e komisionit për hartimin e statutit të komunës së Vushtrrisë, mbajtur më  
05.06.2022, ora 10:30.**

**Komisioni komunal për hartimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, i themeluar me vendim të Kuvendit të Komunës ka mbajtur disa takime dhe ka vepruar në përbërje të plotë prej: Ilmi Azemi (kryesues i komisionit), Shkëlzen Xhaferi, Nasuf Aliu, Alban Tahiraj dhe Ismet Gashi (anëtarë).**

**Komisioni i sipërcekur ka mbajtur disa takime dhe ka hartuar Draft – Statutin e Komunës së Vushtrrisë.**

**Gjatë këtyre takimeve janë dhënë edhe propozimet e përfaqësuesve të subjekteve politike që kanë qenë në komision lidhur me organizimin e brendshëm të komunës apo drejtoritë komunale.**

**Përfaqësuesi nga LDK-ja, Shkëlzen Xhaferi ka propozuar që numri i drejtorive komunale të mbetet 12 ashtu siç është me statutin aktual në fuqi.**

**Përfaqësuesi nga LVV-ja, Nasuf Aliu ka propozuar që numri i drejtorive komunale të jetë sipas numrit aktual me statutin në fuqi, por mundësi të modifikimit me nevojat e kohës. Propozimi tjetër nga Nasuf Aliu ishte që themelimi i drejtorive komunale të mbetet në kompetencën e kryetarit, që me vendim të veçantë të kryetarit të komunës të përcaktohet numri i drejtorive komunale.**

**Pas votimit, komisioni statutar me votim unanimit aprovuan këtë Draft – statut për t'u proceduar në shqyrtim publik dhe për aprovim final në Kuvendin e Komunës.**

**Bastri Duraku**

**Procesmbajtës**

**Ilmi Azemi**

**Kryesues i Komisionit**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**



**KOMUNA E VUSHTRRIË**  
**OPŠTINA VUČITRN**  
**MUNICIPALITY OF VUSHTRRI**

---

## **KUVENDI I KOMUNËS SË VUSHTRRIË**

### **STATUTI I KOMUNËS SË VUSHTRRIË**

.....2022

**Bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2, pika (a) dhe paragrafi 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, i cili është bazë për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më.....2022, miraton:**

**STATUTIN  
01.Nr ./2022  
E KOMUNËS SË VUSHTRRIË**

**KAPITULLI I  
Dispozitat e përgjithshme**

**Neni 1**

**Përkufizimi**

1. Statuti i komunës (në tekstin e mëtejme Statuti) është akti më i lartë juridik i komunës, që miratohet nga Kuvendi i Komunës në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Statuti është bazë për sigurimin e zbatimit të kompetencave dhe përgjegjësive të komunës, ashtu siç është përcaktuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet tjera.
3. Statuti rregullon kompetencat dhe organizimin e komunës, aktivitetet dhe mënyrën e vendosjes për punët publike, organet e komunës, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të kuvendit, administrimin financiar dhe konfliktin e interesave.

**Neni 2**

**Statusi juridik**

Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, në të cilën qytetarët e saj realizojnë vetëqeverisjen në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera dhe Statutin e komunës.

**Neni 3**

**Selia e komunës**

Selia e komunës gjendet në Vushtrri, rruga "Isa Boletini" nr.10

**Neni 4**

**Festat e komunës**

1. "Dita e Çlirimit të Vushtrrisë" është 17 Qershor 1999. Kjo ditë shënohet çdo vit.
2. "Dita e Dëshmorëve të Kombit", e Komunës së Vushtrrisë është 1 Shtatori. Kjo ditë shënohet çdo vit.
3. Komuna e Vushtrrisë feston edhe festat tjera të parapara me Ligjin për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës.

## **Neni 5**

### **Simbolet komunale**

1. Komuna ka emblemën dhe flamurin e vet. Ato përdoren brenda territorit të saj në pajtim me Ligjin për Simbolet Shtetërore. Simbolet nuk duhet t'ju përngjajnë simboleve të shteteve tjera, apo simboleve të komunave në Republikën e Kosovës ose jashtë saj.
2. Përmbajtja, përdorimi dhe ndryshimi i emblemës dhe flamurit, do të përcaktohet me vendim të posaçëm të Kuvendit të komunës, në pajtim me Ligjin për Simbole Shtetërore.
3. Asnjë subjekt dhe person tjetër përveç komunës, nuk mund ta përdorë emblemën, flamurin dhe shenjat komunale apo simbolet pa autorizim paraprak të dhënë nga Kuvendi i komunës.
4. Simbolet e komunës miratohen apo ndryshohen me 2/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të komunës, pas konsultimit publik gjithëpërfshirës.

## **Neni 6**

### **Vulat**

1. Komuna e Vushtrrisë dhe organet e saj, e kanë vulën e rumbullakët dhe atë katrore.
2. Përmasat, përmbajtja e tekstit, mënyra e mbajtjes dhe përdorimit të vulave, është e përcaktuar me vendim të veçantë të Kuvendit të komunës, në pajtim me Ligjin për Vula.
3. Përmbajtja e tekstit të vulave është e shkruar në gjuhën shqipe dhe serbe.

## **Neni 7**

### **Statusi ligjor i komunës**

1. Komuna e ka statusin e personit juridik, si dhe e ka të drejtën:
  - 1.1. të paditë dhe të paditet në gjykatë;
  - 1.2. të posedojë, të menaxhojë pasurinë dhe të përcaktojë kushtet e menaxhimit dhe shfrytëzimit të saj, nëse nuk është e rregulluar ndryshe me ligj;
  - 1.3. mund të jetë pronare dhe bashkëpronare e ndonjë kompanie që është në interes të komunës në raport me qytetarët;
  - 1.4. të lidhë kontrata;
  - 1.5. të punësojë stafin, dhe
  - 1.6. të angazhohet në aktivitete tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësive të saj.

## **Neni 8**

### **Komuna**

Organet e Komunës së Vushtrrisë, kujdesen që të gjithë qytetarët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë, pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik, apo mendimi tjetër, prejardhjes kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindjeje apo ndonjë statusi tjetër, me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale, në të gjitha nivelet.

## **Neni 9**

### **Marrëdhëniet kontraktuale**

1. Komuna mund të delegojë përgjegjësitë e saj në fusha të caktuara tek komunat tjera, apo të hyjë në marrëdhënie kontraktuese me komunat tjera në Republikën e Kosovës dhe jashtë vendit, në pajtueshmëri me ligjin në fuqi.
2. Vendimin për delegimin e përgjegjësive në fusha të caktuara dhe për bashkëpunim e miraton Kuvendi i komunës.

## **KAPITULLI II**

### **Lagjet urbane, fshatrat dhe vendbanimet**

#### **Neni 10**

#### **Lagjet urbane, fshatrat dhe vendbanimet**

1. Territori dhe kufijtë e komunës janë të përcaktuar në Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave.
2. Territori i Komunës së Vushtrrisë si njësi territoriale përbëhet prej lagjeve urbane, fshatrave dhe vendbanime sipas zonave kadastrale, si në vijim:

Qyteti: Vushtrria dhe fshatrat:

Akrashtica, Balinca, Banjska, Beçiqi, Beçuku, Begaj, Bivolaku, Boshllani, Brusniku, Bukoshi, Cecelia, Dalaku, Dobërlluka, Druari, Duboci, Dumnica e Epërme, Dumnica e Llugave, Dumnica e Poshtme, Galica, Gllavatini, Gojbula, Graca, Gumnishta, Hercegovë, Karaça, Kolla, Kunoviku, Kurillova, Liqej, Lumadhi, Mavraj, Maxhunaj, Mihaliqi, Miraça, Nedakoci, Novolani, Oshllani, Pantina, Pasoma, Pestova, Prelluzha, Rezniku, Ropica, Samadrexha, Sfaraçaku i Epërm, Sfaraçaku i Poshtëm, Skoçani, Skroma, Sllakoci, Sllatina, Smrekonica, Stanoci i Epërm, Stanoci i Poshtëm, Stroci, Studimja e Epërme, Studimja e Poshtme, Shala, Shllivovica, Shtitarica, Taraxha, Tërllobuqi, Vesekoci, Vërnica, Vilanci, Zagora, Zhllivoda.

3. Me vendim të posaçëm të Kuvendit të komunës, mund të përcaktohen lagje, vendbanime periferike dhe vendbanime tjera komunale.
4. Me rregullore të miratuar nga ana e Kuvendit të komunës, do të rregullohet struktura organizative dhe funksionale e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, si dhe mënyra, koha, numri dhe çështje tjera që lidhen me zgjedhjen e përfaqësuesve të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane.

#### **Neni 11**

#### **Kufijtë e komunës**

Ndryshimi i kufijve të komunës, mund të bëhet në pajtim me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave dhe në bazë të aprovimit paraprak nga Kuvendi i komunës.

**Neni 12**  
**Raportet me lagjet urbane, fshatrat dhe vendbanimet**

Komuna, me vendim të Kuvendit për vendbanimet e caktuara, mund të themelojë zyra për kryerjen e shërbimeve të caktuara nga kompetenca e organeve të administratës komunale.

**KAPITULLI III**  
**Kompetencat dhe përgjegjësitë e komunës**

**Neni 13**  
**Kompetencat vetanake**

1. Komuna i ka kompetencat e plota dhe ekskluzive në fushat që vijojnë:
  - 1.1. zhvillimin lokal ekonomik;
  - 1.2. planifikimin urban dhe rural;
  - 1.3. shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
  - 1.4. zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
  - 1.5. mbrojtjen e mjedisit lokal;
  - 1.6. ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të ngrohjes lokale;
  - 1.7. përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
  - 1.8. ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e pagave, trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
  - 1.9. promovimin, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe respektimin e barazisë gjinore;
  - 1.10. ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;
  - 1.11. ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijëror, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e qendrave të përkujdesit, punësimin, pagesën e pagave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
  - 1.12. banim-publik;
  - 1.13. shëndetësin publike;
  - 1.14. licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitetet kulturore dhe aktivitetet e lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportin lokal publik dhe taksitë;
  - 1.15. emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike;
  - 1.16. ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike;
  - 1.17. Turizmin;
  - 1.18. aktivitetet kulturore, rinore, sportive dhe të lira;
  - 1.19. çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është paracaktuar një autoriteti tjetër;
  - 1.20. të gjitha çështjet tjera, të cilat me ligj ose akte nënligjore janë paraparë si kompetenca vetanake të komunës;
2. Komuna e Vushtrrisë, si plotësim i aktiviteteve të përmendura më sipër, ushtron kompetencat e deleguara.



## **Neni 14**

### **Kompetencat e deleguara**

1. Institucionet e Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin, i delegojnë komunës kompetencat vijuese:
  - 1.1. shënimet kadastrale;
  - 1.2. regjistrimin civil;
  - 1.3. regjistrimin e votuesve;
  - 1.4. regjistrimin e biznesit dhe licencimin;
  - 1.5. distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve);
  - 1.6. mbrojtja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës, në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjve, në bazë të rregullave të miratuara nga qeveria.
2. Komuna e Vushtrrisë, ushtron përgjegjësitë tjera shtesë, përveç atyre të cekura në pikën 1 të këtij neni, gjithnjë duke u përkujdesur që kompetencat e deleguara shtesë, të shoqërohen me financim të nevojshëm nga niveli qendror për të përmbushur objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria e Kosovës.

## **KAPITULLI IV**

### **Neni 15**

#### **Organet e komunës**

Organet e komunes janë:

1. Kuvendi i komunës, dhe
2. Kryetari/ja i/e komunës.

### **Neni 16**

#### **Kuvendi i komunës**

1. Kuvendi i komunës, është organi më i lartë në komunë, i cili ushtron funksionin përfaqësues dhe vendimmarrës në pajtim me këtë Statut dhe legjislacionin në fuqi.
2. Kuvendin e komunës e përbëjnë anëtarët e zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët me votim të fshehtë, në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale.
3. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i ka 35 anëtarë.
4. Mandati i anëtarëve të Kuvendit është katër (4) vjet.
5. Anëtarit të Kuvendit të komunës i pushon mandati i anëtarit, në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

### **Neni 17**

#### **Funksionet e Kuvendit të komunës**

1. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të komunës dhe akteve tjera nënligjore.

2. Kuvendi i komunës e miraton dhe ndryshon Statutin e komunës, conform dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
3. Miratimi apo ndryshimi i Statutit të komunës, duhet të aprovohet më së paku me 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të komunës.
4. Kuvendi i komunës e miraton Rregulloren e punës dhe mund ta ndryshojë atë. Vendimi për miratimin apo ndryshimin e Rregullores së punës, aprovohet me shumicë të votave të anëtarëve të Kuvendit të komunës.
5. Kuvendi i komunës ndan dekorata për individë dhe persona juridikë, për kontributet dhe vlerat, rolin e tyre në jetën publike. Me rregullore të veçantë përcaktohen kushtet dhe mënyra e ndarjes së dekoratave, titujve të nderit, mirënjohjeve dhe shpërblimeve.
6. Kuvendi i komunës, vendos lidhur me propozimet për ngritjen e lapidarëve, shtatoreve, pllakave përkujtimore.
7. 1/3 e anëtarëve të Kuvendit me nënshkrimet e prezentuara, mund të fillojnë iniciativën për ngritjen e lapidarëve, shtatoreve, pllakave përkujtimore.
8. Propozues mund të jetë Kryetari i komunës, dhe
9. 10% e qytetarëve me të drejtë vote në Komunën e Vushtrrisë.
10. Vendimi për ngritjen e lapidarëve, shtatoreve, pllakave përkujtimore, merret me votat e 2/3 të anëtarëve të Kuvendit të komunës, votimi në të gjitha rastet bëhet në mënyrë të fshehtë.

### **Neni 18** **Përgjegjësitë**

1. Kuvendi i komunës nuk mund t'i delegojë përgjegjësitë e veta për marrjen e vendimeve lidhur me:
  - 1.1. Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret *dhe aktet tjera* komunale, miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
  - 1.2. miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
  - 1.3. miratimin e çështjeve tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas Statutit apo Rregullores së punës;
  - 1.4. planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
  - 1.5. themelimin e komisioneve të kërkuara sipas LVL-së dhe këtij Statuti;
  - 1.6. zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit komunës;
  - 1.7. nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
  - 1.8. krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
  - 1.9. emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike;
  - 1.10. arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brendakomunale;
  - 1.11. marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës;
  - 1.12. përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj, për marrjen e vendimeve, Kuvendi i komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komitetit përkatës të Kuvendit të komunës, apo Kryetarit/es të komunës. Kuvendi i komunës mund të tërheqë delegimin e pushtetit në çdo kohë;
  - 1.13. caktimin e lokacioneve me interes të përgjithshëm;
  - 1.14. themelimin e komisioneve sipas nevojës (puna në komisione duhet të kompensohet konform vendimit të Kuvendit).

**Neni 19**  
**Aktet e Kuvendit të komunës**

1. Kuvendi i komunës, në kuadër të kompetencave të tij miraton këto akte:
  - 1.1. Statutin e komunës;
  - 1.2. Rregulloren e punës;
  - 1.3. rregulloret komunale;
  - 1.4. çdo akt tjetër të nevojshëm për funksionim efikas të komunës.
2. Aktet e Kuvendit të komunës vlejnë vetëm brenda territorit të komunës.
3. Rregullorja mbi punën e Kuvendit miratohet dhe ndryshohet me votimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit të komunës.
4. Aktet tjera dhe vendimet e Kuvendit të komunës aprovohen nga shumica e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë, nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht me ligj.

**Neni 20**  
**Mbledhja inauguruuese, betimi dhe deklarata solemne**

1. Kuvendi i komunës duhet të mbajë mbledhjen e parë inauguruuese brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.
2. Mbledhja inauguruuese e Kuvendit të komunës, thirret nga Kryetari/ja i/e komunës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.
3. Nëse nuk thirret mbledhja sipas detyrës, në paragrafin 2 të këtij neni, mbledhja inauguruuese thirret nga anëtari/ja më i/e vjetër, i/e zgjedhur i/e Kuvendit të komunës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga data kur Kryetari/ja është dashur të thërrasë mbledhjen inauguruuese të Kuvendit të komunës.
4. Nëse anëtari/ja më i/e vjetër i/e Kuvendit nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës së tij/saj, në paragrafin 3 të këtij neni, mbledhja inauguruuese e Kuvendit të komunës caktohet me iniciativë të shumicës së anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të komunës.
5. Mbledhjet e Kuvendit të komunës, të cilat mbahen para zgjedhjes së Kryesuesit/es të Kuvendit të komunës, kryesohen nga anëtari/ja më i/e moshuar i/e Kuvendit të komunës që është i pranishëm në mbledhje.

**Neni 21**  
**Mandati**

Mandati i çdo anëtari/re të Kuvendit të komunës, verifikohet nga komisioni për verifikimin e mandateve që themelohet nga Kuvendi i komunës, para nënshkrimit të mandatit nga secili këshilltar.

## **Neni 22**

### **Betimi i anëtarëve të Kuvendit**

1. Anëtarët e Kuvendit të komunës duhet të nënshkruajnë betimin solemn si në vijim: "Beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime, e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat, si dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar/re i/e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë".
2. Anëtarët e Kuvendit të komunës, të cilët/at nuk e nënshkruajnë betimin solemn ose mandatin, në pajtim me paragrafin I të këtij neni, brenda një (1) muaji pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, pushojnë të jenë anëtarë.

## **Neni 23**

### **Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të komunës**

1. Kuvendi i komunës e zgjedh Kryesuesin/en e Kuvendit të komunës nga radhët e anëtarëve, me mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të komunës. Propozimista për Kryesues/e të Kuvendit të komunës duhet të ketë një e më shumë kandidatë/e të mundshëm/e për t'u zgjedhur Kryesues/e i/e Kuvendit të komunës.
2. Votimi për Kryesues/se të Kuvendit të komunës bëhet me vota të fshehta. Për t'u zgjedhur në votimin e parë, kandidati i propozuar si Kryesues/e i/e Kuvendit, duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.
3. Në rast se, në votimin e parë asnjëri/ra prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur, do të zgjedhet Kryesues/se i/e Kuvendit të komunës.
4. Nëse edhe pas votimit të dytë, asnjëri/ra nga kandidatët/et nuk e ka fituar shumicën e kërkuar të votave si në paragrafin 3 të këtij neni, shkohet në votimin e tretë. Në votimin e tretë Kryesues/ja i/e Kuvendit të komunës, zgjedhet kandidati/ja, i/e cili/a merr më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë. Nëse edhe pas votimit të tretë nuk zgjedhet Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të komunës, atëherë i tërë procesi i votimit përsëritet me propozimin e kandidatëve tjerë për Kryesues/e të Kuvendit. Kur procesi i zgjedhjes bëhet me votim të fshehur, nuk ka vota të abstenuara, kurse votat e pavlefshme llogariten pjesëmarrje në votim.

## **Neni 24**

### **Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit**

1. Kuvendi i komunës me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Kuvendit të komunës, formon komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit për Kryesuesin/en e Kuvendit, i cili/a përbëhet nga 3 deri në 5 anëtarë të Kuvendit të komunës.
2. Komisioni për votim është përgjegjës që të numërojë votat dhe t'i komunikojë rezultatet e votimit para anëtarëve të Kuvendit të komunës.

## **Neni 25**

### **Nënshkrimi i akteve të Kuvendit**

Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të komunës i nënshkruan të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i komunës dhe

është i/e obliguar të kujdeset për procedimin e tyre, dhe një kopje të aktit të nënshkruar ia dorëzon Kryetarit/es të komunës dhe organeve përgjegjëse për zbatim.

## **Neni 26**

### **Kuorumi, mbledhjet e Kuvendit dhe komiteteve**

1. Kuorumi për të gjitha takimet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij, është së paku gjysma e numrit të anëtarëve të Kuvendit apo komiteteve. Kuorumi duhet të verifikohet para çdo vendimi që merr Kuvendi i komunës.
2. Në të gjitha takimet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij, çdo anëtar, duke përfshirë edhe Kryesuesin e mbledhjes, ka nga një votë, por Kryesuesi e ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë »për«, apo »kundër« një propozimi.
3. Kuvendi i komunës dhe komitetet marrin vendime me votim të hapur, përveç nëse kërkohet ndryshe me këtë Statut dhe me Rregullore të punës së Kuvendit të komunës.
4. Nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht në këtë Statut dhe ligj, vendimet e Kuvendit të komunës aprovohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë.
5. Abstenimet regjistrohen me qëllim të konstatimit të kuorunit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.

## **Neni 27**

### **Mbledhjet e Kuvendit të komunës**

1. Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të komunës i thërret dhe i kryeson mbledhjet e Kuvendit të komunës. Në mungesë të Kryesuesit/es të Kuvendit të komunës, mbledhjen e kryeson anëtari/ja më i/e vjetër i/e Kuvendit të komunës.
2. Kuvendi i komunës mban së paku dhjetë (10) seanca në vit, pesë (5) prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit, siç përcaktohet me Rregulloren e punës.
3. Të gjithë anëtarët e Kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet:
  - 3.1. data e mbajtjes së mbledhjes;
  - 3.2. koha e mbajtjes së mbledhjes;
  - 3.3. vendi i mbajtjes së mbledhjes;
  - 3.4. rendi i ditës për mbledhje;
  - 3.5. materialet e mbledhjes, dhe
  - 3.6. të dhëna tjera që mund të përcaktohen me këtë Statut ose Rregullore të punës.
4. Njoftimi dhe materialet e mbledhjes duhet të respektojnë Ligjin për Gjuhët. I njëjti njoftim duhet t'i shpallet publikut.
5. Njoftimi nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, duhet gjithashtu t'i dërgohet ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale.
6. Në mbledhjen e tyre të parë të çdo viti vijues, Kuvendi i komunës dhe secili komitet duhet t'i caktojë datat në të cilat duhet të mbahen takimet e rregullta gjatë vitit. Mbledhjet plotësuese mund të thirren në çdo kohë. Datat e mbajtjes së takimeve mund të ndryshohen me vendime tjera.

## **Neni 28**

### **Udhëheqja e mbledhjeve**

Mbledhjet e Kuvendit të komunës dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa, thirren dhe mbahen në pajtueshmëri me Rregulloren e punës së Kuvendit. Kryesuesi/ja thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kuvendit të komunës dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa, duke siguruar që të gjithë anëtarët që marrin pjesë në mbledhje, të kenë të drejta të njëjta dhe të barabarta, si dhe të kenë mundësi të marrin pjesë të barabartë në diskutime dhe votim.

## **Neni 29**

### **Transparenca**

1. Mbledhjet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve të Kuvendit të komunës, janë të hapura për publikun, përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjekteve të interesuara, për temat që janë objekt diskutimi, përveç në rastet kur parashihet ndryshe me legjislacionin në fuqi.
2. Në qoftë se Kuvendi i komunës, gjatë punës së tij vendos që për arsye të caktuara me ligj, të përjashtojë publikun në shqyrtimin e ndonjë çështjeje nga seanca e Kuvendit, duhet të marrë vendim me shumicë votash të anëtarëve prezent, për përjashtim të publikut.
3. Kuvendi i komunës nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim, njofton publikun, të paktën 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme.
4. Komitetet obligative nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim, njoftojnë publikun 3 ditë pune para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve.

## **Neni 30**

### **Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të komunës dhe procesverbali**

1. Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të komunës, caktohet me kërkesën e bërë me shkrim, nga më së paku 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të komunës, apo me kërkesë të Kryetarit/es.
2. E drejta për të thirrur një mbledhje të jashtëzakonshme, gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar.
3. Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.
4. Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të komunës, nuk mbahet nëse nuk janë të njoftuar me shkrim të gjithë anëtarët e Kuvendit të komunës dhe publiku, siç kërkohet me Rregulloren e punës së Kuvendit, së paku tri (3) ditë pune para datës të mbajtjes së takimit.
5. Procedurat e njëjta që kërkohen për njoftimin dhe çështjet tjera që zbatohen për mbledhjet e rregullta, zbatohen për mbledhjet e jashtëzakonshme gjithashtu.
6. Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për takimet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.
7. Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve mbahet procesverbali. Procesverbali përmban emrat e anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje, anëtarëve dhe personave tjerë të ftuar, rendin e ditës, esencën e diskutimeve, rezultatin numerik të votimit, si dhe evidentimin e çfarëdo vote që ka dhënë çdonjëri, nëse kërkohet nga anëtari i Kuvendit për propozimet e miratuara apo të refuzuara.
8. Procesverbalin e mban një shërbyes/se civil/e komunal/e, i/e caktuar nga shërbimet e Kuvendit të

komunës. Në konsultim me Kryesuesin/en e Kuvendit të komunës, çdokush ka të drejtë të shikojë procesverbalin dhe të marrë një kopje. Procesverbali mbahet në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve dhe i njëjti duhet të miratohet në takimin e ardhshëm të Kuvendit. Procesverbalet duhet të nënshkruhen nga Kryesuesi/ja i/e mbledhjeve dhe nga zyrtari/ja i/e autorizuar për mbajtjen e procesverbalit.

### **Neni 31**

#### **Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit të komunës**

1. Në pajtim me LVL, anëtari/ja i/e Kuvendit të komunës ka të drejtë:
  - 1.1. të kërkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga Kryetari/ja, nga të emëruarit e tij/saj, dhe Kryesuesit/es të Kuvendit dhe komiteteve. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen me Rregulloren e punës;
  - 1.2. mund të paraqesë vërejtje me shkrim, të cilat i bashkëngjiten procesverbalit;
  - 1.3. mund t'ju drejtohet të pranishmëve në cilindo komision të Kuvendit të komunës, anëtar i të cilit nuk është, por nuk mund të votojë. Ai apo ajo mund t'i propozojë Kryesuesit/es të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është përgjegjësi e komitetit;
  - 1.4. mund të kërkojë nga Kryetari/ja informacione që janë të nevojshme për punën e tij/saj si anëtar/e, nëse nuk është i/e kënaqur me përgjigjen. Ai apo ajo mund të ngritë çështjen në Kuvendin e komunës;
  - 1.5. anëtarët e Kuvendit të komunës, detyrohen të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, të thirrura në mënyrë të rregullt në komisionet ku ata/ato janë anëtarë/e, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të justifikueshme për mungesën e tyre;
  - 1.6. anëtari/ja i/e Kuvendit të komunës, lejohet të mungojë nga vendi i punës për periudha kohore që janë të domosdoshme për kryerjen e punëve të Kuvendit.

### **Neni 32**

#### **Konflikti i interesit i anëtarëve të Kuvendit**

1. Anëtari/ja i/e Kuvendit të komunës, apo anëtari/ja i/e komitetit dhe i komisionit, nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai/ajo, apo ndonjë anëtar i familjes së tij/saj, ka interes personal dhe material.
2. Anëtarët e Kuvendit të komunës, të komiteteve dhe të komisioneve duhet t'i shfaqin të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është prezent.
3. Anëtarët e Kuvendit të komunës, nuk mund të punësohen nga komuna në asnjë pozitë në administratën e komunës dhe në të njëjtën kohë nuk mund të jenë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

**Neni 33**  
**Deklarata financiare**

Në pajtim me LVL, çdo anëtar/e i/e Kuvendit të komunës, para mbledhjes së parë të Kuvendit të komunës, duhet t'i regjistrojë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare, dhe obligohet të shënojë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare, posa ato të ndodhin në regjistrin që e mban Kryetari/ja i/e komunës.

**Neni 34**  
**Pushimi i mandatit të anëtarit të Kuvendit**

1. Anëtar i Kuvendit të komunës, i/e cili/a nuk nënshkruan betimin – deklaratën solemne brenda një (1) muaji pas zgjedhjes, pa arsye, pushon të jetë anëtar i Kuvendit.
2. Nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur, kalon për të jetuar në territorin e një komune tjetër, sipas evidentimit të regjistrimit të gjendjes civile.
3. Nëse anëtar i paraqet dorëheqjen me shkrim nga posti i tij.
4. Nëse anëtar i është dënuar për ndonjë vepër penale dhe është lëshuar urdhri për burgim për gjashtë (6) ose më shumë muaj.
5. Nëse anëtar i Kuvendit të komunës nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht në mbledhjet e Kuvendit të komunës pa arsye.
6. Nëse ai/ajo vdes.
7. Me përfundimin e mandatit.

**KAPITULLIV**

**Neni 35**  
**Komitetet e përhershme**

1. Kuvendi i komunës themelon komitete të përhershme siç janë:
  - 1.1. Komiteti për Politikë dhe Financa, dhe
  - 1.2. Komiteti për Komunitete.

**Neni 36**  
**Komiteti për Politikë dhe Financa**

1. Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet prej nëntë (9) anëtarëve.
2. Të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, duhet të zgjedhen nga radha e anëtarëve të Kuvendit të komunës.
3. Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvendin e komunës.
4. Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, marrjen e raporteve nga kryetari, si dhe dorëzimin e rekomandimeve



në Kuvendin e komunës.

5. Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të reflektojë përfaqësimin gjinor.
6. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve tjera.
7. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa kryesohen nga Kryesuesi/ja e Kuvendit të komunës. Në mungesë të Kryesuesit/es të Kuvendit të komunës, mbledhja kryesohet nga anëtari/ja më i/e vjetër i/e komitetit.

### **Neni 37**

#### **Komiteti për Komunitete**

1. Komiteti për Komunitete mund t'i ketë nëntë (9) anëtarë.
2. Anëtarët e Komitetit për Komunitete, zgjedhen nga Kuvendi i komunës nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të komunës dhe përfaqësuesve të komiteteve pakicë.
3. Komunitetet pakicë në komunë, duhet të kenë përfaqësimin e paraparë me ligjin në fuqi në Komitetin për Komunitete.
4. Përbërja e Komitetit për Komunitete duhet të reflektojë përfaqësimin gjinor.
5. Komiteti për Komunitete përfshin në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit të komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komiteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë, përfaqësohet nga së paku një (1) përfaqësues në Komitetin për Komunitete. Përfaqësuesit e komiteteve joshumicë në komunë, e përbëjnë shumicën e anëtarëve të Komitetit të Komuniteteve.
6. Komiteti i Komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komiteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të komunës, masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komiteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komiteteve brenda komunës.

### **Neni 38**

#### **Komitetet konsultative**

1. Komitetet konsultative janë trupa ndihmës të Kuvendit të komunës, roli i të cilëve është që përmes këtyre komiteteve të garantohet që organet komunale të jenë më transparente, më efikase dhe të japin më shumë llogari qytetarëve.
2. Kuvendi i komunës përveç komiteteve si trupa punuese të tij, me vendim të veçantë mund të themelojë komitete konsultative në pajtim me ligjet në fuqi.
3. Themelimi i komiteteve konsultative në komunë, ka për qëllim që qytetarët dhe grupet tjera të interesit, të marrin pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes për interes publik.
4. Kuvendi i komunës mund të themelojë edhe komitete konsultative ad hoc, për çështje të caktuara, kurse mandati i tyre pushon pas përfundimit të çështjes. Për themelimin e secilit komitet, duhet të votohet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm të Kuvendit të komunës.
5. Anëtarët e komiteteve konsultative, zgjedhen në bazë të konkursit publik për mandat 4 vjeçar. Asnjë anëtar i komitetit këshillëdhënës, nuk mund të shërbejë më shumë se në dy mandate të njëpasnjëshme.
6. Kuvendi i komunës me vendim të posaçëm, cakton numrin e anëtarëve të komiteteve konsultative, numri i të cilëve nuk mund të jetë më tepër se shtatë (7).
7. Për të gjitha çështjet tjera që lidhen me punën e komiteteve konsultative, do të zbatohen dispozitat e

udhëzimeve administrative, me të cilat rregullohet mënyra e organizimit dhe e funksionimit të komiteteve konsultative në komunë.

8. Përbërja e komiteteve konsultative duhet të reflektojë përfaqësimin gjinor.
9. Komitetet në kuadër të kompetencave të veta lidhur me çështjet e caktuara, mund t'i rekomandojnë Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të komunës, shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve përkatëse.
10. Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të çështjeve të caktuara nga kompetencat e tij, ia rekomandon Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe marrjen e vendimeve përkatëse.

### **Neni 39**

#### **Transparenca publike e punës e Kuvendit dhe komiteteve**

1. Mbledhjet e Kuvendit të komunës, komiteteve dhe komisioneve tjera të tij, janë të hapura për publikun.
2. Kuvendi i komunës, komitetet dhe komisionet tjera, mund të vendosin për përjashtimin e publikut nga e tërë apo një pjesë e mbledhjes, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e mediave.
3. Vendimet për përjashtimin e publikut dhe mediave, merren me shumicë të anëtarëve të Kuvendit të komunës, komiteteve ose komisioneve tjera.

### **Neni 40**

#### **Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit të komunës**

1. Të gjithë anëtarët e Kuvendit të komunës kanë të drejta dhe mundësi të barabarta të marrin pjesë plotësisht në punimet e Kuvendit. Kuvendi i komunës siguron që këto të drejta dhe mundësi të parashikohen në Statutin dhe në Rregulloren e tij të punës.
2. Anëtari i Kuvendit të komunës ka të drejtë të kërkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga Kryetari. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen në Statut dhe Rregulloren e punës.
3. Anëtari i Kuvendit të komunës mund të dorëzojë vërejtje me shkrim, të cilat i bashkëngjiten procesverbalit.
4. Anëtari i Kuvendit të komunës mund t'ju drejtohet të pranishmëve në cilindo komision të Kuvendit të komunës, anëtar i të cilit nuk është, por nuk mund të votojë. Ai apo ajo mund t'i propozojë Kryesuesit/es të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është përgjegjësi e komitetit.
5. Anëtari i Kuvendit të komunës mund të kërkojë informacione nga Kryetari, të cilat janë të nevojshme për punën e tij si këshilltar. Nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen, ai apo ajo mund ta ngritë çështjen në Kuvendin e komunës.
6. Anëtari i Kuvendit të komunës lejohet të mungojë nga vendi i punës për periudha kohore që janë të domosdoshme për kryerjen punëve të Kuvendit.
7. Kuvendi i komunës, në pajtim me Statutin e komunës dhe me udhëzimet e nxjerra nga qeveria qendrore, mund t'ju ofrojë kompensim anëtarëve të Kuvendit për punën e tyre në Kuvendin e komunës.
8. Anëtarët e Kuvendit të komunës detyrohen të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e thirrura të kuvendit, në mënyrë të duhur, në komisionet ku ata janë anëtarë, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të justifikueshme për mungesën e tyre.

## KAPITULLI VI

### Neni 41

#### Zgjedhja e Kryetarit/es të komunës

1. Kryetari/ja i/e komunës zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët që kanë të drejtë vote në komunë, në përputhje me Ligjin mbi Zgjedhjet Komunale në fuqi.
2. Kryetari/ja i/e komunës zgjedhet për mandat të njëjtë, sikurse anëtarët e Kuvendit të komunës në pajtim me ligjin.

### Neni 42

#### Betimi i Kryetarit të komunës

1. Në rastin e zgjedhjes, Kryetari/ja i/e komunës e bën betimin apo deklaratën solemne përpara anëtarëve të Kuvendit të komunës.  
Teksti i betimit në vijim:  
"Beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat e mia si Kryetar i Komunës së Vushtrrisë, me nder, besnikëri, paanshmëri, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushte për një jetë të qetë për të gjithë"
2. Kryetari/ja që dështon të jepë betimin brenda një (1) muaji, nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve, e humb mandatin.

### Neni 43

#### Përgjegjësitë e Kryetarit/es

1. Kryetari/ja i/e komunës i zbaton përgjegjësitë në vijim:
  - 1.1. përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj;
  - 1.2. udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj, si dhe mbikëqyr administrimin financiar të komunës;
  - 1.3. ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të komunës apo komiteteve të tij;
  - 1.4. ekzekuton aktet e Kuvendit të komunës;
  - 1.5. emëron apo shkarkon zëvendësit e tij/saj;
  - 1.6. emëron dhe shkarkon *këshilltarët e tij dhe stafin mbështetës*, të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
  - 1.7. organizon punën dhe drejton politikën e komunës;
  - 1.8. propozon rregullore apo akte tjera për miratim në Kuvendin e komunës;
  - 1.9. propozon zhvillimin e komunës, planet rregulluese dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar
  - 1.10. raporton para Kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj, apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i komunës;
  - 1.11. mund të kërkojë që Kuvendi i komunës të shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve;
  - 1.12. aktivitetet tjera që i caktohen me këtë Statut dhe me ligj.

**Neni 44**  
**Aktet e Kryetarit/es të komunës**

Kryetari i komunës merr vendime dhe lëshon urdhëresa brenda fushës dhe kompetencave të tij.

**Neni 45**  
**Përfundimi i mandatit të Kryetarit**

1. Mandati i Kryetarit/es të komunës përfundon;

- 1.1. kur ta kryejë mandatin e tij;
- 1.2. nëse vdes;
- 1.3. nëse jep dorëheqje;
- 1.4. nëse ndërron vendbanimin në komunë tjetër;
- 1.5. nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se 1 muaj, pa arsye;
- 1.6. nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me LVL;
- 1.7. në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon Kryetarin e komunës nga cilësia juridike, dhe
- 1.8. në rast të dënimit për vepër penale, me një urdhër për burgim, për gjashtë (6) muaj ose më tepër.

**Neni 46**  
**Delegimi i kompetencave në mungesë të Kryetarit**

Nëse Kryetari/ja i/e komunës përkohësisht mungon apo përkohësisht nuk është në gjendje t'i kryejë detyrat e tij/saj, nënkryetari/ja i/e komunës me kërkesë të tij ose saj i ushtron funksionet ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit/es të komunës, ndërsa në mungesë edhe të nënkryetarit, Kryetari me autorizim e cakton njërin nga drejtorët e drejtorive t'i kryejë detyrat e tij/saj dhe ushtron funksionet ekzekutive të përditshme, si dhe vepron në emër të Kryetarit/es të komunës.

**Neni 47**  
**Suspendimi dhe shkarkimi nga detyra i Kryetarit/es të komunës**

Kryetari/ja mund të suspendohet dhe shkarkohet sipas procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale

**Neni 48**  
**Konflikti i interesave**

1. Dispozitat e LVL, do të zbatohen në rast të konfliktit të interesit të Kryetarit/es të komunës. Menjëherë pas zgjedhjes së tyre, Kryetari/ja i/e komunës e ndërpreu çdo kontratë apo lidhje që ka, e cila mund ta vë në pikëpyetje aftësinë e tij për kryerjen e përgjegjësisë së tij, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.
2. Me Rregullore të punës të Kuvendit të komunës, mund të parashihen masat që duhet të ndërmerren për të përjashtuar Kryetarin/en nga procedurat e vendimmarrjes dhe në ato administrative, në rast kur ka konflikt interesi.

## **Neni 49**

### **Nënkryetari/ja i/e komunës**

1. Në komunë, Kryetari/ja i/e komunës e ka një nënkryetar/e. Nënkryetari/ja emërohet nga Kryetari/ja për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga Kryetari/ja.
2. Me kërkesë të Kryetarit/es, nënkryetari/ja i ndihmon Kryetarit/es në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit/es në mungesë të tij.
3. Kur posti i nënkryetarit/es mbetet i lirë, Kryetari/ja emëron nënkryetarin/en e ri/re, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas paraqitjes së postit të lirë.
4. Për konfliktin e interesit të nënkryetarit/es, përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale që rregullon konfliktin e interesit për Kryetarin/en e komunës.

## **Neni 50**

### **Kompensimet**

1. IPër punën që e bëjnë për komunën: - Kryetari/ja i/e komunës, nënkryetarët e komunës, kryesuesi/ja dhe zëvendeskryesuesi/ja i/e KK-së, anëtarët e Kuvendit të komunës, anëtarët e komiteteve përkatëse, kompensohen në harmoni me rregullat e përcaktuara nga autoriteti qendror i Kosovës.
2. Lartësia e kompensimit të anëtarëve të komiteteve tjera dhe komisioneve të formuara nga Kuvendi i komunës caktohet me vendim të veçantë të Kuvendit të komunës dhe duhet të jetë ekuivalente me kompensimin që i bëhet komiteteve obligative të KK-së.

## **KAPITULLI VII**

## **Neni 51**

### **Administrata e komunës**

1. Administrata e komunës organizohet në drejtori, ku secila drejtori komunale udhëhiqet nga drejtori/esha. Drejtorët i emëron dhe shkarkon Kryetari i komunës.
2. Komuna e Vushtrisë organizohet në më së shumti 14 (katërmbëdhjetë) drejtori.
3. Kryetari i komunës ka kompetencë ekskluzive në caktimin e numrit të drejtorive maksimum, si në pikën 2 të këtij neni.
4. Obligohet Kryetari i komunës, që me një akt të brendshëm të përshkruajë kompetecat dhe përgjegjësitë e secilës drejtori, duke përfshirë edhe emërtimet e drejtorive.
5. Kryetari i komunës në mbledhjen e parë të Kuvendit të komunës, pas themelimit të drejtorive, prezenton numrin, emërtimin e drejtorive dhe emrat e drejtorëve.

## **Neni 52**

### **Konfliktet e interesit për drejtorët**

1. Çdo drejtor do të përjashtohet nga marrja e vendimeve dhe nga procedurat administrative që kanë të bëjnë me çfarëdo çështjeje, për të cilën ai apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes së tij apo të saj, ka ndonjë interes personal ose financiar.
2. Nga drejtorët kërkohet që të paraqesin me shkrim çdo konflikt interesash, në një regjistër të cilin mban Drejtoria për Administratë dhe personeli.

## **Neni 53**

### **Zyrat komunale**

Përveç drejtorive të komunës, në kuadër të Administratës komunale, ekzistojnë edhe këto zyra dhe njësi:

1. Kabineti i Kryetarit/es.
2. Sektori për punë të Kuvendit të komunës – **Sekretaria**.
3. Njësia për personel.
4. Njësia për të drejtat e njeriut.
5. Njësia e auditimit të brendshëm.
6. Zyra e informimit.
7. Zyra për komunitete dhe kthim.
8. Zyra ligjore.
9. Zyra për barazi gjinore.
10. Zyra për integritet dhe diasporë.

## **KAPITULLI VIII**

### **Financat e komunës dhe procedurat buxhetore**

## **Neni 54**

### **Financat e komunës dhe procedurat buxhetore**

1. Komuna e Vushtrrisë ka buxhetin dhe financat e saj. Buxheti i komunës përbëhet prej të hyrave vetanake, granteve nga Qeveria e Republikës së Kosovës, donacionet dhe të hyrat tjera, të cilat rregullohen me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe aktet tjera.
2. Rregullat, procedurat financiare dhe procedurat e prokurimit të komunës, janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 55**

### **Të hyrat vetanake të komunës**

Komuna mbledh të hyra vetanake në përputhje me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal. Të hyrat planifikohen, përcaktohen, ndryshohen dhe aprovohen nga Kuvendi i komunës në harmoni me ligjin.

**Neni 56**  
**Dëgjimet publike buxhetore**

1. Drejtoria përgjegjëse për financa, është kompetente për koordinimin e përgjithshëm të procesit të buxhetit, duke përfshirë edhe përgatitjen e tij, procesin e konsultimit të brendshëm dhe konsultimit me publikun, në bashkëpunim me Komitetin për Politikë dhe Financa, në pajtim me ligjin dhe udhëzimet e ministrisë së linjës.
2. Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organizon dëgjime publike me qytetarë dhe palët e interesit, duke inkorporuar propozimet e arsyeshme të qytetarëve.
3. KPF-ja në bashkëpunim me Kryetarin e komunës, i rekomandon Kuvendit të komunës për miratim Draft-buxhetin vjetor.

**Neni 57**  
**Raporti vjetor**

Kryetari/ja i/e komunës obligohet që të paraqitë raport të detajuar vjetor në Kuvendin e komunës në afatet ligjore.

**Neni 58**  
**Miratimi i buxhetit**

Kryetari/ja i/e komunës ia propozon Kuvendit të komunës Draft-buxhetin komunal për miratim, në afatin e paraparë ligjor.

**Neni 59**  
**Buxheti i ndërmarrjeve publike lokale**

1. Ndërmarrjet publike lokale, të cilat kryejnë shërbime publike lokale, i dorëzojnë Kuvendit të komunës buxhetin e tyre për miratim. Buxheti i propozuar duhet të përfshijë strukturën e tarifës së propozuar për kryerjen e shërbimeve dhe duhet të dorëzohet deri më 1 dhjetor, para vitit të ardhshëm fiskal.
2. Në rast se një ndërmarrje ofron shërbime publike lokale, për më shumë se një komunë, komuna bën marrëveshje me komunat gjegjëse, për lartësinë e tarifave dhe mbikëqyrjen e përbashkët të veprimtarive të asaj ndërmarrjeje.

**Neni 60**  
**Auditori i brendshëm**

Auditori i brendshëm është i autorizuar dhe ka përgjegjësi në pajtim me dispozitat e Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

**Neni 61**  
**Pasuria e komunës**

1. Komuna ka të drejtë të posedojë dhe menaxhojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.
2. Komuna ka të drejtë të shesë dhe të jepë me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme sipas ligjit, me përjashtim të shitjes së tokës, e cila rregullohet me ligj të posaçëm.
3. Komuna mban dhe udhëheq regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme që e kanë në shfrytëzim

dhe posedim.

4. Kryetari/ja i/e komunës emëron komisione (ad hoc) me qëllim të regjistrimit të pasurisë së tundshme dhe të patundshme të komunës, më së voni një (1) muaj para përfundimit të vitit fiskal.

5. Të drejtën për të emëruar komisionin për regjistrimin e pasurisë e ka Kryetari i komunës.

## **KAPITULLI IX**

### **Neni 62**

#### **Shërbimi civil komunal**

1. Shërbimi civil i komunës udhëhiqet në bazë të parimeve dhe procedurave të përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës.
2. Shërbimi civil komunal, si tërësi duhet që të përmbajë proporcion të drejtë të përfaqësimit të personave me nevoja të veçanta.
3. Të gjithë shërbyesit civil komunal, i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të paanshme dhe të drejtë në pajtim me ligjin, i zbatojnë dhe i përfillin urdhrat e prapë të tyre, përveç rasteve kur detyrat e dhëna janë në kundërshtim me ligjin.

### **Neni 63**

#### **Udhëheqesi i personelit**

1. Administrata e Komunës së Vushtrrisë ka udhëheqësin e personelit.
2. Procedurat për zgjedhjen, rekrutimin dhe largimin e tij i udhëheq Kryetari i komunës në pajtim me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë, brenda afatit ligjor.

## **KAPITULLI X**

### **Neni 64**

#### **Konsultimet me publikun**

1. Komuna mund të shfrytëzojë secilën nga format e konsultimit të shënuara më poshtë (format tjera të konsultimeve sipas nevojës dhe rrethanave):
  - 1.1. fushatat informative dhe të publicitetit për të promovuar aktivitetet dhe programet komunale;
  - 1.2. kontaktet me grupet e interesit, për t'i testuar dhe diskutuar politikat lokale;
  - 1.3. anketat për zbatimin e politikës lokale, duke përfshirë informimin e klientëve dhe qytetarëve që kanë interesa;
  - 1.4. shpalljet publike të propozimeve për politika apo draft-rregulloret, duke thirrur për pjesëmarrje dhe prezentim;
  - 1.5. takimet publike;
  - 1.6. dëgjimet publike;
  - 1.7. studimet për vlerësim të efekteve të implementimit të vendimeve komunale, studime që duhet të bëhen nga komisionet profesionale, të caktuara nga Kuvendi komunal dhe për fushat e rëndësishme të qeverisjes komunale.



**Neni 65**  
**Organizimi i konsultimeve**

Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të komunës, Kryetari/ja i/e komunës, komiteti dhe komisionet e Kuvendit të komunës, kanë autoritet të mbajnë konsultimet publike, për çdo çështje që është në kompetencat e tyre.

1. Në secilin rast duhet të jepet një arsyetim për mbajtjen e konsultave me publikun. Mënyra e cila shfrytëzohet për mbajtjen e konsultave me publikun, duhet të publikohet 14 ditë përpara dhe duhet të lejohet kohë e duhur për përgatitjen e prezentimeve. Rezultatet e konsultimeve duhet të merren parasysh dhe duhet të bëhen publike para së të merret vendimi.

**Neni 66**  
**Takimet me publikun**

1. Takimet me publikun duhet të mbahen në një sallë adekuate për pjesëmarrjen e publikut të interesuar. Kryetari i komunës duhet të mbajë së paku dy takime me publikun në çdo vit kalendarik. Një në gjashtë mujorin e parë dhe një tjetër në gjashtëmujorin e dytë.
2. Përveç takimeve si në paragrafin paraparak të këtij neni, takimet tjera me publikun mund të mbahen për çështje tjera që janë me interes publik, atëherë kur Kryetari i komunës e sheh të arsyeshme.
3. Vendi, data dhe koha e mbajtjes së takimit publik, duhet të shpallet së paku dy javë para mbajtjes së takimit. Takimet publike duhet të mos mbahen në datat apo kohën që në përgjithësi nuk është e përshtatshme për pjesëmarrësit.
4. Përfaqësuesit e mediave duhet të ftohen që të marrin pjesë në të gjitha takimet me publikun.
5. Në takimet publike janë të obliguar të marrin pjesë zyrtarët më të lartë të organeve të komunës si: Kryetari/ja i/e komunës, drejtorët e drejtorive dhe zyrtarët tjerë kompetentë.
6. Nëse bëhet një pyetje në takim publik, e që nuk mund të ketë përgjigje gjatë takimit, parashtruesi i pyetjes mund të kërkojë përgjigje me shkrim në një periudhë prej 30 ditësh, pas ditës së takimit.
7. Për çdo takim publik mbahet procesverbal i cili duhet të ruhet me të gjitha informatat e hollësishme që jepen për komunë, si dhe të gjitha propozimet e bëra nga pjesëmarrësit e takimit publik dhe përgjigjet që janë dhënë në pyetjet e bëra. Një kopje e të gjitha përgjigjeve të dhëna me shkrim, në ndonjë datë të mëvonshme, duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit të takimit.
8. Kërkesat dhe iniciativat e qytetarëve të evidentuara në procesverbalin e mbledhjes publike, Komiteti për Politike dhe Financa dhe Kuvendi i komunës, obligohen t'i shqyrtojnë brenda afatit prej 60 ditësh pas mbajtjes së mbledhjes dhe t'i njoftojë parashtruesit e kërkesave lidhur me vendimin e aprovuar.

**Neni 67**

**Format tjera të konsultimit, pjesëmarrja publike dhe referendumi**

1. Për çështjet e rëndësisë së veçantë, komuna organizon referendum.
2. Organizimi i referendumit bëhet në përputhje me ligjin përkatës.

### **Neni 68**

#### **Peticionet**

1. Secili person fizik dhe juridik apo organizatë që ka interes në komunë, ka të drejtë t'i paraqitë petition Kuvendit të komunës, për cilëndo çështje që lidhet me punën e komunës. Peticioni është kërkesë për Kuvendin, për t'u marrë me çështjet specifike, apo për të miratuar rregullore dhe vendime të caktuara dhe përbën një të drejtë themelore demokratike.
2. Kuvendi i komunës duhet të njohë rëndësinë e petitionit dhe t'i përgjigjet të gjitha pyetjeve dhe kërkesave të përfshira në petition. Peticioni mund të rezultojë gjithashtu me mbajtjen e takimit publik, në të cilin popullata diskuton për çështjet me interes për ta, bashkë me zyrtarët komunal.
3. Të gjitha petitionet mund t'i drejtohen Kuvendit të komunës, Kryetarit/es të komunës, Kryesuesit/es të Kuvendit, komiteteve të Kuvendit apo drejtorive komunale, drejtpërsëdrejti, nëpërmjet postës elektronike ose të shkruar.
4. Kuvendi i komunës nuk do të ketë parasysh asnjë petition që ka të bëjë me çështje që nuk janë kompetencë dhe përgjegjësi e komunës dhe organeve të saj.
5. Secili petition duhet të përmbajë emrin dhe adresën e organizatorit, emrat, numrin e letërnjoftimit dhe adresat e personave që e nënshkruan. Lënda e petitionit duhet të shënohet qartë në çdo faqe të petitionit/ankesës.
6. Kryesuesi/sja i/e Kuvendit në koordinim me Kryetarin/en i/e komunës, do të paraqitë çdo petition para Kuvendit të komunës brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita që pranon petitionin, gjegjësisht në takimin e ardhshëm të radhës të Kuvendit të komunës, nëse në afatin e caktuar nuk është shqyrtuar i njëjti.

### **Neni 69**

#### **Përgjigje në petition**

1. Kuvendi i komunës do të marrë një vendim përfundimtar lidhur me lëndën e petitionit më së largu tridhjetë (30) ditë pasi të bëhet prezentimi i petitionit në Kuvendin e komunës.
2. Vendimi do të arsyetohet dhe do t'i komunikohet me shkrim organizatorit të petitionit.

### **Neni 70**

#### **Iniciativa qytetare**

Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar projekt-rregullore, brenda kompetencave të komunës, për miratim nga Kuvendi i komunës apo me votën e qytetarëve në pajtim me ligjin.

### **Neni 71**

#### **Organizatat jofitimprurëse**

Komuna e Vushtrrisë e përkrah aktivitetin e organizatave jofitimprurëse, aktiviteti i të cilave është ofrimi i shërbimeve në kuadër të përgjegjësisë të përgjithshme të komunës.

Të gjitha këto organizata i përmbahen ligjit në fuqi kur ofrojnë shërbime dhe kur zhvillojnë aktivitet

## **KAPITULLI XI**

### **Neni 72**

#### **Informimi, komunikimi dhe qasja në dokumentet zyrtare**

Organet komunale, obligohen që t'i informojnë qytetarët me shkrim lidhur me kërkesat e tyre, duke komunikuar drejtpërsëdrejti në gjuhën e tyre dhe duke ju lejuar qasje në dokumente zyrtare, në pajtim me ligjet përkatëse dhe aktet nënligjore.

### **Neni 73**

#### **Përdorimi i gjuhëve**

Kuvendi i komunës miraton rregullore, që në mënyrë më të detajuar rregullon përdorimin e gjuhëve brenda territorit të saj, siç përcaktohet me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

### **Neni 74**

#### **Ankesat e qytetarëve**

1. Çdo qytetar mund të parashtojë ankesë në afatin ligjor ndaj vendimit administrativ të organeve të komunës, nëse ai apo ajo mendon se i janë cenuar të drejtat e tij ose saj.
2. Shqyrtimi i ankesave do të bëhet në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe me ligje të veçanta.

## **KAPITULLI XII**

### **Dispozitat përfundimtare**

### **Neni 75**

#### **Procedurat për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës**

1. Iniciativa për hartimin, ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës mund të ndërmerret nga:
  - 1.1. Kryetari i komunës;
  - 1.2. 1/3 e anëtarëve të Kuvendit të komunës, dhe
  - 1.3. 15% e qytetarëve të komunës me të drejtë vote.
2. Propozimi për ndryshimin e Statutit të komunës duhet t'i dërgohet Kuvendit të komunës për shqyrtim fillestar. Kuvendi i komunës para shqyrtimit final, duhet ta konsultojë publikun në lidhje me atë propozim, ku afati për konsultim me publikun nuk mund të jetë më i shkurtë se 14 ditë dhe as më i gjatë se 30 ditë.
3. Nisma për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës me shumicën e anëtarëve të Kuvendit që janë prezent dhe votojnë.
4. Pas përfundimit të periudhës së konsultimit, Kuvendi i komunës, duhet të vendosë se a do ta miratojë Statutin me ndryshime, pas shqyrtimeve të të gjitha vërejtjeve të marra.
5. Kuvendi i komunës, në rastin e marrjes së vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës dhe akteve tjera në kompetencë të Kuvendit të komunës, emëron një komision kompetent, i cili do të jetë i balancuar në aspektin profesional, politik, etnik dhe gjinor.

**Neni 76**  
**Konflikti i dispozitave**

Në rast kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave të këtij Statuti me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dispozitat e ligjit do të mbizotërojnë.

**Neni 77**  
**Dispozitat shfuqizuese**

Pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti, pushojnë të vlejnë dispozitat e Statutit të Komunës së Vushtrrisë 01.Nr.58/11, i datës 28.4.2011.

**Neni 78**  
**Hyrja në fuqi**

Me aprovimin e këtij Statuti, të gjitha aktet tjera të komunës do të harmonizohen brenda gjashtë (6) muajve me Statutin në fuqi.

**Neni 79**  
**Interpretimi i Statutit**

Interpretimin autentik të dispozitave të këtij Statuti e bën Kuvendi i komunës.

**Neni 80**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Statut hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare, në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesja e Kuvendit

\_\_\_\_\_  
Melihate Basholli Latifi










Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022



# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrrisë (VU), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Vushtrrisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Llogaritë e Arkëtueshme janë nënvlerësuar për 199,290€. Nga kjo vlerë salldot në taksën për inkasimin e mbeturinave janë nënvlerësuar për 158,692€ poashtu salldot nga shfrytëzimi i pronës publike janë nënvlerësuar për 40,598€.
- A2 Keqklasifikimi i shpenzimeve nëpër kategoritë ekonomike, ishte në vlerë 148,241€: prej tyre 94,601€ nga kategoria e Investimeve Kapitale janë paguar Mallra dhe Shërbime dhe 53,640€ nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve janë paguar Subvencione dhe Transfere.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Vushtrrisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A3 Mos-vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit konform periudhës së zbatimit të kontratës në vlerë 303,273€.
- A4 Angazhimi i punonjësve pa procedura për shërbime të veçanta në vlerë 150,071€.
- A5 Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor në vlerë 90,357€.
- A6 Vlerësimi i tenderit për zgjerimin e rrejtit të ndriqimit publik, në vlerë të kontratës 94,121€, ishte përzgjedh kompania që nuk ka plotësuar kriterin për inxhinjer të elektroteknikës të drejtimit tensioni i ulët.
- A7 Pranimi i shërbimeve para krijimit të urdhërblertes në vlerë 37,908€, ishin jo në pajtim me rregullën financiare nr.01/2013.
- A8 Në kontratën për kryerjen e shërbimeve komunale, janë paguar 5,368€ më shumë se sa shuma mujore e përcaktuar me marrëveshje.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Vushtrrisë.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Vushtrrisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Vushtrrisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Vushtrrisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Vushtrrisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë këtu kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Procesi i raportimit në komunë është përcjellur me mangësi, kjo është vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së PFV-të të cilat kishin edhe gabime tjera, të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe pas sugjerimeve tona janë bërë korrigjimet e mundshme. Megjithatë çështjet që ndërlidhen me Llogaritë e Arkëtueshme (LI.A) dhe Keqklasifikimet, janë paraqitur jo saktë dhe drejtë në PFV. Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i shqyrtojmë këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 21 rekomandime, prej tyre dymbëdhjetë (12) janë rekomandime të reja dhe 9 rekomandime të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja A1 - Shpalosje jo e saktë e vlerës së llogarive të arkëtueshme në PFV

##### Gjetja

Sipas Rregullores së MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, citon që OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.

- Bazuar në PFV dhe shënimeve për të arkëtueshmet kemi identifikuar se:
- Saldot e LI.A për taksën për inkasimin e mbeturinave është nënvlerësuar për 158,692€; dhe
- Saldot e LI.A nga shfrytëzimi i pronës publike janë nënvlerësuar për 40,598€.

Kjo ka ndodh pasi që zyrtarët përgjegjës për menaxhimin e LI.A nga taksa për inkasimin e mbeturinave, i kanë paraqitur në PFV lirimet nga taksa për raste sociale të cilat i kanë zbritur nga sistemi manualisht, përderisa në sistemin që menaxhohet nga komuna, faturimi është evident. Kjo ka shkakuar mospërputhje mes PFV dhe shënimeve të Komunës. Si dhe mosvendosja e mekanizmave adekuate për harmonizimin e regjistrave nga drejtoritë përkatëse me ZKF- në.

##### Ndikimi

Dobësitë e identifikuar në shpalosjet e llogarive të arkëtueshme, ndikojnë në prezantimin e informatave jo të sakta për vlerën e tyre në PFV, të cilat mund të kenë ndikim negativ në vendimarrjen e menaxhmentit dhe jo transparencë ndaj palëve të interesit.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për Llogaritë e Arkëtueshme në mënyrë që prezantimi i tyre në Pasqyra Financiare Vjetore të jetë i saktë dhe i drejtë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A2 - Keqklasifikim i shpenzimeve**

**Gjetja** Ligji Nr. 07/L-041 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, si dhe plani kontabël definojnë qartë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike. Gjithashtu UA Nr. 19/2009 për planin kontabël, neni 8.1 dhe 8.3 kanë përcaktuar qëllimin dhe strukturën e planit kontabël, si dhe klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të cilat duhen të bëhen sipas kodeve dhe kategorive të caktuara ekonomike.

Në katër mostrat e testuara nga kategoria e Investimeve Kapitale në vlerë 94,601€, kemi identifikuar se janë keqklasifikuar shpenzimet për këtë kategori. Këto shpenzime janë paguar nga kategoria e Investimeve Kapitale, përderisa janë pajisje nën 1,000€ që i takojnë kategorisë Mallra dhe Shërbime.

Në pesë mostrat tjera të testuara nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve në vlerë 53,640€, kemi identifikuar se shpenzimet që janë paguar nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve, për shpenzime të varrimit për qytetarët në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit, i takojnë kategorisë Subvencione dhe Transfere.

Keqklasifikimi ka ndodh për shkak të planifikimit jo adekuat të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike.

**Ndikimi** Klasifikimet ekonomike jo të sakta prezantojnë pamje jo të drejtë të shpenzimeve në PFV, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategorinë ekonomike të shpenzimit, dhe nuk pasqyrojnë drejtë informacionet për kategoritë përkatëse të shpenzimeve.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuate.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A3 - Mos-vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit konform periudhës së zbatimit të kontratës

**Gjetja** Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, neni 30 përcakton:  
 “Siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmbushjen e kontratës. Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës. Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës”. Po të njëjtin obligim ligjor komuna e kishte përfshirë edhe te kushtet e veçanta të kontratave.

Në tre mostra të identifikuara të vonesave në kryerjen e punimeve, zyrtarët përgjegjës, përkatësisht zyra e prokurimit nuk kishte kërkuar vazhdimin e sigurimit të ekzekutimit të kontratës, përkundër që siguria e ekzekutimit kishte skaduar akoma pa përfunduar projektin:

- "Kontrata në vlerë 49,737.80€, për rregullimin e oborreve dhe hapësirave të QMF-së- Vushtrri, e datës 17.06.2021;
- "Kontrata në vlerë 113,606€, për renovimin e stadiumit të hendbollit Musa Abazi- Vushtrri e datës 23.07.2021"; dhe
- "Kontrata në vlerë 139,929.70€, për rregullimin e hapësirës publike- Një ecje në histori e datës 10.06.2021".

Një situatë e tillë kishte ndodhë si pasojë që zyra e prokurimit si dhe menaxherët e kontratave kishin neglizhuar rëndësinë e sigurisë së ekzekutimit.

**Ndikimi** Mungesa e sigurisë së ekzekutimit përveç që është anashkalim ligjor, rrit rrezikun që autoriteti kontraktues të mos ketë mbulesë për dëmet dhe shpenzimet eventuale të mundshme që mund të rrjedhin gjatë periudhës së shtyrë për implementimin e këtyre kontratave.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës, se sigurimi i ekzekutimit duhet të ketë vlefshmëri në raport me periudhën e përmbushjes së kontratës ashtu siç parashihet me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A4 - Angazhimi i punonjësve pa procedura për shërbime të veçanta

**Gjetja** Ligji për zyrtarët publik nr. 06/L-114, neni 84 - përcakton se marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik. Sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent/kontraktorët individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit.

Komuna në vitin 2021 kishte angazhuar 141 persona me marrëveshje për shërbime të veçanta për periudhën nga tetori deri në dhjetor 2021.



Bazuar në shënimet e Thesarit, për shërbime të veçanta janë paguar në vlerë të përafërt 150,071€. Ne kemi testuar tre mostra dhe kemi identifikuar se komuna nuk kishte zhvilluar procedura të prokurimit publik për angazhimin e tyre. Kontratat e nënshkruara mes komunës dhe të angazhuarve kryesisht ishin për pozita të rregullta të punës (jo specifike) si për infermier, zyrtar për leje ndërtimore, për mirëqenie sociale etj.

Ky staf ishte angazhuar pasi që kishte mangësi në sistemin për aplikimin e procedurave të përcaktuara ligjore për punësimin e stafit për pozita të rregullta të aprovuara me planin e personelit, si dhe për shkak të mungesës së stafit gjatë pandemisë, për plotësimin e shërbimeve komunale.

#### **Ndikimi**

Anashkalimi i procedurave të prokurimit në lidhje me mbulimin e pozitave për shërbime të veçanta, përveç mosrespektimit të procedurave ligjore po ashtu e rritë edhe rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita dhe detyrat e caktuara, çka mund të reflektoj edhe në performancën e tyre në punë.

#### **Rekomandimi A4**

Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbush detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A5 - Mos pagesa e faturave brenda afatit 30-ditë**

#### **Gjetja**

Me nenin 39 të LMFP, kërkohet që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e realizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Nga pesë mostrat e testuara (fatura) një nga këto nuk ishte paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vlera e faturave të cilat nuk janë paguar brenda 30 ditëve në PFV është 90,358€.

Shkaku i mos pagesave me kohë janë kontrollet e dobëta në menaxhimin e borxheve dhe menaxhimin e buxhetit.

#### **Ndikimi**

Mos pagesa e obligimeve brenda afatit ligjor rritë mundësinë që furnitorët të drejtohen përmbaresve dhe gjykatave ku krijojnë shpenzime shtesë për buxhetin e komunës.

#### **Rekomandimi A5**

Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë që të gjitha obligimet të paguhet në afatin ligjor prej 30 ditësh.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A6 - Përzgjedhja e Operatorit Ekonomik të përgjegjshëm**

**Gjetja** Bazuar në LPP, neni 59.4, përcakton se autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Dosja e tenderit e datës 16.07.2021 për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik, me numër prokurimi VU644-21-4632-5-2-1 tek pjesa Kapaciteti teknik dhe professional, kërkohet, një Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës apo master, 3 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi Tension i Ulët).

Në procedurat e tenderit për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik, kontratë e nënshkruar me datë 30.09.2021 me vlerë 94,121€, OE që ka fituar tenderin nuk ka dëshmi se ka ndonjë inxhinjer të elektroteknikës të drejtimit tensioni i ulët.

Bazuar në këtë, ne kemi vërejtur se nuk janë përmbushur kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, për të cilat komisioni i vlerësimit të ofertave kishte vlerësuar si të përgjegjshëm duke rekomanduar nënshkrimin e kontratës.

Kjo ka ndodh si rezultat i kontroleve të brendshme jo efektive në procesin e vlerësimit të tenderëve konform kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

**Ndikimi** Përzgjedhja e OE fitues që nuk përmbush kriteret e përcaktuara me njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, rezulton me shpërblimin e OE në kundërshtim me kërkesat ligjore. Kjo mund të rrezikojë cilësinë e shërbimeve dhe arritjen e objektivave të parapara në projekt.

**Rekomandimi A6** Kryetari duhet të sigurojë kontrole në procesin e vlerësimit të ofertave, në mënyrë që përzgjedhja e fituesve të bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja A7 - Pranimi i shërbimeve para krijimit të urdhërblerjes**

**Gjetja** Rregulla financiare nr. 01/2013- Shpenzimi i parave publike, neni 22- procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjell faturën për pagesë.

Në tre pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë 37,908€, kemi identifikuar se paraprakisht është pranuar fatura pastaj është krijuar urdhërblerja.<sup>4</sup>

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos funksionimit të mirë të kontrollit të brendshëm.

**Ndikimi** Pranimi i shërbimeve para krijimit të urdhërblerjes, mund të rezultojë me shërbime apo furnizime pa kërkesë nga njësia përkatëse, të cilat njëkohësisht mund të jenë jo të përshtatshme në kohë si dhe mund të

ndikojnë në vonesa në pagesën e faturave.

**Rekomandimi A7** Kryetari duhet të sigurojë përmes personave përgjegjës që të ndjekin hapat për procedimin e pagesave të përcaktuara me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A8 - Shërbimet e pranuar jo në pajtueshmëri me marrëveshjen**

**Gjetja** Në marrëveshjen numër 542/21 me vlerë mujore 45,850€ të datës 17.05.2021 për kryerjen e shërbimeve komunale në komunën e Vushtrrisë, në pikën 2, mirëmbajtja - pastrimi i objekteve të institucioneve publike të komunës është e përcaktuar, që nga kjo vlerë të paguhet për pastrimin e objekteve për 21,350€ dhe sigurimin fizik të objekteve për 24,500€.

Për kryerjen e shërbimeve komunale në Komunën e Vushtrrisë janë identifikuar pagesa më tepër se marrëveshja në vlerë 5,368€. Këto gabime janë identifikuar:

- Në tre pagesat në vlerë 49,518€ të datës 30.08.2021, për mirëmbajtjen e pastrimit dhe sigurimin fizik të objekteve, komisioni mbikëqyrës ka pranuar më tepër shërbime në vlerë 3,668€ për një muaj; dhe
- Në pagesën në vlerë 15,403€ të datës 16.12.2021, janë paguar shpenzime jo në përputhje me marrëveshjen për ujitjen e drunjëve dekorativ është paguar më tepër për 1,700€<sup>5</sup> se sa ishte e paraparë në marrëveshje.

Mungesa e sistemit të kontrolleve ka rezultuar që të bëhen pagesa jo sipas çmimeve dhe shërbimeve të përcaktuara me marrëveshje.

**Ndikimi** Pagesat për shërbimet e papaparara me marrëveshje dhe pagesa me çmime me të larta se sa ato të parapara ndikojnë në rritjen e shpenzimeve dhe keqmenaxhimin e buxhetit.

**Rekomandimi A8** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm që të gjitha pagesat të bëhen në pajtueshmëri me kontratën.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Vushtrrisë në 2021 ishin 2,668,067€, me një rritje prej 27% krahasuar me vitin paraprak. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga taksa për grumbullimin e mbeturinave, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte edhe të hyra të arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës, si në vijim: gjobat në trafik 359,274€, dhe gjobat nga gjykatat 17,850€.

#### Çështja B1 - Dobësi në procesin e veprimtarive inspektuese të pronave

- Gjetja** Sipas ligjit Nr.06/L-005-“Për pronën e Paluajtshme”, neni 15 “Inspektimi” pika 2, përcakton se “Veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzet përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës”. Komuna për vitin 2021 nuk ka arrit të kryej inspektimin e 20% të pronave të regjistruara, ku prej 23,526 të pronave, gjatë vitit 2021 ka inspektuar vetëm 969 prej tyre, apo 4.11%. Shkaku për këtë ka qenë pandemia globale, si dhe vështirësive në organizimin e aktiviteteve dhe stafit.
- Ndikimi** Mos verifikimi i objekteve mund të rezultojë me mangësi të informacionit aktual rreth bazës së tatimit në pronë dhe mund të ndikojë negativisht në vlerësimin e tatimit në pronë.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë mekanizma efektiv për inspektimin e kuotës së përcaktuar prej 20% të objekteve siç kërkohet me ligjin e ri, si dhe të rrisë kontrollin e menaxhimit të punëve në teren.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B2 - Mangësi në menaxhimin e të dhënave nga tatimi në pronë

- Gjetja** Ligji Nr.06/L-005 Për tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11 përcakton se zbritja për vendbanimin parësor, “Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000)€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit”. Nga testimi i katër mostrave, në dy prej tyre kemi identifikuar se është bërë nën-faturim në vlerë prej 90€<sup>6</sup>, për arsye se Komuna i ka lejuar zbritjet për vendbanimin parësor në të gjitha pronat që i kanë poseduar; Nga testimi i katër mostrave, në dy prej tyre kemi identifikuar se është bërë mbi-faturim në vlerë prej 45€<sup>6</sup>, sepse nuk ju ka bërë tatimpaguesit zbritja adekuate e vendbanimit parësor të një prone (objekti).

Kjo ka ndodhur si shkak i kontrolleve të dobëta në këtë fushë lidhur me përditësimin e informacionit të tatimpaguesve në sistem.

**Ndikimi**

Dobësitë e identifikuar lidhur me menaxhimin e të dhënave të tatimit në pronë, respektivisht mospërditësimi i informatave të tatimpaguesve, ndikon në nënvlerësimin/mbivlerësimin e bazës tatimore.

**Rekomandimi B2**

Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në departamentin e tatimit në pronë, në mënyrë që të dhënat në sistemin ProTax të jenë të harmonizuara me rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme të Komunës dhe me ligjin, dhe të gjitha rastet e tilla të korrigjohen.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3.2 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere në 2021 ishte 1,007,005€, prej të cilave ishin shpenzuar 836,871€ apo 83%. Ato janë dhënë për entitete publike dhe jopublike dhe kanë të bëjnë kryesisht me përkrahjen e sektorit të bujqësisë, kulturës, sportit dhe aktiviteteve tjera në kuadër të komunës.

### Çështja A9 - Mangësi në raportim të implementimit të projektit të subvencionuar

#### Gjetja

Bazuar në memorandumit e mirëkuptimit ndërmjet organizatës ndërkombëtare humanitare Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland e V (ASB), pika A, përcakton se projekti do të zgjasë deri me 31 dhjetor 2021. Poashtu pika D përcakton se ASB obligohet që në fund të projektit të përgatisë një raport me të dhënat e përfituesve si dhe një pasqyrë financiare, ku paraqiten shpenzimet e kontributit komunal. Rregullorja 04/2017-mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 24, pika 2, përcakton se "Ofruesit e mbështetjes financiare kanë për detyrë të bëjnë monitorimin e rregullt dhe të drejtpërdrejtë të mbështetjes financiare publike për OJQ-të, me qëllim që ajo të jetë në linjë me kërkesat e Rregullores, dhe të arrijë qëllimin për të cilin është ofruar mbështetja financiare publike".

Në projektin për "Mbështetje të integruar Socio-ekonomike për familjet shumë të prekura" me vlerë 12,000€, i cili duhej të përfundonte me 31.12.2021, nuk kishte raportim sipas memorandumit, pika D, ku përcakton se ASB obligohet që në fund të projektit të përgatisë një raport me të dhënat e përfituesve si dhe një pasqyrë financiare, ku paraqiten shpenzimet e kontributit komunal.

Në projektin për "Për përkrahje financiare për klubin e futbollit Vushtrria", me vlerë 45,000€, e aprovuar me vendimin e kuvendit komunal, për këtë shpenzim komuna nuk kishte përcaktuar monitorimin e rregullt dhe të drejtpërdrejtë të mbështetjes financiare publike, ku si pasojë e kësaj nuk kishte raporte kthyese.

Kjo situatë ka ndodhur për shkak të neglizhencës nga ana e zyrtarëve përgjegjës të komunës.

#### Ndikimi

Mungesa e kontrolleve në monitorimin dhe raportimin për projektet e financuara nga komuna, ndikon në shpenzimin e mjeteve për qëllime tjera që nuk janë të paraqitura me memorandum dhe ekspozimin e pa rregullsisve të shpenzimit të fondeve publike.

#### Rekomandimi A9

Kryetari duhet të sigurojë që zyrtari përgjegjës për monitorim dhe zbatim të projekteve të subvencionuara, zbaton të gjitha procedurat e kontrollit, për raportimin e tyre që të arrijnë të arsyetojnë shpenzimet sipas memorandumit, dhe monitorimeve apo raportimeve sipas kërkesës së rregullores përkatëse.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja A10 - Mungesa e planit vjetor të mbështetjes financiare të OJQ-ve**

**Gjetja** Rregullorja 04/2017-mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 6, ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës.

Komuna edhe pse me Buxhet të Kosovës ka parapa që gjatë vitit 2021 të ofrojë mbështetje financiare për projektet dhe programet e OJQ-ve, megjithatë nuk ka përmbushur kërkesën ligjore për përgatitjen e Planit Vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve.

Mungesa e llogaridhënies në nivelin e duhur nga menaxhmenti për menaxhimin e mirefilltë të subvencioneve ka ndikuar në mospërgatitjen e planit vjetor për mbështetje financiare.

**Ndikimi** Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve, paraqet mungesë të informatave se cilat fusha do përkrahën nga Komuna, si dhe qëllimet se për çfarë janë të parapara këto mjete.

**Rekomandimi A10** Kryetari duhet të sigurojë se personat përgjegjës përgatitin Planin Vjetor për Mbështetje Financiare për OJQ-të dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregullore për Mbështetje Financiare.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B3 - Mangësi në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për subvencion**

**Gjetja** Rregullorja 04/2017-mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 4, përcakton se duhet të bëhet trajtimi i barabartë dhe mos diskriminimi i aplikuesve si dhe gjithëpërfshirja gjinore e përfituesve. Thirrja për aplikim e datës 07.05.2021 për furnizim me pajisje për bletë, pika II përcakton numrin maksimal prej 80 pikëve.

Përzgjedhja e përfituesve të subvencioneve të datës 02.08.2021, kishte rezultuar me parregullsi në trajtmin e përzgjedhjes së aplikuesve.

Kemi identifikuar se në dy raste<sup>7</sup>, komisioni i vlerësimit ka shpallur fitues aplikantët përkundër që nuk kishin plotësuar kriteret për tatimin në pronë. Në anën tjetër përkundër që aplikanti kishte plotësuar kriteret, nuk ishte në listën e përfituesve.

Për më tepër, pikët e vendosura në listën e përfituesve nuk ishin të harmonizuara me pikët në vlerësimin e aplikacioneve.

Kjo ka ndodh si rezultat i mungesës së kontrolleve adekuate nga zyrtarët përgjegjës gjatë vlerësimit të aplikuesve.

**Ndikimi** Mungesa e kontrolleve adekuate lidhur me procesin e vlerësimit të aplikantëve, ka ndikuar në eliminimin e aplikuesit i cili është vlerësuar me më shumë pikë se aplikuesi që është përfitues.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës që procesi i

vlërësimin të aplikuesve për subvencione të jetë i saktë dhe i drejtë bazuar në dëshmitë për kriteret.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



### 2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,074,473€, prej të cilave ishin shpenzuar vetëm 3,438,148€ apo 68%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtim dhe rregullim të infrastrukturës rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtimin e shkollave dhe parqeve, shpronësime dhe blerje të pajisjeve.

#### Çështja A11 - Pagesa e TVSH-së jo në pajtim me kontratën

**Gjetja** Kontrata e datës 10.06.2021 për rregullimin e hapësirës publike, bashkfinancim me UN-Habitat, neni 2.4 i kontratës potencon se UN-Habitat përjashtohet nga TVSH, ku me rastin e faturimit fatura të jetë me TVSH por pagesa të bëhet pa TVSH.

Në pagesën për ndërtimin e rrugëve me bashkfinancim në situacionin e dytë në vlerë 57,142€, është identifikuar se pjesa e shpenzimit nga fondi 60 -UN Habitat në vlerë 14,775€ ishte paguar komplet, përkundër që TVSH-ja në vlerë 2,253€ nuk do duhej të paguhej.

Kjo ka ndodhur për arsye të mbikëqyrjes së pamjaftueshme nga zyrtarët përgjegjës, gjatë ekzekutimit të pagesave.

**Ndikimi** Dobësitë e identifikuar lidhur me pagesën e TVSH-së jo në pajtim me kontratën, ka shkaktuar shpenzime shtesë të buxhetit.

**Rekomandimi A11** Kryetari duhet të sigurojë përmes personave përgjegjës vendosjen e kontrolleve shtesë gjatë procedurave të pagesave për të siguruar se pagesat ekzekutohen në pajtim me kushtet e kontratës.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja A12 - Mangësi në shpenzimin e Investimit përmes përmbauesit privat

**Gjetja** Regulla financiare 01/2013, neni 38-Pagesat e vendimeve përmbauese të gjykatave, neni 1.1, përcakton se kur një gjykatë nxjerr urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrorit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave. Poashtu sipas nenit 41- Pagimi i faturave dhe kërkesave për pagesë, pika 1. Organizata buxhetore duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e mallrave dhe shërbimeve të pranuar ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës.

Në propozimin për përmbaues të datës 03.08.2021 nga përmbauesi privat, për punët e pranuar nga komuna në vlerë 50,220€ të datës 11.05.2021, komuna nuk kishte ushtruar ankesë, përkundër që fatura nuk kishte dëshmi se është pranuar në komunë për pagesë. Me datë 08.09.2021 përmbauesi kishte dhënë urdhër për transfer të mjeteve në Ministrinë e Financave, ku shpenzimi kryesor plus shpenzimet përmbauesore kanë arritur në vlerë 53.007€. Komuna vetëm për shpenzime përmbauesore ka paguar 2,787€.

Kjo ka ndodh pasi që fillimisht fatura e OE nuk ishte pranuar në komunë. Për shkak të neglizhencës nga zyrtarët përgjegjës, zyra ligjore nuk kishte

ushtruar ankesë për mos ekzekutimin e pagesës.

**Ndikimi** Dobësitë e identifikuar lidhur me shpenzimet e përmbaruesit privat e dëmtojnë buxhetin komunal, duke krijuar shpenzime të paplanifikuara të projektit.

**Rekomandimi A12** Kryetari duhet të sigurojë që zyra ligjore në kordinim me drejtoritë të analizojnë shkresat nga përmbaruesi, aty ku ka dëshmi për prapësim të veprjës me kohë.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B4 - Mungesa e projektit ekzekutues**

**Gjetja** Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik neni 20.10, përcakton që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten. Ndërsa pika 13 "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Kemi identifikuar se në pesë (5) mostra të testuara për kontrata pune, komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë. Mungesa e projekteve ekzekutuese kryesisht ishte te: "Rregullimi i hapësirës publike Një Ecje në Histori"; "Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica&Vushtrri"; "Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe 13 fshatra-Lot 1"; "Rehabilitimi i zhveshtoreve në terrenin në fushën e sportit"; "Asfaltimi i rrugëve lokale në 14 fshatra-Lot 2".

Kjo ka ndodh pasi që kontrata për hartimin e projekteve që ka pas komuna, ishte përmbushur me 25.02.2020. Deri tani komuna nuk ka lidhur kontratë të re për shkak të ankesave të njëpasnjëshme nga OE.

**Ndikimi** Mungesa e projekteve ekzekutuese dhe inicimi i procedurave për projekte kapitale vetëm me paramasë dhe parallogari, rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B5 - Vonesa në realizimin e kontratave****Gjetja**

Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimit Publik, pikat 61.6, 61.19 dhe 61.20 përcaktojnë se: “Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Nga pagesat e testuara kemi evidentuar vonesa deri në 6 muaj në realizimin e shtatë (7) kontratave, të cilat është dashur të përfundonin në vitin 2020/2021. Vonesat kanë të bëjnë me projektet për:

- Rehabilitimin e zhveshtores në terrenin në fushën e sportit Dobërllukë (29,842€), e datës 16.08.2021;
- Asfaltimin e rrugëve në 12 fshatra (346,619.70€), e datës 03.09.2019;
- Renovimin e shkollës Eqrem Qabej (26,084€), duhej të fillonte me 09.08.2020;
- Rregullimin e oborrit dhe hapësirës QMF-Vushtrri (49,737.80€), e datës 17.06.2021;
- Renovimin e stadiumit të hendbollit Musa Abazi-Vushtrri (113,606€), e datës 23.07.2021;
- Rregullimin e hapësirës publike-Një ecje në histori (139,929.70€), e datës 10.06.2021;
- Pajisje mjekësore (25,000), e datës 11.03.2021.

Duhet theksuar se në asnjërin prej këtyre rasteve nuk kishte kërkesë/aprovim për zgjatjen e afatit për realizimin e kontratave, siç përcaktohet në nenin 18 të dosjes standarde të tenderit. Po ashtu, nuk kishte aplikim të penaleve.

Shkaqet e vonesave kryesisht ishin për shkak të menaxhimit jo adekuat të komunës lidhur me problemet pronësore, specifikave të punëve, pa përgjegjshmërisë së OE, kushteve atmosferike etj. Ndërsa, mos formalizimi i vonesave ishte për shkak të neglizhencës së menaxherëve të kontratave lidhur me kërkesat ligjore.

**Ndikimi**

Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore për buxhetin e vitit pasues. Kjo po ashtu ndikon në performancën dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës.

**Rekomandimi B5**

Kryetari duhet të sigurojë që mos të fillohen projektet pa u siguruar çështjet pronësore, hartimit të specifikave adekuate të projekteve dhe se menaxherët e kontratave për çdo raport të punëve të sqarojnë arsyet e vonesave. Po ashtu, për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen penalet e parapara me kontratë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale ishte 113,626,022€, pasurive jokapitale është 449,769€, ndërsa vlera stoqeve 1,123€.

#### Çështja B6 - Mangësi në regjistrin kontabël të pasurive

**Gjetja** Rregullorja 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 6.3, përcakton se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.

Regjistri i e-pasurive nën 1,000€ është nënvlerësuar për 324,531€. Ky nënvlerësim ka reflektuar nga pasuritë e paregjistruara nga viti 2020 në vlerë për 46,512€ si dhe pasuritë jo kapitale të blera në vitin 2021 në vlerë 278,019€, të cilat nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive jo financiare.

Po ashtu blerja e pajisjeve të teknologjisë informative në vlerë €72,409€, ishte regjistruar si pasuri kapitale regjistrin SIMFK, duke mbivlerësuar pasurinë mbi 1,000€. Ndërsa këto pajisje do duhej të regjistroheshin në regjistrin e-pasuria.

Sistemi për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive jo kapitale "e-pasuria" nuk ishte aplikuar gjatë vitit 2020 dhe 2021, si rezultat i mosfunksionimit të sistemit e-pasuria. Megjithatë komuna nuk mban regjistra të brendshëm për evidentimin e pasurisë nën 1,000€. Prandaj vlera e pasurive jo kapitale të shpalosura në PFV-të prej 449,769€ dhe stoqet 1,123€ nuk japin siguri në raportim.

Dobësitë e identifikuara lidhur me mosregjistrimin e pasurisë jo-kapitale, janë si pasojë e mungesës së zyrtarit përgjegjës për regjistrimin e pasurive jo-kapitale si dhe problemeve të shfaqura me sistemin e-pasuria. Ndërsa mbivlerësimi i pasurive në regjistrin e SIMFK-së ka rrjedh si gabim teknik.

**Ndikimi** Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që posedon komuna, shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

**Rekomandimi B6** Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale, me qëllim të ruajtjes nga humbja apo keqpërdorimit të tyre.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B7 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare

**Gjetja** Rregullorja 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 19.4.3 përcakton se çdo fundvit duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Ndërsa neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare.

Procesi i inventarizimit të pasurive jo financiare nuk ishte përfunduar sipas

kërkesave të Rregullores 02/2013. Komuna kishte kryer vetëm një pjesë të inventarizimit të pasurive jo financiare, rrjedhimisht nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare para datës së përgatitjes së PFV-ve. Po ashtu, komuna nuk kishte formuar komisionin për vlerësimin e pasurive jo financiare.

Mangësitë janë vërejtur po ashtu në ekzaminimin fizik të Pajisjeve mjekësore në vlerë 25,000€, të pranuara me 27.04.2021, të cilat nuk ishin në funksion. Pajisjet e pranuara janë paisje electrolyte analyzer në vlerë 9,500€, e cila gjindet në laborator si dhe ventilator transportues dhe inhalator profesional në vlerë 15,500€ që ishin në depo, përderisa asnjëra prej tyre nuk ishin vënë në shërbim.

Magësitë në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive, kryesisht ishin për shkak të neglizhencës së zbatimit të procedurave për menaxhimin e pasurive jo financiare si dhe mungesës së udhëzuesve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.

#### **Ndikimi**

Mos krahasimi i inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive dhe mosvlerësimi i pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me gjendjen e pasurive komunale.

Përderisa pajisjet e blera që nuk janë vënë në përdorim apo mos funksionalizimi i tyre, ndikon në zhvlerësimin apo humbjen e vlerës së tyre ende pa u përdorur.

#### **Rekomandimi B7**

Kryetari duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore.

Të bëhen planifikime adekuate për furnizim të paisjeve si dhe paraprakisht të vlerësohen kapacitetet ekzistuese me qëllim të vënies në funksion të të gjitha paisjeve të blera, ashtu që të arsyetohet vlera për para për furnizimet e bëra.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.5 Të arkëtueshmet

Vlera e shpalosur në PFV ishte 4,985,049€. Kjo vlerë përbëhet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë, taksa në biznes, taksa për grumbullimin e mbeturinave, shfrytëzimi i pronës publike dhe të tjera.

#### Çështja B8 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

##### Gjetja

Sipas Rregullores së MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, citon që OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.

Rritja e të arkëtueshmeve ndaj komunës, në fund të vitit 2021 ishte 535,399€ ose 12% më tepër se në vitin 2020.

Sfida kryesore mbetet në inkasimin e tatimit në pronë, e cila është rritur për 7% në vitin 2021, në krahasim me vitin 2020 dhe të hyrat në inkasimin e mbeturinave, borxhet e të cilave janë rritur prej 31 % në vitin 2021, krahasuar me vitin paraprak<sup>8</sup>. Ndonëse niveli i arkëtimit ishte edhe si rezultat i ndikimit të pandemisë.

Përkundër rekomandimit nga vitit i kaluar, komuna nuk ka ndërmarrë veprime konkrete apo të krijoj mekanizma përkatës për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.

##### Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal me refleksion negativ në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetjake.

##### Rekomandimi B8

Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, regjistrimit dhe arkëtimit të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.6 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) funksionon me drejtorin dhe një anëtar. Përveç planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë gjashtë (6) auditime, dhe ishin realizuar gjatë vitit 2021. Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit është 23, prej të cilave të zbatuara ishin gjashtë (6) në proces ishin shtatë (7) dhe dhjetë (10) të pazbatuara. Auditimet ishin fokusuar në fushën e prokurimit, vlerësimit të sistemit të kontrolleve nëpër drejtori të ndryshme si dhe në fushën e të hyrave, përderisa periudha e mbuluar me auditim ishte kryesisht viti 2020. Komiteti i auditimit ishte funksional dhe kishte mbajtur katër (4) takime, ku ishte diskutuar për raportin e auditorit të jashtëm dhe të NjAB.

#### Çështja B9 - Mos kompletimi i NjAB

<b>Gjetja</b>	<p>Neni 5.1.1 i Rregullores 01/2019 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekt i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë së paku tre auditorë.</p> <p>Komuna ka të themeluar NJAB i cili përbëhet nga 2 auditorë, drejtori i auditimit dhe auditori, përderisa sipas ligjit të buxhetit duhet të ketë së paku 3 auditorë.</p> <p>Për shkak të pengesave me sistemin e ri për rekrutimin e personelit për vitin 2021 komuna nuk ka mund ta rekrutojë pozitën Auditor i Brendshëm, Për vitin 2022 kjo pozitë është planifikuar me buxhetin dhe me plan të personelit, mirëpo deri sa ishim në auditim, nuk është zhvilluar ndonjë procedurë e rekrutimit.</p>
<b>Ndikimi</b>	<p>Mos kompletimi i NjAB-së me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.</p>
<b>Rekomandimi B9</b>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që sa më parë të zhvilloj procedurat për auditor, për plotësimin me staf të mjaftueshëm, bazuar në rregulloren për themelimin e Njesisë për Auditimin e Brendshëm.</p>

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>o</sup>	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>18,878,129</b>	<b>20,861,815</b>	<b>18,297,176</b>	<b>18,716,055</b>	<b>17,724,021</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	16,971,227	16,729,050	15,664,569	16,352,367	15,369,553
Financimi përmes huamarrjes	0	54,187	52,937	150,060	89,534
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,789,252	1,174,440	853,863	497,100
Të hyrat vetanake	1,906,903	1,906,903	1,085,992	1,039,575	1,550,507
Donacionet vendore	0	78,637	25,894	238,846	111,142
Donacionet e jashtme	0	303,787	293,344	81,344	106,186

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,983,686€. Kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak për 1,789,252€, rritjes së donacioneve të brendshme për 69,482€, donacioneve të jashtme për 312,943€, rritjes së financimit nga huamarrja prej 54,187€, si dhe zvogëlimit të grantit qeveritar për 242,177€.

Në vitin 2021 Komuna ka shpenzuar 88% të buxhetit përfundimtar, me një shpenzim 18,297,176€, kishte rritje të shpenzimit për 2% të shpenzimeve në krahasim me vitin 2020.

Shpenzimet gjatë vitit 2021 për rimëkëmbje ekonomike ishin 333,804€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me kompensimin e pagave shtesë të zjarrfikësve, punëtorëve shëndetësor dhe të arsimit, sipas vendimeve të nivelit qendror.




**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>18,878,129</b>	<b>20,861,815</b>	<b>18,297,176</b>	<b>18,716,055</b>	<b>17,724,021</b>
Pagat dhe mëditjet	10,691,340	10,603,183	10,603,104	10,313,007	9,936,267
Mallrat dhe shërbimet	3,218,600	3,842,777	3,109,691	3,153,317	2,527,731
Komunalitë	309,035	334,376	309,362	239,623	274,878
Subvencionet dhe transferet	600,000	1,007,005	836,871	689,149	195,167
Investimet Kapitale	3,765,154	5,074,473	3,438,148	4,320,960	4,789,977
Rezervat	294,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 88,156€. Me vendim të qeverisë së Kosovës janë bërë harmonizime buxhetore;
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 624,177€. Rritja kishte ndodhur nga të hyrat e bartura për 600,839€, nga huamarrja 11,719€, nga grantet e donatorëve të brendshëm dhe jashtëm për 11,619€;
- Buxheti për shërbimet komunale ishte rritur për 25,341. Rritja kishte ndodhur nga të hyrat e bartura;
- Buxheti për subvencione ishte rritur për 407,005€. Rritja kishte ndodhur me vendim të qeverisë për kompensim dëmi për 162,000€, nga të hyrat të bartura për 225,305€, si dhe nga grantet për 19,700€;
- Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 1,309,319€, Fillimisht me rishikim të buxhetit është rrit buxheti për 299,493€. Rritje nga grantet e donatorëve të brendshëm dhe të jashtëm për 351,104€, nga të hyrat 936,207€. Me vendim të qeverisë ka ndodh zvogëlimi i buxhetit për 277,486€. Përkundër rritjes së buxhetit komuna ka shpenzuar në nivel shumë të ulët buxhetin për investime kapitale me vetëm 68%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Vushtrrisë në 2021 ishin 2,670,051€, me një rritje prej 28% krahasuar me vitin paraprak. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga taksa për grumbullimin e mbeturinave, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte edhe të hyra të arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës, si në vijim: gjobat në trafik 359,274€ dhe gjobat nga gjykatat 17,850€.


**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>1,906,903</b>	<b>1,906,903</b>	<b>2,670,051</b>	<b>2,116,618</b>	<b>2,122,938</b>
Të hyrat tatimore	923,124	923,124	895,449	734,352	820,800
Të hyrat jo tatimore	983,779	983,779	1,772,618	1,381,488	1,302,137
Të hyrat tjera	0	0	1,984	778	

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 ka rezultuar me 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit për vitin 2021, pesë rekomandime janë zbatuar, nëntë rekomandime nuk ishin zbatuar, siç është paraqitur më poshtë në Grafikon 2. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në departamentin e tatimit në pronë, në mënyrë që të dhënat në sistemin ProTax të jenë të harmonizuara me rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme të Komunës dhe me ligjin, dhe të gjitha rastet e tilla të korrigjohen.		Nuk është adresuar
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj mekanizma efektiv për inspektimin e kuotës së përcaktuar prej 20% të objekteve siç kërkohet me ligjin e ri si dhe të rrisë kontrollin e menaxhimit të punëve në teren.		Nuk është adresuar
3.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që paratë e gatshme të grumbulluar në arkë të dorëzohen dhe të depozitohen në bankë sipas kërkesave të rregullës financiare për të hyrat.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla	I zbatuar

4.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në këtë fushë në mënyrë që hyrat të klasifikohen drejtë në përputhje me kodet përkatëse ekonomike të përcaktuara me planin kontabël të Thesarit/SIMFK.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së tenderëve konform kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla	I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari të sigurojë ndarjen e drejtë të detyrave në procesin e menaxhimit të aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave konform respektimit të kriterëve ligjore dhe rregullative të prokurimit publik.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla	I zbatuar
7.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që procesi i vlerësimit të aplikuesve të dokumentohet me dëshmi përkatëse duke siguruar në të njëjtën kohë të mos shkelet parimi i konkurrencës, si dhe përfitues të subvencioneve të jenë vetëm aplikuesit që përmbushin kriteret e përcaktuara në thirrjen publike.		Nuk është adresuar
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.		Nuk është adresuar
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave dhe çertifikuesi aplikojnë kontrolle efektive në procesin e shpenzimit të parasë publike dhe menaxhimin e kontratave për tu siguruar se pagesat bëhen vetëm sipas çmimeve të kontraktuara dhe punëve/furnizimeve të realizuara. Po ashtu, për gabimet financiare dhe ndryshimet e identifikuar, komuna duhet të sigurohet se do të bëhet kthimi i mjeteve financiare në buxhetin e komunës dhe realizohen aprovimet e nevojshme për kontratat të cilat ende nuk janë përmbyllur.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla	I zbatuar
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që mos të fillohen projektet pa u siguruar për çështjet e problemeve pronësore, hartimit të specifikave adekuate të projekteve dhe se menaxherët e kontratave formalizojnë procesin e shtyrjes së afateve kur ato janë të nevojshme nga ana e Komunës. Po ashtu, për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen penalet e parapara me kontratë.		Nuk është adresuar

11.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale konform gjetjeve të auditimit të trajtuara me lartë për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale.	Komuna nuk kishte marr asnjë veprim në procesin e inventarizimit, poashtu për regjistrat e pasurive jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqeve nuk kishte shënime të sakta.	Nuk është adresuar
12.	Pasuritë	Kryetari, duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore.		Nuk është adresuar
13.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, regjistrimit dhe arkëtimit të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime.		Nuk është adresuar
14.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB.		Nuk është adresuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit



Selvete Foniqi, Udhëheqëse e ekipit




Fetah Osmani, Anëtar i ekipit



Bahri Statovci, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



KOMUNA VUSHTRRI

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar drafri raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>10</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>11</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.



### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> - fatura numër 027/2021 në shumë 29,738€, për mirëmbajtjen e ndriçimit publik ishte pranuar me datën 05.11.2021 ndërsa urdhër blerja ishte proceduar me datën 25.11.2021; - fatura numër 05-E/2021 në shumë 1,170€, transporti i nxënësve ishte pranuar me datën 06.05.2021 ndërsa urdhër blerja ishte proceduar me datën 11/05/2021;dhe - fatura numër 10.20201/51 në shumë 7,000€, për furnizim me mjete praktike ishte pranuar me datën 03.12.2021 ndërsa urdhër blerja ishte proceduar me datën 22/12/2021.
- <sup>5</sup> Çmimi për njësi sipas marrëveshjes ishte 0.50€ ndërsa ishin paguar me 2.50€.
- <sup>6</sup> Vlera totale e nën-faturimeve është 765 € (34\*22.50 €) Vlera  
totale e mbi-faturimeve është 337.5 € (15\*22.5)
- <sup>7</sup> aplikanti nr.09-104/02-0021735/21 dhe nr.09-104/02-0021772/21, aplikanti nr.09-104/02-0021043/21
- <sup>8</sup> Inkasimi per vitin 2021 ka qene ne shume prej 495,801€, kurse faturimi per vitin 2021 ka qene ne vlerën prej 850,384€ , atëherë rrjedh se kemi nje realizim prej 58.30 % (495,801/ 850,384=58.30%), rrjedh se rreth 41.7 % te klientëve faturohen dhe nuk paguajnë ose nga 17380 kliente gjithsejt , i bie që 7247 klientë nuk paguajnë fare.
- <sup>9</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>10</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>11</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

<b>DATË/A:</b>	12.07.2022
<b>PËR/ZA/TO:</b>	KPF dhe Kuvend
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës  Abit Abiti, ZKF 
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Raporti tremujor , Janar – Qershor 2022

Në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka përgatitur raportin tremujor i cili mbulon vitin fiskal e deri në fund të këtij tremujori i cili sapo ka përfunduar. Ky raport përmban shënime mbi arkëtimet , shpenzimet dhe një përmbledhje të shpenzimeve Kapitale . Këtë raport e prezentojmë në KPF , pas shqyrtimit nga KPF ky raport i prezantohet Kuvendit Komunal dhe një kopje të këtij raporti ja dërgojmë edhe Ministrisë.

Me respekt.

Shtojcë Raportet:



TOTAL		37,000.00	39,872.00	108%	74,000.00	34,128.00	0.00	74,000.00	27,935.00
Gjeodezi dhe Kadaster	650	€	€	%	€	€	€	€	€
Qiraja nga objektet publike		11,500.00	2,155.00	19%	23,000.00	20,845.00	0.00	23,000.00	2,155.00
Të hyrat nga Gjeodezia dhe Kadastri		20,000.00	62,464.00	312%	40,000.00	-22,464.00	0.00	40,000.00	50,888.62
TOTAL		31,500.00	64,619.00	205%	63,000.00	-1,619.00	0.00	63,000.00	53,043.62
Kulturë, rini dhe sport	850	€	€	%	€	€	€	€	€
Palestra e sportit		500.00	48.00	10%	1,000.00	952.00	0.00	1,000.00	552.00
Biblioteka		250.00		0%	500.00	500.00	0.00	500.00	46.00
Shtëpia e Kulturës		500.00		0%	1,000.00	1,000.00	0.00	1,000.00	265.00
TOTAL		1,250.00	48.00	4%	2,500.00	2,452.00	0.00	2,500.00	863.00
Shërbime publike	180	€	€	%	€	€	€	€	€
Parkngjet		1,000.00	2,867.50	287%	2,000.00	-867.50	0.00	2,000.00	690.00
Regjistrimi i automjeteve		41,500.00	60,590.50	146%	83,000.00	22,409.50	0.00	83,000.00	56,480.00
Taksat e mbeturinave		306,867.00	244,530.95	80%	613,734.00	369,203.05	0.00	613,734.00	221,069.99
TOTAL		349,367.00	307,988.95	88%	698,734.00	390,745.05	0.00	698,734.00	278,239.99
Bujqësi	470	€	€	%	€	€	€	€	€
Ndrryshimi i destinimit të tokës		5,000.00	18,600.00	372%	10,000.00	-8,600.00	0.00	10,000.00	35,553.19
Leje pune			160.00						30.00
TOTAL		5,000.00	18,760.00	375%	10,000.00	-8,600.00	0.00	10,000.00	35,583.19
Shëndetësi	700	€	€	%	€	€	€	€	€
Participim		25,000.00	21,240.50	85%	50,000.00	28,759.50	0.00	50,000.00	22,148.00
Participim QPS		1,000.00	1,665.00	167%	2,000.00	335.00	0.00	2,000.00	1,321.00
TOTAL		26,000.00	22,905.50	88%	52,000.00	29,094.50	0.00	52,000.00	23,469.00
Urbanizimi	660	€	€	%	€	€	€	€	€
Lejet e ndërtimit		102,946.00	292,554.12	284%	205,892.00	-86,662.12	0.00	205,892.00	115,205.43
Leje mjedisore			19,774.78						4,696.57
Legalizim I Objekteve			9,001.56						3,185.74
Rrenim I objekteve			156.24						1,025.64
Shtyrëzimi i pronës Publike		2,500.00	5,172.20	207%	5,000.00	-172.20	0.00	5,000.00	1,210.00
TOTAL		105,446.00	326,658.90	310%	210,892.00	-86,834.32	0.00	210,892.00	125,323.38
	850	€	€	%	€	€	€	€	€

Globalt e trafikut					0%					0.00		0.00		
Globalt e gjykatave					0%					0.00		0.00		
Globalt e pyleve			50.00							0.00		0.00		
Të hyrat tjera			29,973.00		#VALUE!					0.00		0.00	19,035.73	
<b>TOTAL</b>			<b>0.00</b>	<b>30,023.00</b>	<b>#DIV/0!</b>					<b>0.00</b>		<b>0.00</b>	<b>19,035.73</b>	
			<b>1,131,397.50</b>	<b>1,328,226.26</b>	<b>117%</b>					<b>2,262,795.00</b>	<b>934,568.74</b>	<b>0.00</b>	<b>2,262,795.00</b>	<b>1,066,600.01</b>

#REFI	K.K. Vushtrri																		
#REFI	644																		
Perioda raportuese	Janar -Qershor																		
<b>PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS BURIMIT TË FINANCIIMIT</b>																			
<i>Ngjertimi i rrejtë të qiesjellësit me rezervuar për fshatit Posorë - Durrës Epërme</i>																			
PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VIETORE					Viti i kaluar									
		BUXHETI PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e buxhetit të alokuar	Buxheti i planifikuar për 2022	Buxheti i mbetur për 2022	Plan i reviduar 2022	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Shpenzimi i realizuar për periudhën e njëjtit 2021										
	4	€	€	6 = 5/4*100 %	€	8=7-5	9	10 =7-9	11										
Financimi nga huantariet	04		€	0%	€	0.00	€	0.00	€										
Granti Qeveritar	10	7,247,865.46	6,220,389.49	86%	17,678,391.55	11,458,002.06	0.00	17,678,391.55	7,096,693.11										
Të hyrat vetanake	21	1,241,424.39	417,270.06	34%	2,262,795.00	1,845,524.95	0.00	2,262,795.00	279,183.97										
Mjetet e bartura	22	121,051.36	100,610.97	83%	2,574,011.71	2,473,400.74	0.00	2,574,011.71	220,501.80										
Donacionet e brendshme	31	52,001.29		0%	52,001.23	52,001.23	0.00	52,001.23	2,779.95										
Donacionet e jashtme	32	39,816.11	22,145.12	56%	42,099.39	19,954.27	0.00	42,099.39	1,499.65										
<b>TOTALI</b>		<b>8,702,158.54</b>	<b>6,760,415.63</b>	<b>78%</b>	<b>22,609,298.88</b>	<b>15,848,883.25</b>	<b>0.00</b>	<b>22,609,298.88</b>	<b>7,615,481.10</b>										

Për shkak të mos miratimit të buxhetit sipas Nenet 20.3 të LMIEPP, Komunes së Vushtrrisë ju kanë alokuar për shpenzime 3/12 e buxhetit të vitit 2021





Emri i Komunës :	VUSHTRRI								
Kodi i Komunës:	644								
	Janar -Qershor								
Periudha raportuese									
<b>PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE</b>									
PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE	VJETORE					Viti i kaluar	
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR e buxhetit të alokuar	Përqindja planifikuar për 2022	Buxheti I për 2022	Buxheti I mbetur reviduar 2022	Plani I reviduar 2022	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Shpenzimi I realizuar për periudhën e njëjtë 2021
				%	€	€	€	€	€
Zyra e Kryetarit	160	153,940.58	126,554.22	82%	457,218.00	330,663.78	0.00	457,218.00	163,659.31
Administrata dhe personeli	163	266,672.92	149,751.67	56%	779,758.00	630,006.33	0.00	779,758.00	156,368.11
Inspektorimet	166	56,976.08	35,722.19	63%	142,815.00	107,092.81	0.00	142,815.00	45,873.76
Prokurimi	167	15,598.76	11,998.76	77%	55,918.00	43,919.24	0.00	55,918.00	16,988.08
Zyra e Kuvendit Komunal	169	70,425.16	67,809.16	96%	143,451.00	75,641.84	0.00	143,451.00	72,403.99
Buxheti dhe financat dhe shërbimet publike	175	90,066.25	71,120.62	79%	210,676.00	139,555.38	0.00	210,676.00	77,803.52
Mbrojtja civile dhe emergjencë	180	1,505,732.02	847,640.28	56%	3,732,956.60	2,885,316.32	0.00	3,732,956.60	1,288,003.22
Zyra tokare e komuniteteve	195	25,799.38	20,699.38	80%	81,871.00	61,171.62	0.00	81,871.00	21,536.34
Bujqësi, pylltari, zhvillimi rural	470	222,648.91	87,899.30	39%	1,122,619.23	1,034,719.93	0.00	1,122,619.23	125,891.72
Gjendësi dhe kadashtëri	650	37,998.46	34,070.24	90%	105,497.00	71,426.76	0.00	105,497.00	33,400.16
Planifikimi urban dhe mjedisi	660	142,195.60	45,765.84	32%	1,670,386.49	1,624,620.65	0.00	1,670,386.49	139,275.23
Shëndetësia primare	730	1,426,889.08	1,064,412.98	75%	3,188,721.14	2,124,308.16	0.00	3,188,721.14	1,110,045.54
Shërbimet sociale rezidenciale		126,992.61	87,573.03	69%	334,419.00	246,845.97	0.00	334,419.00	93,072.27
Kulturë, rinj, sport	850	283,472.16	180,164.82	64%	819,893.46	639,728.64	0.00	819,893.46	108,041.00
Arsimi	920	4,279,033.85	4,012,871.96	94%	9,763,098.96	5,750,227.00	0.00	9,763,098.96	4,163,008.85
<b>TOTALI</b>		<b>8,704,441.82</b>	<b>6,844,054.45</b>	<b>79%</b>	<b>22,609,298.88</b>	<b>15,765,244.43</b>	<b>0.00</b>	<b>22,609,298.88</b>	<b>7,615,481.10</b>

Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet	Zotim / Obligimet në pritje	Mjete e lira	% e mjeteve të shpenzuara
<b>16324 ADMINISTRATA - VUSHTRRI</b>	<b>362,200.00</b>	<b>14,131.70</b>	<b>269,404.30</b>	<b>79,664.00</b>	<b>3.90</b>
43690 Inventar për Objektin e Ri të Komunës	4,200.00	0.00	1,534.00	2,666.00	-
49479 NDERTIMI I DEPOZË	30,000.00	0.00	29,822.00	178.00	-
51814 Ngrohja qendrore për administratën Komunale	97,000.00	0.00	97,000.00	0.00	-
51815 Moton për gjenerator në administratën Komunale	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00	-
51816 Rregullimi i nyjeve sanitare në objektin e administratës Kom	15,000.00	0.00	0.00	15,000.00	-
51817 Ndajja fizike e objektin në administratën Komunale	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00	-
51818 Teknologjia informative për administratën Komunale	60,000.00	14,131.70	4,048.30	61,820.00	17.66
52186 NDERTIMI I SALLËS NË OBJEKTIN E KOMUNËS	121,000.00	0.00	121,000.00	0.00	-
<b>16024 SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE - VUSHTRRI</b>	<b>3,094.59</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>3,094.59</b>	
71936 RREGULLIMI I SHESHIT HSAN PRISHTINA	37.00	0.00	0.00	37.00	-
72228 RREGU RRUGËS BAHRI KUQI SEG 1	375.52	0.00	0.00	375.52	-
86140 FONDI BHASHKFINANCIMIT SHTRURJA E RRUGËS ME KUBE	2,576.07	0.00	0.00	2,576.07	-
93129 PTK PER RR.NE L.BUN.SOP.F.SAMA	104.00	0.00	0.00	104.00	-
<b>16184 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - VUSHTRRI</b>	<b>1,690,660.01</b>	<b>41,124.89</b>	<b>199,237.93</b>	<b>1,650,297.19</b>	<b>2.16</b>
41407 NDERTIMI I TROTUARËVE	2,500.00	0.00	0.00	2,500.00	-
43900 Projektet në bashkëfinansim me donator	21,194.80	0.00	0.00	21,194.80	-
46628 ZGJERIMI I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT	51,235.81	0.00	0.00	51,235.81	-
47962 RREGULLIMI I VARREZAVE TË MARTIRËVE	5,192.00	0.00	4,237.00	955.00	-
51202 RINDERTIMI I RRUGËVE ME INFRASTRUKTURE	1,125.82	1,124.89	0.93	0.00	99.92
51819 Ndërtimi i kanalizimeve në Vushtri, Smadrexhtë, Maxhunaj, S	443,000.00	0.00	0.00	443,000.00	-
51820 Ndërtimi i rrugëve me kubeza betoni rr. "Skenderbeu", "Bek	207,000.00	0.00	0.00	207,000.00	-
51821 Ndërtimi i trotuarëve në Vushtri, Stanoc, Smrekonicë	100,000.00	0.00	75,000.00	25,000.00	-
51822 Shtjellimi horizontal dhe vertikal rr. "Dashmore e Kombit"	70,000.00	0.00	0.00	70,000.00	-
51823 Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në Ishtrat e Qytavës,	212,100.00	0.00	0.00	212,100.00	-
51824 Ndërtimi i sheshit të "Oytalit", Stroc, Smrekonicë dhe parku	51,134.00	0.00	0.00	51,134.00	-
51825 Rregullimi i varrezave të qytetit-Vushtri	25,000.00	0.00	0.00	25,000.00	-
51825 Blerja e veturave për administratën komunale - Vushtri	55,000.00	0.00	0.00	55,000.00	-
51827 Ndërtimi i vigave mbi lumin Silnica , Tërstenë dhe Stanoc	40,000.00	0.00	30,000.00	10,000.00	-
51828 Rikonstruktimi i rrugëve të asfaltuara "2 Maji", "Hamit Hyse	200,000.00	40,000.00	0.00	160,000.00	20.00
51829 Rrugët e randit të IV - Dobërlukë, Pesiqe, Ceshan, Sllatin	50,000.00	0.00	40,000.00	10,000.00	-
51830 Rregullimi i shtetit të lumit „Silnica“	250,000.00	0.00	0.00	250,000.00	-
51831 Ndricimi publik në Vushtri, Dobërlukë, Maxhunaj, Stanoc	25,000.00	0.00	0.00	25,000.00	-
51832 Kamerat në qytet rr. "D.Kombit" dhe shkollën SHMU-Vushtri	10,000.00	0.00	0.00	10,000.00	-
51833 Ndërtimi i urave dhe murëve mbrojtëse në Stanoc dhe Pantinë	60,000.00	0.00	50,000.00	10,000.00	-
92060 NGRITJA E PERFORMANÇES 2019	3,985.65	0.00	0.00	3,985.65	-
92111 PERFORMANCA KOMUNALE 2021	6,285.73	0.00	0.00	6,285.73	-
93195 NDERT PK.PRITËSE PER AUTOB.PRI-ZHI-BIV-STR	906.20	0.00	0.00	906.20	-
<b>16429 ZJARRFIKËSIT INSPEKTIVET - VUSHTRRI</b>	<b>35,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>29,994.75</b>	<b>5,005.25</b>	
51834 Pajisje (pompa uji) për zjarrifikësit e Komunës së Vushtrisë	30,000.00	0.00	25,000.00	5,000.00	-
52167 RENOVIMI I OBJEKTIT TË ZJARRFIKËSVE	5,000.00	0.00	4,994.75	5.25	-
<b>47024 BUJQËSIA - VUSHTRRI</b>	<b>622,759.23</b>	<b>43,140.66</b>	<b>96,039.67</b>	<b>383,578.90</b>	<b>6.28</b>
48182 NGRITJA E PEMISHTËVE	991.00	0.00	0.00	991.00	-

49581 PROJEKTET NE BASHKËFINANÇIM ME DONATORË	440,081.00	36,055.66	94,239.67	310,785.67	7.97
51203 NDËRTIMI I KANALEVE KULLUESE NE LUMMADH DHE DUMNICE E ULET	5,439.65	0.00	0.00	5,439.65	-
51204 RR. I SHTR. TE LUME. NE STUJIME,MAXHUNAJ DHE DUMNICE E MESME	8,085.00	8,085.00	0.00	0.00	100.00
51835 Rregullime i arginatave te lumit "Sincica"	66,360.58	0.00	0.00	66,360.58	-
72691 FURNIZIM ME MAKINA PER SHKOKËLIMIN E MISRIT	1,800.00	0.00	1,800.00	0.00	-
<b>06426 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKÇIONI - VUSHTRRI</b>	<b>1,468,968.48</b>	<b>20,707.00</b>	<b>938,200.00</b>	<b>510,059.49</b>	<b>1.41</b>
41424 NDERT RRUQ LOKALE NE FSHATRA	1,172,471.30	0.00	878,200.00	294,271.30	-
45265 ASFALTIMI I RRUGEVE NE QYTET	43,525.58	0.00	0.00	43,525.58	-
49579 RREGULLIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE -SHESHEVE	5,552.57	0.00	0.00	5,552.57	-
49588 MBJELLJA E DRUNJVE DEKORATIV	13,044.33	0.00	0.00	13,044.33	-
51836 Riasfaltimi i rruges ne Ishatrat Dunicë, Qllavotin, Pantinë	30,000.00	0.00	0.00	30,000.00	-
51837 Ndërtimi i parqeve dhe mbjellja e drunjeve dekorativ "Adem Ja	75,000.00	0.00	60,000.00	15,000.00	-
52188 ASFALTIMI I RRUGES VESEKOC SLLAKOVIC	100,000.00	0.00	0.00	100,000.00	-
96018 SHËTITJE NE HISTORI	29,372.71	20,707.00	0.00	8,665.71	70.90
<b>74450 SHËRBIMET E KUJDEBIT PRIMAR SHËNDËTËSOR - VUSHTRRI</b>	<b>414,327.59</b>	<b>0.00</b>	<b>317,836.64</b>	<b>96,491.95</b>	-
41427 NDËRTIMI I QMF NE VUSHTRRI	2,827.59	0.00	0.00	2,827.59	-
45253 PAISJE NJEKËSORE	68,000.00	0.00	68,000.00	0.00	-
45261 FURNIZIM ME INVENTAR	30,000.00	0.00	0.00	30,000.00	-
50059 AUTOMJET I TERENIT PER SHËNDËTËSI	30,000.00	0.00	0.00	30,000.00	-
51838 Ndërtimi i aneksit ne QKMF Vushtrri (depo dhe garazhe)	40,000.00	0.00	40,000.00	0.00	-
51839 Renovimi dhe ngjyrosja e QMF-1, Vushtrri	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00	-
51840 Bletja dhe montimi i klimave ne QKMF - Vushtrri	5,000.00	0.00	4,840.00	160.00	-
51841 Paisje per tavantieri ne QKMF-Vushtrri	6,000.00	0.00	6,000.00	0.00	-
51842 Kamera per AMF-it ne Maxhunaj,Pantinë,Druar dhe Srrakoncë	8,000.00	0.00	0.00	8,000.00	-
51843 Rindërtimi i laboratorit ne QMF-3 Vushtrri	4,000.00	0.00	0.00	4,000.00	-
51844 Kaldaja elektrike QMF1 Vushtrri	2,000.00	0.00	0.00	2,000.00	-
51846 Rregullime i oborrit i QKMF-se Vushtrri	31,000.00	0.00	31,000.00	0.00	-
51848 Ndërtimi i receptionit ne QKMF - Vushtrri	4,500.00	0.00	0.00	4,500.00	-
52189 NDËRTIMI I DEPOSË PER MBETURINA MEDICINALE	2,056.64	0.00	2,056.64	4.36	-
52190 NDËRTIMI I ZYRAVE ADMINISTRATIVE NE QKMF	65,940.00	0.00	65,940.00	0.00	-
52192 RREGULLIMI I HAPËSIRAVE TE RENTGENIT QKMF DR. SAFET IDRIZI	50,000.00	0.00	50,000.00	0.00	-
80263 TEKNOLOGJI INFORMATIVE	15,000.00	0.00	0.00	15,000.00	-
<b>75616 SHËRBIMET SOCIALE - VUSHTRRI</b>	<b>20,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>20,000.00</b>	-
49626 RENOVIMI I QENDRËS PER KUJDES DITOR PER TE MOSHUAR	20,000.00	0.00	0.00	20,000.00	-
<b>75617 SHËRBIMET REZIDENCIALE - VUSHTRRI</b>	<b>8,800.00</b>	<b>0.00</b>	<b>8,800.00</b>	<b>0.00</b>	-
50984 RENOVIMI I QENDRËS REZIDENCIALE	8,800.00	0.00	8,800.00	0.00	-
<b>80224 SHËRBIMET KULTURORE - VUSHTRRI</b>	<b>419,510.02</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>419,510.02</b>	-
48940 RENOVIMI I STADIUMIT TE HENDBOLLIT "MUSA ABAZI"	91,000.00	0.00	0.00	91,000.00	-
48361 NDËRTIMI I FUSHËS NDËHMËSE TE STADIUMI I FUTBOLLIT (FAZA II)	10,510.00	0.00	0.00	10,510.00	-
49580 INVENTARIZIMI I QENDRËS SE KULTURËS	66,000.00	0.00	0.00	66,000.00	-
51007 RENOVIMI I PALESTRËS „JETON TERRSTENA“	120,000.00	0.00	0.00	120,000.00	-
51847 Ndërtimi i objektit ndihmës ne stadiumin „Feria Aliu“	60,000.00	0.00	0.00	60,000.00	-
51849 Bletje e aparaturës për kinema dhe funksionalizimi ne qendër	50,000.00	0.00	0.00	50,000.00	-
51850 Digjitalizimi i putrit dhe ndonjëmit profesional për teatrin	10,000.00	0.00	0.00	10,000.00	-
51851 Ndërtimi pllakeve per kujtimore ne Pasomë	12,000.00	0.00	0.00	12,000.00	-
<b>82120 ADMINISTRATA - VUSHTRRI</b>	<b>132,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>132,000.00</b>	<b>0.00</b>	-
46575 TEKNOLOGJI INFORMATIVE	132,000.00	0.00	132,000.00	0.00	-
41440 NDËRTIMI I RRETHOJAVE NE SHKOLLA	2,878.14	0.00	2,878.14	0.00	-
46587 FUSHA SPORTIVE	11,949.40	0.00	11,949.40	0.00	-

47909 NDERTIMI I ÇERDHËS SË RE	39,557.60	0.00	39,557.60	0.00	-
47970 SALLA SPORTIVE	22,260.00	22,260.00	0.00	0.00	100.00
51006 NDERTIMI I TOLETEVE NË SHKOLLË	2,229.00	0.00	2,229.00	0.00	-
51652 Inventar për shkollë SHMU „Anton Zeko Çajupi	22,000.00	0.00	22,000.00	0.00	-
51653 Fusha sportive dhe rrethoja në SHMU Lummadh	29,000.00	0.00	29,000.00	0.00	-
51654 Ndërtimi i tualeteve në SHMU „Emin Duraku”	35,000.00	0.00	35,000.00	0.00	-
51655 Ndërtimi i ploteve me kubëza betoni në SHMU Vushitit	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00	-
51657 Fusha sportive në SHMU „Enver Haxhi”	7,000.00	0.00	7,000.00	0.00	-
51656 Depo për SHF „Naim Frashëri” Vushitri	11,796.36	0.00	11,796.36	0.00	-
51659 Depo për SHF „Latif Berisha”	4,600.00	0.00	4,600.00	0.00	-
51660 Depo për SHF „Mustafë Shyti” Oshitan	4,600.00	0.00	4,600.00	0.00	-
51661 Inventari për SHMU “Lumni Surdull” Samëdrethe	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00	-
51662 Ndërtimi i rrethojave në SHMU “Mustafë Shyti” Oshitan	3,500.00	0.00	3,500.00	0.00	-
51663 Ndërtimi i rrethojave në SHFU “Rindja” Vllanc	3,000.00	0.00	3,000.00	0.00	-
51664 Meremetimi i SHMU “Adam Vuca” Pasomë	65,000.00	0.00	65,000.00	0.00	-
51665 Meremetimi i SHMU “Lumni Surdull”	31,000.00	0.00	31,000.00	0.00	-
51666 Meremetimi i SHMU „Enver Haxhi” - Smykoniçë	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00	-
51667 Meremetimi i SHMU “Rindja” Vllanc	8,000.00	0.00	8,000.00	0.00	-
51668 Meremetimi i sht. “Ali Kelmendi” - Studime	45,000.00	0.00	45,000.00	0.00	-
51669 Meremetimi i SHFMU “Mihalq”	2,000.00	0.00	2,000.00	0.00	-
51670 Meremetimi i SHFMU “Rexhep Musa”	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00	-
51671 Rregullimi i SHFMU-46 në Stanoç me infrastrukturë	35,000.00	0.00	35,000.00	0.00	-
51672 Meremetimi i SHF Naim Frashëri dhe ndërtimi i tualeteve	26,000.00	0.00	26,000.00	0.00	-
51673 Meremetimi i SHFMU “Azem Bejta” - Dëbiç	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00	-
52191 NDERTIMI I SHKOLLËS NË OLLAVOTIN	147,000.00	0.00	0.00	147,000.00	-
90202 MEREMETIMI I SHKOLLAVE	5,541.94	5,541.94	0.00	0.00	100.00
51674 Përsje për praktike profesionale SHMP “Bahri Haxha”	55,000.00	0.00	55,000.00	0.00	-
51676 Kalkula për ngrohje qendrore “Lulë Musiqi” SHMU II	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00	-
51676 Pajisje laboratorike SHMP “Bahri Haxha”	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00	-
51677 Renovimi i ngrohjes qendrore SHMP “Bahri Haxha”	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00	-
93222 RREGULLIMI I SHKOLLËS BAHRI HAXHA	577.05	0.00	0.00	577.05	-
95104 FURNIZ MJETE PER PUNTOR SILDATOR-AXHUSTATOREVE	157.00	0.00	0.00	157.00	-
<b>Totali i Përgjithshëm</b>	<b>6,042,316.42</b>	<b>146,926.19</b>	<b>2,579,622.79</b>	<b>3,315,767.44</b>	<b>2.43</b>



**REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI**  
**Kryetari i Komunës**

---



**INFORMATË**  
**LIDHUR ME ZBATIMIN E VENDIMEVE TË KU VENDIT TË KOMUNËS**  
**JANAR – QËRSHOR 2022**

**Korrik 2022**

Bazuar në Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, përkatësisht pika 1, muaj korrik, paraqitet kjo Informatë lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar – qershor 2022, si në vijim:

<b>Janar 2022</b>						
Nr	Vendimet e miratuara	Vendimet e zbatuara	Vendimet në procedurë të zbatimit	Vendimet e pa zbatuara	Arsyeja e mos zbatimit	Vërejtje
1	Vendim për aprovimin të buxhetit të komunës për vitin 2022-2024	√				
2	Vendim për themelimin të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi	√				
3	Vendim për themelimin të Komitetit për Politikë dhe Financa	√				
4	Vendim për emërim të anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM “Uniteti”	√				
5	Vendim për emërim të anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL “Përparimi”	√				
6	Vendim për emërim të komisionit për përzgjedhje të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave	√				
7	Vendim për lirimin nga pagesa e taksës për Çerdhet publike	√				

**Shkurt 2022**

Nr	Vendimet e miratuara	Vendimet e zbatuara	Vendimet në procedurë të zbatimit	Vendimet e pa zbatuara	Arsyeja e mos zbatimit	Vërejtje
1	Vendim për miratimin e Planit për Menaxhimin e Mbeturinave	√				
2	Vendim për ndarje të subvencioneve për v. 2022	√				
3	Vendim për lirim nga pagesa e taksës për mbeturina	√				
4	Vendim për formim të grupit vlerësues për identifikimin e shtëpive - shkolla		√			
5	Vendim për zëvendësimin e anëtarit të KKS SB	√				
6.	Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër		√			
7	Vendim për miratim të nismës për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës	√				
8	Vendim për formim të komisionit për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës	√				
9	Vendim për themelimin të Komitetit për Komunitete	√				



Mars 2022						
Nr	Vendimet e miratuara	Vendimet e zbatuara	Vendimet në procedurë të zbatimit	Vendimet e pa zbatuara	Arsyeja e mos zbatimit	Vërejtje
1	Vendim për ndërtimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Suphi Metëhu)			√	Arsyet ligjore të dhëna nga Ministria e Bujqësisë	
2	Vendim për harmonizimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër	√				
3	Vendim për zgjaqjen e afatit për hartim të hartës zonale		√			
4	Vendim për shfuqizim të vendimit për lirim nga pagesa e taksës së çerdheve publike	√				
5	Vendim për formim të komisionit për ndryshim të rregullores për fermerët	√				
6	Vendim për formim të komisionit për hartim të tekstit të spastruar të Rregullores për Taksa dhe Ngarjesa Komunale		√			

Prill 2022						
Nr	Vendimet e miratara	Vendimet e zbatuara	Vendimet në procedurë të zbatimit	Vendimet e pa zbatuara	Arsyeja e mos zbatimit	Vërejtje
1	Vendim për shpërndarje të të hyrave vetanake buxhetore për vitin 2022	√				
2	Vendim për bartjen e të hyrave vetanake buxhetore nga viti 2021 në vitin 2022	√				
3	Vendim për përkrahje financiare të klubit të futbollit	√				
4	Vendim për lirim nga pagesa e taksës për kiosqe		√			
5	Vendim për riçekimin e tarifës për shërbimet e vartimit		√			
6	Vendim për ricaktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër		√			
7	Vendim për formimin e komisionit për verifikimin e procesit të dhënies në shfrytëzim të pronave të komunës		√			

25 maj 2022						
Nr.	Vendimet e miratuar	Vendimet e zbatuara	Vendimet në procedurë të zbatimit	Vendimet e pa zbatuara	Arsyeja e mos zbatimit	Vërejtje
1	Vendim për ndarjen e mirënjohjeve për Ditën e Çlirimit (17 qershor 2022)	√				
2	Vendim për ndarje të titullit “Qytetar Nderi”	√				
3	Vendim për ndarje të titullit “Nderi i Qytetit”	√				
4	Vendim për ndarje të çmimit “Emblema e Vushtrisë”	√				
5	Vendim për ndarje të çmimit “Hasan Prishtina”	√				
6	Vendim për formimin e komisionit caktimin e kufijve të lagjeve urbane	√				
7	Vendim për formimin e komisionit kuvend-qeveri lidhur me shfrytëzimin e objektit të ish shkollës në Stanoc të Epërm		√			
8	Vendim paraprak për aprovimin e listës së veçantë për dhënie në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës	√				

Qershor 2022						
Nr.	Vendimet e miratara	Vendimet e zbatuara	Vendimet në procedurë të zbatimit	Vendimet e pa zbatuara	Arsyeja e mos zbatimit	Vërejtje
1	Vendim për aprovimin e komizës buxhetore 2022/2024		√			
2	Vendim për emërtimin e lagjeve urbane në qytet		√			
3.	Vendim për lirim nga pagesa për shfrytëzim të hapësirave para lokaleve të gastronomisë		√			
4.	Vendim për caktim të lokacionit për treg të gjelbër		√			

Sic shihet nga të dhënat e mësipërme, janë miratuar gjithsej 41 vendime, nga të cilat, janë zbatuar 27, ose 65.8 %, në procedurë janë 13 ose 31.7 %, ndërsa nuk është zbatuar 1 vendim ose 2.4 %.

Në muajt në vijim do të bëhen përpjekje që të zbatohen gjitha vendimet të cilat miratohen në kuvendin e komunës.

Me Respekt!

**Ferit Idrizi**

  
Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA VUSHTRRI

**Për:** Kuvendin e Komunës  
**Propozues:** Kryetari i Komunës  
**Hartues:** Drejtoria për Administratë  
**Çështja për shqyrtim:** Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, si dhe nenin 41, paragrafi 2, shkronja “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 2022 merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E KËSHILLAVE**  
**LOKALE**

1. Me këtë vendim themelohet komisioni për koordinimin e procesit për përzgjedhjen e këshillave lokale në këtë përbërje:

- 1.1 \_\_\_\_\_, anëtar i Kuvendit të komunës;
- 1.2 \_\_\_\_\_, anëtar i Kuvendit të komunës;
- 1.3 \_\_\_\_\_, anëtar i Kuvendit të komunës;
- 1.4 \_\_\_\_\_, anëtar i Kuvendit të komunës;
- 1.5 \_\_\_\_\_, anëtar i ekzekutivit të komunës;
- 1.6 \_\_\_\_\_, anëtar i shoqërisë civile, dhe
- 1.7 \_\_\_\_\_, përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjia urbane.

2. Komisioni komunal për përzgjedhjen e këshillave lokale do t’i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane.

3. Mandati i Komisionit komunal për përzgjedhjen e këshillave lokale është i lidhur me mandatin e Kuvendit komunal.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit**

## **A r s y e t i m**

Me aprovimin e Rregullores për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, është obligim i komunës që të themelojë Komisionin komunal për themelimin e këshillave lokale.

Me qëllim të zbatimit të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, si dhe zbatimit të Rregullores për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, si dhe duke marrë për bazë faktin se shumicës së këshillave lokal ju ka kaluar mandati, i propozojmë Kuvendit të komunës që ta miratojë këtë propozim-vendim si në dispozitiv.

**Me respekt!**



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Për: Kuvendin e Komunës  
Propozues: Kryetari i Komunës  
Hartues: Drejtoria për Shërbime Publike  
Tema: Propozim – vendim

*[Handwritten signature]*  
*[Handwritten signature]*

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 41 paragr. 41.2 shkronja “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën \_\_\_\_\_ 2022 këtë:

#### V E N D I M

#### PËR LIRIM TË EKONOMIVE FAMILJARE NGA PAGESA E KYÇJES NË RRJETIN E UJËSJELLËSIT

1. Me këtë vendim lirohen Ekonomitë familjare të Komunës së Vushtrrisë nga pagesa për kyçjet e mbetura në rrjetin e ujësjellësit që do të realizohen në bazë të kontratës ekzistuese “Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit” të cilën është duke e imlementuar operatori ekonomik “Ilea Group” që është duke i kryer punët në terren.
2. Vlera e mjeteve financiare për pjesën e mbetur sipas kontratës me operatorin ekonomik do të paguhet nga mjetet e planifikuara me buxhetin e komunës dhe Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli Latifi

Kryesues i Kuvendit

## Arsyetim

Komuna e Vushtrrisë me qëllim të realizimit të projektit „Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit”, të cilën është duke e imlementuar operatori ekonomik “Ilea Group”, ka lidhur marrëveshje me KRU „Mitrovica”, për kyçjen e ekonomive familjare me ç’rast janë obliguar qytetarët që në emër të participimit për kyçje të paguajnë vlerën prej 80 €.

Mirëpo aktualisht, Komuna e Vushtrrisë këtë taksë e ka vlerësuar si të panevojshme dhe ngarkesë për buxhetin familjar, prandaj edhe ka hartuar propozim vendimin për shfuqizimin e vendimit paraprak.

Vlera e mjeteve financiare për pjesën e mbetur sipas kontratës me operatorin ekonomik do të paguhet nga mjetet e planifikuara me buxhetin e komunës dhe Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë.

Prandaj bazuar në të cekurat e mësipërme, i propozojmë kuvendit të komunës që të miratojë këtë propozim vendim.

Me respekt,





Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Për: KPF-në dhe Kuvendin e Komunës

Propozues: Ferit Idrizi, Kryetari i Komunës

Hartues: Abit Abiti, Zyrtar Kryesor Financiar

Propozim Vendim: Për transferin e mjeteve financiare të Komunës së Vushtrrisë

Bazuar në nenin 15 të Ligjit Nr. 08/L-066 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, në lidhje me Nenin 30.1, 30.5 shkronja "c" të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe nenin 12 paragrafi 2 shkronja "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe nenit 41 paragrafi 2 shkronja "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 2022, merr këtë:

#### VENDIM

#### PËR TRANSFERIN E MJETEVE FINANCIARE TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim bëhet transferimi i mjeteve financiare në vlerë 9,319.56€ të cilat transferohen nga programi Bujqësia, Projekti bashkëfinancim me donator, kodi i projektit 49561, në programin Arsimit fillor (93690) në projektin Ndërtimi i tualeteve në SHMU "Emin Duraku" kodi i projektit 51854.
2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi mbeten në kuadër të kategorisë Shpenzime kapitale dhe në kuadër të fondit të njëjtë, Fondi 21.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Formulari i Thesarit
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
5. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

Kryesuese e Kuvendit

## **Arsyetim**

Për shkak të ndryshimit të çmimeve për realizimin e projektit Ndërtimi i tualeteve në SHMU "Emin Duraku", nevojiten mjete shtesë në vlerë prej 9,319.56 €, të cilat merren nga Projekti bashkëfinansim me donator, i cili projekt ndikohet negativisht vetëm 3.67%, e cila është e lejuar deri në 5 %, e cila lejohet sipas legjislacionit në fuqi.

Transferi i tillë bëhet sipas propozimit të njësisë kërkuese (Drejtoria e Arsimit), për realizimin e suksesshëm të projektit në fjalë.

Nga të cekurat më lartë i propozojmë Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht kuvendit të komunës që ta aprovoj këtë propozim-vendim si në dispozitiv të tij.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRAN  
02 Nr. / Nr. 899/22  
Nr. / Nr. / Be. at  
Datim / Datum 08.07.2022  
YUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr. 10, Tel.038/200 42402, E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net

PËR/ZA/TO:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Ferit Idrizi Kryetari i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë e znj. Pranvera Hyseni, - ju dërgohet

Të nderuar anëtarë të KPF/Kuvendit,

Të bashkëngjitur keni Kërkesën e Znj. Pranvera Hyseni nga fsh. Shalë Komuna e Vushtrisë datë 04.07.2022 për mbështetje financiare për realizim të eventit shkencor përkatësisht projektit "Festivali i Astronomisë" që planifikon t'a organizoj për t'u mbajtur në Vushtri nga data 09-16 gusht 2022.

Kostoja e projektit 2575 €.

Duke qenë se me Rregulloren e komunës për ndarje të subvencioneve nuk kam të drejtë të ndaj mjete financiare nga buxheti i komunës – transfere dhe subvencione më tepër se 1000 €, ju propozoj që kërkesën e znj. Pranvera Hyseni ta shqyrtoni dhe aprovoni pasi që konsideroj se ky projekt është mjaft atraktiv dhe me interes për të rinjtë e Komunës sonë të cilët janë të interesuar të merren me studime në fushën e astronomisë.

Me respekt!

4/7/2022

## KËRKESË

Për: Kabinetin e Kryetarit të Vushtrrisë

I nderuar Kryetarë, z. Ferit Idrizi,

Jam Pranvera Hyseni, themeluese e organizatës së astronomisë në Kosovë “Astronomy Outreach of Kosovo”, aktualisht duke kryer studimet e doktoratës në Shkenca Planetare në Universitetin e Kalifornisë në Santa Cruz të SHBA-së, dhe njëkohësisht jam e involvuar në implementimin e aktiviteteve të shumta shkencore në Kosovë.

Kosova është vendi i vetëm në botë që nuk ofron kushte për hulumtime në fushën e Astronomisë. Mungesa e kushteve të infrastrukturës kërkimore-shkencore, bënë që shumë studentë dhe të rinjë të ngecin në identifikimin e prioriteteve kërkimore-shkencore të nivelit të mesëm shkollor dhe universitar. Duke u mbështetur në arsyetimin e mësipërm, ne si organizatë e punës shkencore kemi hartuar një projekt-propozim me qëllim që të realizojmë Konventën e parë Ndërkombëtare të Astronomisë në Kosovë, të cilën planifikojmë të realizojmë në qytetin e Vushtrrisë nga 9 – 15 gusht 2022. Konventa në fjalë do të mbledh në Kosovë disa nga mendjet më të shquara të botës nga fusha e Astronomisë, si dhe do të jetë evenimenti i parë i tillë në Ballkan, i ashtuquajtur, Festival i Astronomisë (Astrofest).

Astronomy Outreach of Kosovo është organizatë shkencore jo-profitabile, e themeluar më 10 Janar 2015. Veprimtaria jonë është e koncentruar kryesisht në popullarizimin e shkencës dhe astronomisë në Republikën e Kosovës, nëpërmjet aktiviteteve edukativo-shkencore. Jemi organizata e vetme në Evropën Lindore që kemi arritur mbi 25,000 pjesëmarrës brenda një viti në aktivitetet tona edukativo-shkencore. Jemi të vetmit që kemi përfaqësuar Kosovën në qendrën e NASAs si dhe në shumë observatorë dhe qendra tjera shkencore anembanë botës. Aftësimi i popullsisë së vendit tonë me bazat fundamentale të shkencës është prioriteti ynë.

Si themeluese e organizatës së astronomisë, kërkoj nga ju që të na bashkoheni si institucion dhe të keni në konsideratë aprovimin e fondeve për të mundësuar ardhjen e astronomit më prominent të botës në Kosovë, Dr. Seth Shostak nga Instituti për Kërkime të Jetës Jashtëtokësore, SETI. Në këtë email, ju kam bashkangjitur projekt-propozimin e detajizuar, për të cilin shpresoj që ndani një shumë të konsiderueshme financiare në mënyrë që të na mundësohet grumbullimi i fondeve të mjaftueshme për realizimin e këtij evenimenti shkencor.

Sinqerisht,  
Pranvera Hyseni



Kandidate për PhD në Shkenca Planetare,  
Universiteti i Kalifornisë, Santa Cruz, SHBA  
Themeluese e AOK – Astronomy Outreach of Kosovo  
[physeni@ucsc.edu](mailto:physeni@ucsc.edu)  
+1 (906) 221-5215



**Astronomy Outreach of Kosovo**  
Programi më i lartë jo-profitabil për popullarizimin e Astronomisë në Republikën e Kosovës  
E-mail: [aok.cbsap@hotmail.com](mailto:aok.cbsap@hotmail.com)

---

## **PROJEKT – PROPOZIM**

**Titulli i projektit:**  
**FESTIVALI I ASTRONOMISË**

**Për:**  
**KABINETIN E KRYETARIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË**

**Dërgon:**  
**PRANVERA HYSENI**  
Themeluese e organizatës së Astronomisë “Astronomy Outreach of Kosovo”

Kandidate për PhD në Shkenca Planetare

Universiteti i Kalifornisë, Santa Cruz

E-mail: [physeni@ucsc.edu](mailto:physeni@ucsc.edu)

Nr. Kontaktues: +1 (906) 221-5215

### **1. Parathënie:**

StarLight Festival (Festivali i Astronomisë) do të jetë Konventa e Parë Ndërkombëtare e Astronomisë që do të mbahet në Republikën e Kosovës. Qëllimi i kësaj konvente është të promovojë shkencën e Astronomisë dhe fushave tjera shkencore, si dhe të inkurajojë të rinjtë e Kosovës të vazhdojnë studimet në shkencë, teknologji, inxhinieri, dhe matematikë (STEM).

### **2. Qëllimet dhe objektivat:**

- ✓ Popullarizimi i Astronomisë dhe shkencës në Kosovë,
- ✓ Integrimi i studentëve dhe qytetarëve në aktivitete STEM,
- ✓ Nxitja dhe inkurajimi i nxënësve dhe studentëve për vrojtime dhe zbulime të rëndësishme qiellore,
- ✓ Vrojtimi i trupave qiellor nëpërmjet pajisjeve optike,

### **Sqarime shtesë mbi qëllimin e Festivalit të parë Ndërkombëtar të Astronomisë**

Ëndrra e secilit individ është të shohë përtej vetvetes, të studiojë, eksplorojë dhe shoh se çfarë ofron qielli. Zhvillimi ynë psikik ndikon në rritjen e diapazonit të njohurive sociale, ekonomike dhe shkencore. Ekspertiza në fushat e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës (STEM) do të luajë një rol kyç në aftësimin e gjeneratave të reja në Kosovë për të qenë ekonomikisht konkurruese me vendet tjera. Jemi të informuar për zhvillimin dhe evoluimin e shkencës së Astronomisë në Kosovë. Mungesa e kushteve të infrastrukturës kërkimore-shkencore, bënë që shumë studentë dhe të rinjë të ngecin në identifikimin e prioriteteve kërkimore-shkencore të nivelit të mesëm shkollor dhe universitar. Duke u mbështetur në arsyetimin e mësipërm, ne si organizatë e punës shkencore kemi hartuar këtë projekt-propozim me qëllim që të realizojmë Konventën e parë Ndërkombëtare të Astronomisë në Kosovë. Konventa në fjalë do të mbledh në Kosovë disa nga shkencëtarët më të shquar të botës nga fusha e Astronomisë. Mënyra e realizimit të aktiviteteve teorike dhe praktike në disiplinën e Astronomisë gjatë kësaj konvente shkencore të paraqitura në detaje më poshtë, do të ketë qasje kreative dhe të do zgjojë interesim të madh tek studentët dhe qytetarët e vendit. Ne besojmë që një aktivitet si ky do të ndikonte jashtëzakonisht në aftësimin e popullsisë me bazat fundamentale të shkencës dhe astronomisë dhe do të rezultonte në një të ardhme të ndritur për shkencën në vendin tonë.

### **3. Përfituesit:**

- ✓ Nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme,
- ✓ Studentët e fushave të ndryshme,
- ✓ Qytetarët e vendit.

#### **4. Lokacioni:**

✓ Vushtri

Prezantimet do të mbahen në: në *Shtëpinë e Kulturës* si dhe në *Kalanë e qytetit të Vushtrrisë*

Aktivitetet vrojtuese do të mbahen në: Sheshin "*Adem Jashari*" në Vushtri

#### **5. Kohëzgjatja dhe agjenda:**

**9 - 16 gusht, 2022**

*9 gusht* – ardhja e astronomëve në Kosovë nga SHBA-të

*10 gusht* – konferencë për media si dhe takim i astronomëve me Kryetarin e Komunës, z. Idrizi

*11 gusht* – hapja zyrtare e festivalit në Vushtri, takim me Ambasadorin Amerikan

*12 gusht – 15 gusht* – prezantime në fushën e astronomisë nga profesorë dhe astronomë ndërkombëtarë dhe të vendit

*16 gusht* – mbarimi i festivalit si dhe kthimi i mysafirëve në vendlindje

Festivali do të jetë i hapur për të gjithë qytetarët e vendit, pa dallim moshe, race, etnie.

#### **6. Prezantuesit:**

Prezantuesit në Konventën e Parë të Astronomisë në Kosovë do të jenë astronomë me renome ndërkombëtare si dhe nga vendi, të cilët do të shpalosin hulumtimet e tyre kërkimore-shkencore në fushën e Astronomisë dhe Shkencave Planetare, duke sjellë risi nga më të ndryshmet nga hapësira kozmike.

**Dr. Seth Shostak** – *Astronom, Instituti për Hulumtime të Jetës Jashtëtokësore SETI, SHBA*  
Titulli i prezantimit: "*The Origin of Life in the Universe and the Search for Extraterrestrial life forms (Origjina e Jetës në Univers si dhe Kërkimet për Forma të Jetës Jashtëtokësore)*"

**Prof. Dr. Rasim Bejtullahu** – *Profesor i Astronomisë dhe Fizikës në Universitetin e Prishtinës*  
Titulli i prezantimit: "*Evolucioni i Galaktikave dhe formimi i Vrimave të Zeza*"

**Prof. Syleme Gogolli** – *Profesoreshë në Gjinnazin “Eqrem Qabej” Vushtrri*

*Titulli i prezantimit: “Konstelacionet dhe Rëndësia e Kordinatave Qiellore”*

**Prof. Asllan Sallahu** – *Ish-profesor i Gjeografisë në Gjinnazin “Eqrem Qabej” Vushtrri*

*Titulli i prezantimit: “Toka – Planeti i Vetëm i Banueshëm në Sistemin Diellor”*

**Prof. Milaim Rushiti** – *Profesor i Astronomisë dhe Fizikës në Gjinnazin “Kuvendi i Arbërit” Ferizaj,*

*Titulli i prezantimit: “Pajisjet optike: llojet e teleskopëve”*

**Pranvera Hyseni** - *Kandidate për PhD në Shkenca Planetare në Universitetin e Kalifornisë, Santa Cruz / Themeluese e Astronomy Outreach of Kosovo – AOK*

*Titulli i prezantimit: “Formation and Evolution of the Solar System (Formimi dhe Evolucioni i Sistemit Diellor)*

Vëmendje: Temat e prezantimeve mund të jenë të ndryshme nga vendi në vend.

## **7. Aktiviteti praktik:**

Aktiviteti praktik do të përfshijë vrojtimin e trupave qiellor nëpërmjet pajisjeve optike që posedon organizata AOK. Vrojtimi do të realizohet në sheshin “Adem Jashari” në Vushtrri, në mënyrë që çdo qytetar të ketë mundësinë të vrojtojë me teleskop. Vrojtmet do të mbahen në dy faza: gjatë ditës do të bëhet vrojtimi i Diellit në tri gjatësi valore me teleskopë solarë, dhe në mbrëmje do të bëhet vrojtimi i Hënës si dhe planetëve të sistemit diellor me teleskopë të llojeve reflektor dhe refraktor. Aktiviteti praktik do të përfshijë gjithashtu vrojtimin e Diellit me syze solare që do të shpërndahen falas për qytetarët nga organizata jonë, ekspozitë e koleksionit të copëzave shkëmbore të ardhura nga hapësira ndërplanetare (meteorëve), leximi i hartave yjore, njohja e konstelacioneve, si dhe aktivitete tjera argëtuese edukativo-shkencore.



## **8. Stafi i projektit**

Ekipi i projektit përbëhet kryesisht nga studentë dhe profesorë të disiplinave të ndryshme shkencore, që kanë dëshmuar sukses në realizimin e qindra aktiviteteve edukativo-shkencore anembanë Kosovës për vite me radhë, të cilët do të angazhohen dhe përkujdesen në implementimin dhe realizimin e qëllimit të këtij projekti. Ekipi përbëhet nga:

**Pranvera Hyseni** – *Kandidate për PhD në Shkenca Planetare në Universitetin e Kalifornisë, Santa Cruz / Themeluese e Astronomy Outreach of Kosovo – AOK*

**Prof. Milaim Rushiti** – *Profesor i Astronomisë dhe Fizikës në Gjimnazin "Kuvendi i Arbërit Ferizaj / Drejtor ekzekutiv i Astronomy Outreach of Kosovo - AOK*

**Faton Hetemaj** – *Master i Gjeologjisë në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" / Inxhinier i Gjeologjisë në minierën e Trepqës*

**Visar Azemi** – *I diplomuar në Departamentin e Gjeografisë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, UP*

**Bujar Mehmeti** – *Student në Departamentin e Fizikës në Universitetin e Debrecenit, Hungari / PR i Unionit Studentor Ndërkombëtar*

**Florentina Maxhuni** – *Studente e Inxhinerisë në Universitetin e Prishtinës*

**Besart Musa** – *Student në Departamentin e Gjeografisë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, UP*

**Euron Ilazi** – *Fotograf*

## **8. Emri i kordinatorit dhe detajet e kontaktit:**

Pranvera Hyseni, +1 (906) 221-5215, [physeni@ucsc.edu](mailto:physeni@ucsc.edu)

Adresa e përkohshme: 293 Chateau La Salle Drive, San Jose, CA 95111

Adresa e përgjithshme: Rr "Vëllezërit Fazliu", Shallic, Vushtrri 42000 RKS,

## 9. Pasqyra e Shpenzimeve

Pasqyra në vijim paraqet në mënyre analitike parashikimet e aktiviteteve dhe vlerat që kërkohet të mbulohen nga buxheti i Kabinetit të Komunës së Vushtrisë.

Përshkrimi i aktivitetit	Kosto për person	Njësia (Ditë)	Numri i personave	Total (Euro)
Bileta kthyes <sup>1</sup>	1245	1	1	1245
Akomodimi <sup>2</sup>	72	7	1	504
Ushqimi <sup>3</sup>	40	7	1	280
Transporti brenda KS <sup>4</sup>	30	7	1	210
<b>TOTAL BUXHETI (pa kostot e rastësishme)</b>				<b>2239</b>
15% e shumës totale <sup>5</sup>				336
<b>TOTAL BUXHETI (me kostot e rastësishme)<sup>6</sup></b>				<b>2575</b>

1. Bileta kthye sipas Turkish Airlines (San Francisco – Prishtinë / Prishtinë – San Francisco) = 1245€, qershor 2022. Kostoja e biletave varen nga data dhe vendi.
2. Kostoja e qëndrimit në hotel sipas Hotel Nartel, Prishtinë = 72.5€ nata.
3. Kostoja e ushqimit për dy shujta në ditë.
4. Makinë me qira për 7 ditë.
5. Kosto e rastësishme është e paraparë të mbuloj çdo luhatje në çmime që mund të paraqiten përgjatë aktivitetit.
6. Fondi i tepruar nga buxheti total do t'i kthehet secilit institucion përkatës që mbështet këtë projekt-propozim.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUCITRN

01 Nr. / Br 171/22

Nr. i fq. / Br. sh - 1 -

Data / Datum 18.7.2022

VUSHTRRIË - VUCITRN



KOMUNA VUSHTRRI  
OPËSTINA VUCITRN

<b>DATE</b>	<b>18.7.2022</b>
<b>PËR/ZA/TO:</b>	<b>Kuvendin e Komunës</b>
<b>NGA/OD/FROM:</b>	<b>Melihate Basholli - Latifi</b> <b>Kryesuese e kuvendit</b>
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>Rekomandim i KPF-së</b>



Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 15 korrik 2022 ka rekomanduar që të futet në rend të ditës në mbledhjen e rregullt të Kuvendi të Komunës, (e cila do të mbahet më 28 korrik 2022) <Rishqyrtimi i vendimit nr. 81/21 i datës 16.4.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh.

Me respekt



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	81 / 21
Nr. i fq. / Br. st	- 2 -
Data: / Datum	16. 04. 2021
VESHTRRI - VUÇITRN	



## Republika e Kosovës

## Kuvendi i Komunës-Vushtri

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 shkronja "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 19 paragrafi 3 pika 3.1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 11 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Zonat Ekonomike Nr. 04/L-159, nenit 22 paragrafi 1 i Rregullores (QRK) NR.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 41, paragrafi 2 shkronja "ç" të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në rekomandimin e Komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të datës 31 mars 2021, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më **16 prill 2021**, merr këtë:

### VENDIM

### PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh bizneseve private, nga parcelat e evidentuara në certifikatën e pronësisë P-70202011-00435-1 dhe P-70202011-00435-3, në sipërfaqen e tërësishme prej 14.86 ha, Zona Kadastrale Lumadh, pronë e Komunës së Vushtrisë.

2. Ngastrat kadastrale si në pikën 1 (një) të këtij vendimi, iu jepen në shfrytëzim afatgjatë subjekteve afariste për ushtrim të veprimtarive biznese, si vijon:

- 2.1. Solid Group SH.P.K.;
- 2.2. Druri SH.P.K.;
- 2.3. B.t.p. Holding SH.P.K.;
- 2.4. Timber Home SH.P.K.;
- 2.5. Time N.T.P.;
- 2.6. Unikonzum;
- 2.7. Mateo Company SH.P.K.;
- 2.8. Homestar N.T.P.;
- 2.9. Vazo SH.P.K.;
- 2.10. Bunsam Metal SH.P.K.;
- 2.11. Euro Driloni;

- 2.12. Bina SH.P.K.;
- 2.13. Ra Eximp SH.P.K.;
- 2.14. Emona Center SH.P.K.;
- 2.15. Berto SH.P.K.;
- 2.16. Te Duli D.P.Z.;
- 2.17. Trios Group SH.P.K.;
- 2.18. Bvd Ing. SH.P.K.;
- 2.19. AH Invest SH.P.K.;
- 2.20. Ajna Cake SH.P.K.;
- 2.21. Union SH.P.K.;
- 2.22. 7 Vëllezërit SH.P.K.

3. Bizneset e cekura si në pikën paraprake, në tri në 3 vitet e para nga data e nënshkrimit të kontratës me komunën, nuk do të paguajnë kompensim, ndërsa pas tri viteve do të paguajnë 0.05 € (pesë cent) për m<sup>2</sup> në vit.

4. Prona e paluajtshme e komunës iu jepet në shfrytëzim subjekteve ekonomike në afat prej nëntëdhjetë e nëntë (99) viteve.

5. Obligohet Kryetari i Komunës që të lidhë kontratë me secilin përfaqësues të biznesit të cekura në pikën 2 (dy) të këtij vendimi.

6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: rekomandimi i komisionit vlerësues dhe dokumentacioni shtesë i paraparë me legjislacionin në fuqi.

7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

8. Ky vendim hyn fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep: DPKI  
Nr. Prot: 06-02/1326/22  
Data: 25-03-2022  
Prishtine

DATE/A:	24.03.2022
REFERENC-Ë:	AKK-DPKI-06-1655/21
PËR/ZA/TO:	znj. Melihate Basholli - Latifi, Kryesuese e Kuvendit Komunal në Vushtrri
CC:	z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë z. Ilmi Azemi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri z. Fitim Halili, Ish. Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri znj. Venera Çerkini Zëvendës Sekretare e përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Yll Buleshkaj, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Esad Ejupi, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	OPINION lidhur me trajtimin e rastit të konfliktit të interesit

E nderuara znj. Basholli - Latifi,

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar dy kërkesa të ndara (raportues të rastit) për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit, lidhur me pretendimet si në vijim;

Pretendimi i parë, lidhet me atë se; z. Ilmi Azemi, duke qenë Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal së Vushtrrisë të datës 16.04.2021 ka deklaruar konflikt interesi në raport me biznesin Sh.P.K "Mateo Company", por ka abstenuar në votim, e që duke abstenuar në votim, i ka mundësuar Kuvendit Komunal të Vushtrrisë të bëjë

kuorumin lidhur me vendimmarrjen nr.81/21, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës në parkun industrial në "Lumadh".

Pretendimi i dytë, lidhet me atë së; z. Fitim Halili, duke qenë Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë lidhur me vendimmarrjen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës në parkun industrial në "Lumadh", të datës 16.04.2021, ka deklaruar konflikt interesi, por ka abstenuar në votim, e që duke abstenuar në votim, i ka mundësuar që Kuvendi Komunal të bëjë kuorumin për vendimmarrje. Kjo për shkak se bashkëshortja e tij znj. Nuriye Halili, me biznesin SH.P.K "Bina", ka qenë e rekomanduar për dhënien e paluajtshmërisë në shfrytëzim afatgjatë në parkun industrial në "Lumadh".

Agjencia kundër Korrupsionit konform kompetencave të saj të përcaktuara me Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, në cilësinë e autoriteti qendror për mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave të Ligjit në fjalë, në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.12) të Ligjit nr.03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 21 (paragrafi 1, nën paragrafët 1.4, 1.5 dhe 1.7) të LPKI-së, pas vlerësimit të rrethanave lidhur me rastin konkret, Agjencia ofron këtë:

## OPINION

- Ekziston konflikt i interesit për zyrtarin e lartë z. Ilmi Azemi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, lidhur me pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë të datës 16.04.2021, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me kompensim bizneseve private, pronën e paluajtshme të Komunës në parkun industrial në "Lumadh", ku në mesin e të përzgjedhurve ishte znj. Fllanza Sadiku - Azemi, me të cilën ka lidhje familjare (bashkëshortja e djalit të vëllait).
- Ekziston konflikt i interesit për zyrtarin e lartë z. Fitim Halili, ish Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri lidhur me pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë të datës 16.04.2021, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të bizneseve private, pronën e paluajtshme të Komunës në parkun industrial në "Lumadh", ku në mesin e përfutuesve ishte edhe znj Nuriye Halili, me të cilën ka lidhje familjare (bashkëshortja).

## ARSYETIM

Agjencia kundër Korrupsionit duke u bazuar në Ligjin nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit, ka njoftuar zyrtarët e lartë për fillimin e procedurës për shqyrtimin të gjendjes së konfliktit të interesit. z. Ilmi Azemi dhe z. Fitim Halili, nuk janë përgjegjës shkresës së Agjencisë lidhur me sqarimin e situatës së pretenduar për konflikt interesi.

Me qëllim të sqarimit të këtij rasti Agjencia ka kërkuar dokumentacionin dhe informatat shtesë nga Komuna e Vushtrrisë lidhur me procesin vendimmarrës për dhënia në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në parkun industrial në "Lumadh", (shkresa me nr. protokoll 06-02-1727/21). Duke vepruar sipas kërkesës në fjalë Komuna e Vushtrrisë ka dërguar në Agjenci dokumentacionin e kërkuar (shkresa me nr. protokoll 35183/21).

Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar dhe pranuar dosjen për vendosjen e ligjshmërisë së vendimit nr.81/21 nga Ministria e Pushtetit Lokal. Shkresat me nr.(06-02/2019/21 - 020-363/5).

Agjencia kundër Korrupsionit ka analizuar kërkesat e raportuesve të rastit, dokumentacionin e pranuar nga Komuna e Vushtrrisë dhe nga Ministria e Pushtetit Lokal, provat e siguruara sipas detyrës zyrtare dhe më pas ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim;

- Me datë 26.11.2020, Komuna e Vushtrrisë ka nxjerr vendim paraprak me nr.239/20 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës.
- Kuvendi Komunal në Vushtri me datë 26.11.2020 ka nxjerrë vendim me nr. 269/20 për shpalljen e konkursit publik për vendosjen e bizneseve në parkun industrial në Lumadh.
- Kuvendi Komunal në Vushtri me vendimin nr.240/2020 të datës 26.11.2020 ka formuar komisionin për vlerësimin e ofertave dhe për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në fshatin "Lumadh". Pjesë përbërëse e këtij komisioni ishte edhe Ilmi Azemi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtri.
- Komisioni për vlerësimin e ofertave dhe për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në fshatin "Lumadh", me datë 16.04.2021, ka shpallë njoftimin për përzgjedhjen e aplikuesve për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin "Lumadh". Aplikantët që nuk janë përzgjedhur, u është dhënë e drejta të parashtrijnë ankesë brenda afatit prej 7 ditësh në komisionin e ankesave të Komunës së Vushtrrisë.
- Komisioni vlerësues me datë 31.03.2021 i ka rekomanduar Kuvendit Komunal në Vushtri bizneset përfituese për shfrytëzimin e paluajtshmerive në parkun e biznesit



"Lumadh", duke u bazuar në kriteret e vlerësimit të përcaktuara me vendimin nr.269/20 të datës 30.12.2020 të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë .

- Me datë 16.04.2021, është mbajtur mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, bazuar në procesverbalin e mbajtjes së seancës z. Ilmi Azemi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, gjatë seancës ka deklaruar si në vijim: *"njoftoi Kuvendin se ai do të qëndroi në sallën e kuvendit, por vota e tij do të jetë abstenim me qëllim të shmangies së konfliktit eventual të interesit. Sepse kjo parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, por ai do të marrë pjesë, por që vota e tij nuk dëshiron të jetë përcaktuese në kahjen e këtij vendimi që do të merret"*.
- Ndërsa z. Fitim Haliti, ish Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, në seancën e Kuvendit Komunal ka deklaruar se *" deklaroj se për shkak të konfliktit të interesit eventual lidhur me vendimmarrjen njoftoi se vota e tij do të jetë abstenim"*.
- Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka nxjerr vendim me nr. 81/21 të datës 16.04.2021 për dhënien afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.
- Për këtë vendimmarrje kanë votuar 13 vota për, dy vota kundër dhe tre vota abstenim, ndërsa ish Kryesuesi i Kuvendit Komunal nuk kishte marrë pjesë në votim.
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me datë 26.04.2021 e ka bërë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit nr.81/21 të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë.

Zyrtari i lartë z. Azemi, ka qenë anëtar i komisioni për vlerësimin e ofertave dhe për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në fshatin "Lumadh" dhe në takimin e mbajtur të komisionit të datës 12.03.2021, në procesverbal shprehimisht është shkruar *"është votuar lista e aplikuesve që kanë plotësuar kriteret, përveç aplikuesit "Mateo Group", ku anëtar i komisionit z. Ilmi Azemi, nuk ka marrë pjesë në votim e kësaj kompanie, pasi që ka konflikt interesit"*.

Por i njëjti në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të paluajtshmërive në fshatin Lumadh, ka marrë pjesë në votim dhe ka votuar abstenim, e që vota e tij ka ndikuar që seanca e Kuvendit lidhur me vendimmarrjen të bëjë kuorumim.

Edhe ish zyrtar i lartë z. Halili, në seancë të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë ka deklaruar konflikt interesit dhe ka votuar abstenim lidhur me vendimmarrjen për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin "Lumadh".

Person i afërt me zyrtarin dhe Interesi privat i zyrtari është i përcaktuar në nenin 3 (pika 3, 6) të Ligjit nr.06/I-011 për parandalimin e konfliktit të interesit;

*1.6. Person i afërm me zyrtarin – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.*

*1.2 Interes privat i personit zyrtar – nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste.*

Në nenin 17 të Ligjit nr.06/L.-011 për parandalimin e konfliktit të interesit është përcaktuar deklarimi “rast për rast” i interesave private të zyrtarit në të cilin thuhet;

Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit

- 1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.*
- 2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo kërkohet nga udhëheqësi ose nga institucioni udhëheqës apo mbikëqyrës. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e kërkesës ose e konstatimit të konfliktit të interesit.*
- 3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.*
- 4. Për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, institucioni punëdhënës regjistron identitetin e zyrtarit, interesat private të tij, shkak për një konflikt interesi dhe konfliktin apo papajtueshmërinë e konstatuar, palët e interesuara, burimin e informatave, si dhe vendimet e marra për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.*
- 5. Deklaratat për interesat private dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë konsiderohen dokumente zyrtare.*

Në rastin konkret, zyrtarët z. Azemi dhe Halili, në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal në Vushtrri, kanë deklaruar konflikt interesi, por nuk janë tërhequr nga vendimmarrja duke votuar abstenim.

Në nenin 48.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale shprehimisht thuhet;

*Në të gjitha takimet e kuvendit të komunës dhe komitetet e tij, çdo person, përfshirë edhe kryesuesin, ka nga një votë, por kryesuesi ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi. 48.2 Nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht në këtë ligj, vendimet e kuvendit të komunës aprovohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë. 48.3 Abstenimet regjistrohen me qëllim të themelimit të kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.*

Fakti që z. Ilmi Azemi dhe z. Fitim Halili kanë pasur interesa private dhe këtë e kanë deklaruar në seancën e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë nënkupton atë se zyrtarët do të duhej të mos merrnin pjesë në vendimmarrje për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit, por kjo nuk ka ndodhë dhe këta zyrtar kanë votuar abstenim. Ndërsa votat e tyre abstenim kanë qenë thelbësore dhe përcaktuese në formimin e kuorumit. Në këtë rast zyrtarët kanë vepruar në kundërshtim me nenin 17 pika 1 të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit.

Nga 35 anëtar sa ka kuvendi Komunal në Vushtri për vendimmarrje me nr.81/21 kanë votuar 13 vota për, dy vota kundër dhe tre vota abstenim, ndërsa ish Kryesuesi i Kuvendit Komunal nuk kishte marrë pjesë në votim.

Zyrtarët z. Azemi dhe z. Halili me veprimet e tyre në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal në Vushtrrisë kanë vepruar në kundërshtim edhe me nenin 5 pika 1.9 të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në të cilën thuhet;

*9. "Zyrtari nuk mund të përdorë pozitën apo funksionin e vet për t'i avancuar interesat e veta personale apo të personave të afërm".*

Konflikt i interesit për anëtarët e Kuvendit Komunal është i përcaktuar edhe me Ligjin 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, konkretisht në nenin 38 shprehimisht thuhet;

*37.1. Anëtari i Kuvendit të Komunës apo anëtari i komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrje të vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me çështje në të cilën ai/ajo, apo ndonjë anëtar i familjes së tij/saj ka interes personal apo material.*

*37.2. Çdo anëtar duhet të shfaq të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është prezent. Çdo anëtar mund të ofrojë informacionet për interesat e anëtarit tjetër të kuvendit.*

*37.3 para mbledhjes së parë të kuvendit të komunës, anëtarët e kuvendit duhet të regjistrojnë deklarata e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare në një regjistër publik të cilën e mbanë udhëheqësi i personelit. Anëtarët duhet të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa ato të ndodhin.*

Në mbështetje të nenit 23 pika 1.13 të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit si dhe nenit 37 pika 37.4 të Statutit nr.58/11 të Komunës së Vushtrrisë, Agjencia kërkon nga ju si Kryesues e Kuvendit Komunal në Vushtri iniciimin e procedurës për rishqyrtimin e vendimit nr.81/21 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës në parkun industrial në "Lumadh".

Në nenin 23 pika 1.13 të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit shprehimisht thuhet se;

*13. Agjencia i kërkon rishqyrtimin, revokimin dhe/ose shfuqizimin e aktit të nxjerrë në konflikt të interesit organit që e ka nxjerrë atë. Që nga momenti kur Agjencia kërkon rishqyrtimin e vendimit, çdo veprim për zbatimin e tij pezullohet deri në momentin kur organi vendos për vlefshmërinë e vendimit.*

Agjencia kundër Korrupsionit duhet të njoftohet për vendimin e ndërmarrë për zbatimin e këtij Opinioni.

Agjencia kundër korrupsionit ju falënderon për bashkëpunimin.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
MINISTRIA E INDUSTRIE, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË  
MINISTARSTVO INDUSTRIJE, PREDUZETNIŠTVA I TRGOVINE  
MINISTRY OF INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP AND TRADE

Nr./Br./No. 9076-17 Nr./Br./No. pg. 12/1  
Data/Datum/Date 19.05.2022  
PRISHTINË

AGJENCIA  
PËR INVESTIME  
DHE PËRKRAHJEN  
E NDËRMARRJEVE  
NË KOSOVË

**KIESA**

## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,  
Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)

Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA)

PËR/ZA/TO:	Arbër Gegaj, Zv. Sekretarit të Përgjithshëm i MINT, Zef Deda, Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm i KIESA-s				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës				
NGA/OD/FROM:	Behar Tërdevci, Bsc. Hidroteknikë - Kryesues i komisionit Florina Hoxha, IDA - anëtare e komisionit, Shqipe Gashi, Msc. Elektro - anëtare e komisionit				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Procesverbali i komisionit për pranimit teknik të punëve për projektin "Ndërtimi i infrastrukturës në Parkun Industrial në Lumadh" sipas kontratës 2608 të datës 21.03.2019 me numër të prokurimit MTI204-18-8650-/042-5-1-1 dhe aneks kontratës me nr. 2374 me numër të prokurimit MTI204-18-8650-/042-5-1-1(204-19-7738-5-2-5 me date 12.11.2019				
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	3	Lokacioni: Kuceni: Extension:	36 598	Data: Datum: Date:	16.05.2022
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input checked="" type="checkbox"/>

I nderuar,

Në vazhdim keni të bashkangjitur Procesverbalin e komisionit për pranimit teknik të projektit kapital "Ndërtimi i infrastrukturës në Parkun Industrial në Lumadh" sipas kontratës 2608 të datës 21.03.2019 me numër të prokurimit MTI204-18-8650-/042-5-1-1 dhe aneks kontratës me nr. 2374 me numër të prokurimit MTI204-18-8650-/042-5-1-1(204-19-7738-5-2-5 me date 12.11.2019.

Me respekt,

## PROCESVERBAL

KOMISIONI PËR PRANIM TEKNIKË DHE LLOGARI PËRFUNDIMTARE TË PUNIMEVE TË KRYERA NË KONTRATËN: "NDERTIMI I INFRASTRUKTURËS NË PARKUN INDUSTRIAL NË LUMADH" - KONTRATA ME NR. I PROKURIMIT: MTI 204-18-8650/042-5-1-1 DHE ANEKS – KONTRATA ME NR. I-PROKURIMIT:-MTI 204-18-8650/042-5-1-1 (204-19-7738-5-2-5).

PRISHTINË, MAJ 2022

## PROCESVERBAL

IKOMISIONI PËR PRANIM TEKNIKË DHE LLOGARI PËRFUNDIMTARE TË PUNIMEVE TË KRYERA NË KONTRATËN: “NDERTIMI I INFRASTRUKTURËS NË PARKUN INDUSTRIAL NË LUMADH” - KONTRATA ME NR. I PROKURIMIT: MTI 204-18-8650/042-5-1-1 DHE ANEKS – KONTRATA ME NR. I-PROKURIMIT: MTI 204-18-8650/042-5-1-1 (204-19-7738-5-2-5).

Sekretari i pergjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka caktuar komisionin me vendim. Ref. 1387-02 të dates 10.03.2022, për pranim Teknik dhe llogari perfundimtare të puneve të kryera ne kontratën: “NDERTIMI I INFRASTRUKTURËS NË PARKUN INDUSTRIAL NË LUMADH ”

Në komision janë caktuar:

1. Behar Tërdevci, Bsc. Hidroteknikë - Kryesues i komisionit
2. Florina Hoxha, IDA - Anëtare e komisionit
3. Shqipe Gashi Msc. Elektro. – Anëtare e komisionit

### I. PRANIMI TEKNIK

Komisioni fillon me pranim Teknik më datë: 25.03.2022 behet gjendja e kontrollimit të punëve të kryera ne terren pastaj komisioni u pajtua që të caktohet një datë dhe të kontrolloj dokumentacionin tekniko-investues, kontraktues dhe dokumentacionet e udhëhequr gjat realizimit të kontratës.

Gjatë pranimit teknik kanë prezantuar në terren është prezantuar ecuria e punëve nga:

4. Mirvete Jaha – IDN Menaxhere e projektit
5. Nderim Bajraktari – IDN Udhëheqës i punishtes të kontraktuesit, “ERST BAU”-SHPK & ALBA KONSTRUKSION.
6. Nexhat Merovci – ing. Dipl. I nder. - Organmbikqyrës,

Pas kontrollimit të dokumentacionit kontraktues, dokumentacionit të udhëhequr gjatë punimeve dhe vizitës në teren, komisioni ka konstatuar:

1.1.Lënda e pranimit teknik dhe llogaris përfundimtare është: Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Lumadh - Vushtrri

1.2.Punëdhënës është: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

1.3.Kryesi i punimeve është: Kompania “ERST BAU”-SHPK & “ALBA KONSTRUKSION”SH.P.K.

1.4.Financimi i kontratës është kryer nga buxheti i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

1.5.Për “Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial në Lumadh” – Vushtrri, është lidhur kontrata me Nr. i prokurimit: MTI 204-18-8650/042-5-1-1 të datës 21.03.2019 dhe Aneks kontrata me Nr. i

prokurimit: MTI 204-18-8650/042-5-1-1 (204-19-7738-5-2-5), të datës 12.11.2019, në mes të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrjeve dhe Tregtisë dhe kompanisë “ERST BAU”-SHPK & “ALBA KONSTRUKSION”SH.P.K.” – Suharekë.

1.6. Vlera e kontratës: 1,286,691.35 €.

1.6.1. Vlera e Aneks kontratës: 128,223.52 €.

1.7. Afati për kryerjen e punimeve për kontrat Nr. i prokurimit: MTI 204-18-8650/042-5-1-1, sipas planit dinamik të ofruar nga kontraktuesi është: 200 ditë pune dhe afati për kryerjen e punimeve për Aneks kontrata Nr. i prokurimit: MTI 204-18-8650/042-5-1-1 (204-19-7738-5-2-5), është: 30 ditë pune.

1.8. Penaltite për moskryerjen e punimeve në afatin e kontraktuar është 2/1000 për çdo ditë vonës me maksimum 10 % të vlerës së kontratës.

1.9. Afati i garancionit të punimeve sipas kontratës është një vite nga data e përfundimit të pranimit teknik.

## 2. DOKUMENTACIONI TEKNIK – PROJEKTET

2.1. Punimet janë kontraktuar sipas projektit të hartuar nga kompania N.P.SH. “Arhiko ING”, 2018, Prishtinë

Të dhënat për rrugët sipas projektit:

- Gjerësia e Asfaltit,  $B=7.50 \text{ m}^1$ ,
- Gjerësia e trotuareve në të dy anët e rrugëve,  $B=1 \times 1.50 \text{ m}^1$ ,
- Shiriti Gjellbëruese  $2 \times 0.4 \text{ m}$
- Gjatësia e Rrugëve: Profili nr.1 st 0+000  
Profili nr.70 st 1+211.09 L=1,211.09 m<sup>1</sup>
- Vendosja e gjeotekstilit  $400 \text{ gr/m}^2$ .
- Shtresa e mbushjes ( $M_{sh} \geq 50 \text{ MN/m}^2$ ) me material guror 0-200 mm me trashësi sipas kuotës së projektit.
- Shtresa e parë e tamponit, ( $M_{sh} \geq 120 \text{ MN/m}^2$ ) me material guror 0-63 mm me trashësi  $t=30 \text{ cm}$ .
- Shtresa e dytë e tamponit, ( $M_{sh} \geq 120 \text{ MN/m}^2$ ) me material guror 0-31.50 mm me trashësi  $t=20 \text{ cm}$ .
- Shtresa e parë e bitozhavorit BZh 0-32 mm me trashësi  $t=12 \text{ cm}$
- Shtresa e dytë e bitozhavorit BZh 0-22 mm me trashësi  $t=6 \text{ cm}$
- Shtresa e dytë e asfaltbeton AB 0-16 mm me trashësi  $t=4 \text{ cm}$
- Montimi i skajoreve 18/24 cm M100.
- Montimi i skajoreve 10/20 cm M100.



- Montimi i kubzave nga betoni t=6.0 cm.

#### Punimi i kanalizimit Atmosferik dhe Fekal:

- Gypa të brinjëzuar PE SN8 -200 mm, PE SN4 -315 mm, PE SN4 -400 mm, PE SN4 -500 mm, PE SN4 -630 mm.
- Gypa të betonit me prerje konstante unazore  $\phi$  1000 mm.
- Gypa të betonit unazë në formë të konit  $\phi$  700 mm.
- Gypa të betonit me prerje konstante unazore  $\phi$  600 mm.
- Kapak nga Giza  $\phi$  700 mm.
- Ujëmbledhës Rrugor 40x40 cm.

#### Punimi i Ujësjiellit:

- Gypa HDPE - 125 mm, PN – 10.0 bar.
- Gypa HDPE - 75 mm, PN – 10.0 bar.
- Pjesët lidhëse fazonike
- Kapak metalik

#### Punimi i Ndrëqimit:

- Gypi i brinjëzuar PVC  $\phi$ 125 mm.
- Kabllo nga bakri Cu NYY/J4x16 mm<sup>2</sup>.
- Shtylla dy kriheshe .
- Ndrëqesit LED. 96 cope
- Gypa të betonit me prerje konstante unazore  $\phi$  600 mm.
- Shiriti i Zinkuar FeZn 25x4 mm.

Hapësirat gjelbëruese – janë punuar dhe hapësirat gjelbëruese sipas projektit, ku sipërfaqja e tyre është 22,635.0 m<sup>2</sup>

Sinjalizimi – është bërë sinjalizimi horizontal dhe vertikal i zonës.

Raporti i pare i testimit Nr.rap.04/EB/0419 është bërë me date prill 2019 ku nga rezultatet e ekzaminuara laboratorit konkludon se materiali i ekzaminuar është Pluhur Deltinor me përmbajtje organike. Është vërtetuar se materiali nuk mund të përdoret për mbushje.

Raporti i dytë i testimit Nr.rap.04/EB/0419 është bërë me date prill.2019 ku nga rezultatet e ekzaminuara laboratorit konkludon se materiali i ekzaminuar është marr nga huazishtja në bazë të kërkesave teknike ky material mund të përdoret si material mbushës për infrastrukturë rrugore.

Raporti ekzaminimi i fraksioneve të agregatit fr. 0/63 mm tampon. I.AB-104/19 date: 02.04.2019.

Raporti ekzaminimi i fraksioneve të agregatit fr. 0/30 mm tampon. date: maj 2019.

Receptura paraprake për prodhimin e betonit për klasën e betonit C-25/30, me date me anë të provës 28.03.2018.

Recete për asfalt AB16 dhe materiale Bituminoze me numër raporti: RA-002/20 nga "ACT-ing" Prishtine. Prodhuesi "KOSOVA ASFALT" SH.P.K Ferizaj, Fabrika ne Lipjan, me date:21.05.2020 .

Receptura paraprake e shtresës mbajtëse te Asfaltit BZH 22 dhe BZh 32 . Prodhuesi "KOSOVA ASFALT" SH.P.K Ferizaj, Fabrika ne Lipjan, me date: 05.05.2018.

### **3. MENAXHIMI, MBIKQYERJA DHE REALIZIMI I PUNIMEVE**

3.1.Menaxhimi dhe mbikëqyrja në realizimin e kontratës është bërë nga MINT.

- a) Mirvete Jaha – ing. i dipl. i nder. – Menaxhere e projektit
- b) Armend Aliu – ing. i dipl. i nder. – Organmbikqyrës,
- c) Nexhat Merovci – ing. Dipl. I nder. - Organmbikqyrës,

### **4. REALIZIMI I KONTRATËS**

Punimet janë realizuar sipas projektit dhe paramases së kontratës dhe punimeve shtesë të aprovuara në Aneks kontratë. Punimet në realizimin e kontratës kanë filluar sipas afatit të paraparë por ka pasur probleme me mungesë ne pozicione te ndryshme te cilat nuk ishin te parapara ne kontrate (psh. Gërmimi, Pozicioni i mbushjes, lëshesat pllakore, ngjeshja e nenbazës). Gjithashtu kemi pas pengesa ne realizimin e disa pozicioneve si psh. punimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik, ku se pari duhej te punohej mbushja e rrugës e pastaj te kryhet ky pozicion për shkak se kuotat e rrjetit te kanalizimit ishin mbi terrenin ekzistues, ndërsa vonesa tjetër është dhe pëlqimi nga KEDS për vendosjen e trafos, ku i njëjti nuk është kontabël me trafon e kontraktuar.

### **5. DOKUMENTACIONI I UDHËHEQUR GJAT KRYERJES SË PUNIMEVE**

5.1. Ditari i ndërtimit

Ditari i ndërtimit ka gjithsejtë 245 fletë me ditë pune. Data e fillimit të punimeve është 29.03.2019 kurse data e përfundimit të punimeve është 25.11.2021.

Punimet kane filluar me date 29.03.2019 dhe kanë vazhduar deri me date 03.04.2019 kur janë ndërpre punimet për shkak te rishqyrtimit te disa pozicioneve te projektit.

Punimet kane vazhduar me dt.24.06.2019 dhe kanë vazhduar deri me date 28.06.2019 ne pozicionet e gërmimit te gjere. Për shkak te pozicioneve te papapara (deri ne sqarimin e pozicioneve) punimet janë ndërpre me 28.06.2019 deri me 22.07.2019 .

Nga dt.22.07.2019 punimet kanë vazhduar 25.07.2019. Pasi qe nuk na është ofruar zgjidhja e pozicioneve te papapara ne kontrate punimet janë ndërpre me 25.07.2019 deri me 13.11.2019.

Pas nënshkrimit te aneks kontratës me pozicionet e papapara ne kontratën baze, ka filluar vazhdimi i punimeve me dt.13.11.2019 deri 30.11.2019 ku për shkak te kushteve atmosferike dhe sezonit dimëror

punimet janë pezulluar. Pas përmirësimit të kushteve atmosferike kemi rifilluar punimet me dt.24.02.2020 deri me dt.19.06.2020 . Punimet janë ndërpre për shkak të mungesës së buxhetit për këtë projekt. Punimet kanë rifilluar me dt. 18.09.2020 deri me dt 07.12.2020.

Pas pauzimit të punimeve për shkak të sezonit dimëror (kushteve jo të mira atmosferike), punimet kanë rifilluar me dt.26.04.2021 deri me 03.05.2021. Janë ndërpre për arsye të sqarimit të pozicionit lysterja e shtresës me emulsion.

Punimet kanë rifilluar me dt.14.06.2021 dhe kanë përfunduar me 25.11.2021.

Për shkak ditëve me shi nuk është punuar në këto ditë (data): 27.02.2020, 28.02.2020, 05.03.2020, 25.03.2020, 01.04.2020, 02.04.2020, 21.04.2020, 02.05.2020, 21.05.2020, 26.05.2020,08.06.2020,12.06.2020,24.09.2020,25.09.2020, 28.09.2020,29.09.2020,30.09.2020, 09.10.2020, 14.11.2020-03.12.2020, 23.05.2021.

Nuk është punuar për shkak të pandemisë së korona virusit dt.16.03.2020, 17.03.2020, 15.04.2020, 16.04.2020, Festa 28.11.2019, 09.04.2020, 13.04.2020, 20.04.2020, 01.05.2020, 31.07.2020 28.11.2020.

Për shkak ditëve të festave nuk është punuar në këto ditë (data):

22.04.2019,29.04.2019,01.05.2019,04.06.2019,05.06.2019,13.06.2019,12.08.2019, 28.11.2019,31.07.2020,09.04.2021.

Bazuar në afatin e punimeve, sipas planit dinamikë që është 230 ditë pune, ndërsa punimet kanë përfunduar në 244 ditë pune e që për ditë të tejkaluara do të merren masa sipas kontratës me penallti për 14 ditë pune në pozicionet e pa përfunduar ( Rrethoja 9632.20 euro, Elektro 7581.3euro, Kanalizimi 2697.5euro Ujësjellësi 1330 euro, Sinjalistika 701.30 euro) Totali 21942.8 euro x 0.0025=54.85 euro/dite x 14 ditë = Totali Ndalesë 767.9 euro . Po ashtu pengës tjerë është situata me COVID-19, dhe vonesa në lidhje me përdorimin e materialeve për ndërtim sipas rezultateve nga ekzaminimet nga Laboratori.

## 6. EKZAMINIMET

Gjatë ekzekutimit të punimeve janë bërë ekzaminimet e nevojshme si në vijim:

Raportet e testimit me pllakë rrethore  $\phi$  30 cm për përcaktimin e modulit të ngjeshmërisë së nën bazës rruga:

Numri i raportit testues	Data e raportit të ekzaminimit	Stacionazha (Profilet Terthore)	Pozicioni i ekzaminimit	Numri i ekzaminimeve	E plotësojn kriterin e kerkuar	
					Po	Jo
T&I 13/Eb/1119	13.11.2019	0+000-1+120	Nënbaza	12	12	

Raportet e testimit me pllakë rrethore  $\phi$  30 cm për përcaktimin e modulit të ngjeshmërisë së Mbushjes fr. (0-125) mm :

Numri i raportit testues	Data e raportit të ekzaminimit	Stacionazha (Profilet Terthore)	Pozicioni i ekzaminimit	Numri i ekzaminimeve	E plotësojn kriterin e kerkuar	
					Po	Jo
T&I 12/Eb/1119	26.11.2019	0+000-1+110	Mbushje	12	12	

Raportet e testimit me pllakë rrethore  $\phi$  30 cm për përcaktimin e modulit të ngjeshmërisë së tamponit fr. (0-63) mm:

Numri i raportit testues	Data e raportit të ekzaminimit	Stacionazha (Profilet Terthore)	Pozicioni i ekzaminimit	Numri i ekzaminimeve	E plotësojn kriterin e kerkuar	
					Po	Jo
G & B Tamponi	11.05.2020	0+020-1+210	Tampon fr.0-63 mm	13	13	

Raportet e testimit me pllakë rrethore  $\phi$  30 cm për përcaktimin e modulit të ngjeshmërisë së tamponit fr. (0-31.50) mm:

Numri i raportit testues	Data e raportit të ekzaminimit	Stacionazha (Profilet Terthore)	Pozicioni i ekzaminimit	Numri i ekzaminimeve	E plotësojn kriterin e kerkuar	
					Po	Jo
G & B Tamponi	26.04.2021	0+050-1+200	Tampon fr.0-31.50 mm	13	13	

- Janë punuar matjet për raport nga kompania "Geo Global" SH.P.K te sasive te punuara ne ndërtimin e zonës industriale ne Lumadh-Vushtrri. Ne raport përfshihet edhe gërmimi i trupit te rrugës, hapësirat gjelbëruese, gjatësia e skajoreve 18/24 cm dhe 10/20cm, gjatësia e murit rrethues, sipërfaqet me kubeza, sipërfaqet e asfaltit, shtyllat ndriçuese dhe pusetat elektrike, gypi i ujës-jellësit, sasitë e gërmimit për hapjen e kanalit, pusetat e kanalizimit fekal dhe atmosferik. Raport i punuar nga gjeodeti i licencuar Hekuran Demiri me raport nr: 01/20.
- Janë punuar dhe ekzaminimet e mostrave të ngurta për Bitozhavor BZh32 mm, BZh22 dhe AB16 , jan marre gjithsejtë 15 mostra me numër të raportit te ekzaminimit 29/Fc/0421 i datës 05.07.2021 ku janë ekzaminuar 15 mostra qe i plotësojnë kriteret. Ekzaminimet janë bere nga laborator i "G&B Tampon"
- Raporti i testimit: Rep.num.22/K/1218, për testimin e gypave nga betoni me profil constant nga prodhuesi NTP " Kulla " – Korish Prizren. I plotësojnë kriteret.
- Raporti i testimit nr.rap. 22/Vm/0420b nga N.Sh."Test & Ing"-Suharekë me datë 22.04.2020 për testimin e anësoreve nga betoni me dimensione 180x240x1000 mm i prodhuar nga "Vëllezërit Morina" sh.p.k. – Suharekë. Janë testuar thithshmëria e ujit dhe soliditeti në përkulje. Janë ekzaminuar 6 elemente. I plotësojnë kriteret.
- Raporti i testimit nr.rap.22/Vm/0420b nga N.Sh."Test & Ing"-Suharekë me datë 22.04.2020 për testimin e anësoreve nga betoni me dimensione 100x200x1000 mm i prodhuar nga "Vëllezërit Morina" sh.p.k. – Suharekë. Janë testuar thithshmëria e ujit dhe soliditeti në përkulje. Janë ekzaminuar 6 elemente. I plotësojnë kriteret.

- Raporti i testimit nr.rap. 22/Vm/0420b nga N.Sh.“Test & Ing”-Suharekë me datë 22.04.2020 për testimin e kubëzave “profili tullë” nga betoni me dimensione 60x160x240 mm i prodhuar nga “Vëllezërit Morina” sh.p.k. – Suharekë. Janë testuar thithshmëria e ujit dhe soliditeti në thyerje-çarje. Janë ekzaminuar 8 elemente. I plotësojnë kriteret.
- Raporti i testimit nr.208 me datë 15.10.2019 për testimin e pusetes se gizës me dimensione  $\phi 700$  mm i prodhuar nga “LARASHI-2005” sh.p.k. I plotësojnë kriteret.
- Atestet nr.F 8.5.08 për Tub i Brinjëzuar HDPE  $\phi 200/SN4$  , nga prodhuesi “Konti Hidroplast” Maqedoni e Veriut me date:24.04.2020.
- Atestet nr.F 8.5.08 për Tub i Brinjëzuar HDPE  $\phi 315/SN4$  , nga prodhuesi “Konti Hidroplast” Maqedoni e Veriut me date:24.04.2020.
- Atestet nr.F 8.5.08 për Tub i Brinjëzuar HDPE  $\phi 400/SN4$  , nga prodhuesi “Konti Hidroplast” Maqedoni e Veriut me date:24.04.2020.
- Atestet nr.F 8.5.08 për Tub i Brinjëzuar HDPE  $\phi 500/SN4$  , nga prodhuesi “Konti Hidroplast” Maqedoni e Veriut me date:24.04.2020.
- Atestet nr.F 8.5.08 për Tub i Brinjëzuar HDPE  $\phi 630/SN8$  , nga prodhuesi “Konti Hidroplast” Maqedoni e Veriut me date:24.04.2020.
- Atestet nr.394/2018 për Tub Ujësjiellësi HDPE 100,  $\phi 75/PN10$  , nga prodhuesi “Ferplast”-Ferizaj, nr. Certifikatës: 03-303-1-1
- Atestet nr.41/2020 për Tub Ujësjiellësi HDPE 100,  $\phi 125/PN10$  , nga prodhuesi “Ferplast”-Ferizaj, nr. Certifikatës: 03-303-1-1.
- Raport testimi dt.22.04.2018 për kapak te pusetave dhe Ujëmbledhës , NPT “Metal Holding” Lipjan nga N.SH. “IBMS”.
- Certifikata e kabllor së ndriçimit nga Kompania ATTHABASCA INVESTMENT d.o.o. Bosnjë dhe Hercegovinë.

#### Ekzaminimet e Armaturës

Ekzaminimet e armaturës  $\phi 10$ mm,  $\phi 12$ mm,  $\phi 14$ mm, (rezistenca në tërheqje e armaturës sipas standardit EN: 10002-1) ku të gjitha shufrat i plotësojnë kriteret. Ekzaminimet janë prezantuar sipas raportit nr.rap.9684, 9683, 9696, të datës 04.12.2020.

## TË DHËNAT PËR KONTRATËN

- 1.1 Lënda e pranimit teknik dhe llogarisë përfundimtare është: “Ndërtimi i infrastrukturës në Parkun Industrial në Lumadh”- Vushtrri.
- 1.2 Punëdhënës është: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- 1.3 Kryesi i punimeve është: Kompania “ERST BAU” SH.P.K. & ALBA KONSTRUKSION” .
- 1.4 Financimi i kontratës është kryer nga buxheti i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- 1.5 Për “Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial në Lumadh” – Vushtrri, është lidhur kontrata me Nr. i prokurimit: MTI 204-18-8650/042-5-1-1 të datës 25.03.2019 dhe Aneks kontrata me Nr. i prokurimit: MTI 204-18-8650/042-5-1-1 (204-19-7738-5-2-5) të datës 12.11.2019, në mes të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe kompanisë “ERST BAU” SH.P.K. & ALBA KONSTRUKSION”.
- 1.6 Vlera e kontratës: 1,286,691.35 €
- 1.7 Vlera e Aneks kontratës: 128,223.52 €
- 1.8 Afati për kryerjen e punimeve për kontratën me Nr. i prokurimit: MTI 204-18-8650/042-5-1-1, sipas planit dinamik të ofruar nga kontraktuesi është: 200 ditë pune dhe afati për kryerjen e punimeve për Aneks kontratë Nr. i prokurimit: MTI 204-18-8650/042-5-1-1, është: 30 ditë pune
- 1.9 Afati i garancionit të punimeve sipas kontratës është një vit.

## **REKOMANDIMI I KOMISIONIT**

- 1.10 Projekti “NDËRTIMI I INFRASTRUKTURES NË PARKUN INDUSTRIAL NË LUMADH”- Vushtrri. I plotëson kriteret teknike të cilësisë, stabilitetit dhe sigurisë dhe mund të lëshohet për përdorim. Prani dorëzimi dhe llogaria përfundimtare mund të filloj menjëherë.
- 1.11 Autoriteti kompetent mund të jap lejen e përdorimit për projektin:  
NDËRTIMI I INFRASTRUKTURES NË PARKUN INDUSTRIAL NË LUMADH

REKAPITULIMI I LLOGARISË PËRFUNDIMTARE TË PUNËVE TË KRYERA NË KONTRATËN "NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS NË PARKUN INDUSTRIAL NË LUMADH - VUSHTRRI		
1	Vlera e kontratës	1,286,691.35 €
2	Mbetja	30.90 €
3	Pagesa e Avansit 26.03.2019	193,003.70 €
4	Gjendja e Punimeve te realizuara sipas situacionev 1-10	1,135,308.94 €
Numri i situacioneve:		Vlera e pagesës:
	Situacioni Nr. 1	243,510.70 €
	Situacioni Nr. 2	146,748.34 €
	Situacioni Nr. 3	81,986.40 €
	Situacioni Nr. 4	77,487.25 €
	Situacioni Nr. 5	131,413.36 €
	Situacioni Nr. 6	152,874.90 €
	Situacioni Nr. 7	62,438.52 €
	Situacioni Nr. 8	58,778.94 €
	Situacioni Nr. 9	137,386.98 €
	Situacioni Nr. 10	42,683.55 €
	<b>Situacioni nr.11 Përfundimtar</b>	<b>151,351.51 €</b>
	<b>Totali sipas situacionev 1-11</b>	<b>1,286,660.45 €</b>

1	Vlera e kontratës	1,286,691.35 €
2	Vlera e aneks kontratës	128,223.52 €
3	Vlera e kontratës dhe aneks kontratës	1,414,914.87 €
4	Realizimi i kontratës dhe aneks kontratës	1,414,883.97 €
5	Pagesat e kryera sipas situacioneve të përkohëshme 1-10	1,135,308.94 €
6	<b>Sit 11 Përfundimtar</b>	<b>151,351.51 €</b>
7	Zbritja perfundimtare e avansit 15%	22,707.36 €
8	<b>Sit 11 Përfundimtar për Pages</b>	<b>128,644.15 €</b>

REKAPITULIMI I LLOGARISË PËRFUNDIMTARE TË PUNËVE TË KRYERA ANEKS KONTRATA		
1	VLERA E ANEKS KONTRATËS	128,223.52 €
2	SITUACIONI 1 - ANEKSIT	128,223.52 €
3	Fatura nr (prot 9681)	115,401.17 €
4	Punimet e realizuara	128,223.52 €
5	Shuma e ruajtjes prej 10%	12,822.35 €
6	<b>Për pages mbas pranimit teknik</b>	<b>12,822.35 €</b>

Penalltit 21942.8 x 0.0025 = 54.85 euro/dite x14 dite	767.90 €
---	----------

Pagesa e mbetur në vlerë 140,698.60 € do ti bëhet kontraktusit, komfor kushteve të kontratës .

Procesverbali i Pranimit teknik dhe llogaria përfundimtare i është prezantuar të pranishmëve dhe të njëjtit e pranojmë Procesverbalin pa vërejtje.


Rekomandohet që komuna e Vushtrrisë të bëjë zgjidhjen rreth furnizimit dhe montimit të nënstacionit për furnizim me energji elektrike për Parkun Industrial në Lumadh, sepse sipas Pëlqimit të KEDS, trafo e blinduar TSB të tipit 10(20)/0.4 kv me 2+1 kthine, fuqie 1000 kVA, me transformatorë të thatë me nga 10 dalje 0.4 kv dhe kthinë për ndriçim të jashtëm e vendosur nga OE nuk i plotëson kushtet sipas pëlqimit nga KEDS. Ndërsa OE e ka vendosur trafon sipas paramases së kontraktuar.

Një kopje e dokumentacionit teknik dhe dokumentacionit zbatues me procesverbalin për pranim teknik dhe llogari përfundimtare të punëve të kryera në: "Ndërtimin e infrastrukturës në parkun industrial në Lumadh", kontrata: me Nr.MTI204-18-8650/042-5-1-1 dhe Aneks Kontratës nr.MTI204-18-8650/042-5-1-1 duhet te ruhet nga menaxheri i Projektit në Arkivin e MTI - së.

Komisioni ka përfunduar me pranim teknik dhe llogari përfundimtare më: 16.05.2022

Komisioni :

1. Behar Tërdevci, Bsc. Hidroteknikë - Kryesues i komisionit
2. Florina Hoxha, IDA - Anëtare e komisionit
3. Shqipe Gashi Msc. Elektro. - Anëtare e komisionit



Prezent :

- 1). Mirvete JAHA IDN - Menaxhere e Projektit

M. Jaha





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë*  
*Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine*  
*Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade*

**Komuna e Vushtrisë**  
**Municipality of Vuçitër**  
**Opština Vuçitër**

Prishtinë, \_\_\_/\_\_\_/2022

Duke u bazuar në nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr.7/ 01 Mars 2019), dhe neni 8, nënparagrafi 1.4 i Rregullores (QRK) Nr. 02/2022 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, lidhet kjo:

### **ANEKS MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR PROJEKTIN “PARKU INDUSTRIAL NË LUMADH”**

#### **Palët nënshkruese**

1. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e përfaqësuar nga Ministrija (në tekstin e mëtejme MINT) dhe
2. Komuna e Vushtrisë e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna).

#### **Neni 1** **Qëllimi**

1. Me këtë Aneks Marrëveshje ndryshohet dhe plotësohet Marrëveshja e Bashkëpunimit për Projektin “Parku Industrial në Lumadh” me numër protokollit 5041 të datës 16.07.2018 dhe aneks marrëveshjes me numër protokollit 9583 të datës 24.12.2020.
2. Qëllimi i ndryshimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me numër protokollit 5041 të datës 16.07.2018, si dhe aneks marrëveshjes me numër protokollit 9583 të datës 24.12.2020, është për shkak të mos përfundimit të projektit brenda afatit të paraparë në nenin 2 të marrëveshjes bazë dhe aneks marrëveshjes.

3. Nga momenti i pranimit teknik të projektit, Parku Industrial në Lumadh do të menaxhohet nga Komuna e Vushtrrisë, si në aspektin e mirëmbajtjes, ruajtjes së investimeve dhe sigurimin e hapësirave.

**Neni 2**  
**Financimi i projektit**

1. Vlera e parashikuar e investimit për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 do të vazhdoj edhe në vitin 2022, si dhe palët pajtohen se obligimet e tyre të marrëveshjes bazë dhe aneks marrëveshjes t'i përmbushin gjatë vitit 2022.

**Neni 3**  
**Amendamentet**

1. Aneks marrëveshja është pjese përbërëse e marrëveshjes bazë me numër protokollit 5041 të datës 16.07.2018 dhe aneks marrëveshjes me numër protokollit 9583 të datës 24.12.2020.
2. Kjo aneks marrëveshje mund të ndryshohet me shkrim me pëlqimin e të dy palëve nënshkruese të aneks marrëveshjes.

**Neni 4**  
**Kopjet e aneks Marrëveshjes**

1. Kjo aneks marrëveshje është hartuar në katër (4) kopje origjinale, ku secila palë nënshkruese merr nga dy (2) kopje.

**Neni 5**  
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo aneks marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.



Rozeta Hajdari

*Rozeta Hajdari*  
Ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë



Ferit Idrizi


*Ferit Idrizi*  
Kryetar i Komunës së Vushtrrisë



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUÇITRN

<b>DATE:</b>	12.07.2022
<b>PËR:</b>	Për Kryesuesen e Kuvendit të Komunës Znj. Melihate Basholli-Latifi
<b>HARTUES:</b>	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim Drejtori i Drejtorisë: Maliq Ferizi 
<b>TEMA:</b>	Kërkesë për Procedim të Dokumentit për Miratim

I nderuar,

Kërkojmë nga ana Juaj që në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal e cila mbahet më 28.07.2022, në rendit të ditës ta vendosni dokumentin e hartuar nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim;  
” Vlerësimi i rrezikut për territorin e Komunës së Vushtrrisë”.

Ky dokument shërben si udhëzues për identifikimin e shkallës së rrezikshmërisë nga faktorët potencial, planifikimin e masave parandaluese për pengimin dhe zvogëlimin e dëmeve në raste të fatkeqësive eventuale, përfshirja dhe trajnimi i të gjitha strukturave dhe shërbimeve gjegjëse komunale me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në raste të fatkeqësive – katastrofave si dhe angazhimin e forcave për mbrojtje dhe shpëtim me qëllim të ndihmës, vet ndihmës, shpëtimit, evakuimit dhe strehimit të rrezikuarve dhe zvogëlimin e dëmeve materiale-teknike, sigurimin e kushteve për institucionet Komunale dhe atyre të cilat veprojnë në territorin e Komunës për veprimtari ekonomike, për kalimin nga gjendja normale e jetës dhe punës në një situatë emergjente.

Ky dokument duhet të aprovohet në Kuvendin Komunal dhe është edhe rekomandim i Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN

<b>DATE:</b>	12.07.2022
<b>PËR:</b>	Kuvendin e Komunës Vushtrri
<b>PROPOZUES:</b>	Ferit Idrizi Kryetar i Komunës së Vushtrrisë <i>Ferit Idrizi</i>
<b>HARTUES:</b>	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim Drejtori i Drejtorisë: Maliq Ferizi <i>Maliq Ferizi</i>
<b>TEMA:</b>	Akt – përcjellës

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur Vlerësimin e Rrezikut për territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Me respekt!



Republika e Kosovës

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim



Komuna e Vushtrrisë

**VLERËSIMI I RREZIKUT  
PËR TERRITORIN E KOMUNËS SË  
VUSHTRRIË**

Korrik 2022

# PËRMBAJTJA:

## Mbështetja Ligjore

- 1. Hyrja**
- 1.1. Fusha e përgjegjësisë së bartësit të Planifikimit
- 1.2. Pozita dhe Karakteristikat e terrenit të Komunës së Vushtrisë
- 1.2.1. Komuna e Vushtrisë në rajon
- 1.3. Gjendja e resurseve ujore-lumore
- 1.4. Malet dhe bjeshkët në Komunën e Vushtrisë
- 1.5. Karakteristikat Gjeografike-klimatike të Komunës së Vushtrisë
- 2. Struktura demografike e Komunës së Vushtrisë**
- 2.1. Numri i Popullsisë,
- 2.2. Grup Moshë e Popullatës,
- 2.3. Vendbanimet e Komunës së Vushtrisë,
- 2.4. Numri i të punësuarve, paunësuarve dhe pensionistëve,
- 3. Të mirat materiale, Kulture dhe të ambientit**
- 3.1. Vlerat e Trashëgimisë Kulture,
- 3.2. Trashëgimia Natyrore,
- 3.3. Parqet nacionale, natyrore, rezervatet dhe sipërfaqet pyjore,
- 3.4. Objektet për furnizim me ujë,
- 3.5. Zonat për prodhim Bujqësor,
- 4. Numri i zonave dhe objekteve industriale,**
- 4.1. Lokacioni i zonave ,dhe objekteve industrilae në raport me vendbanime,
- 4.2. Strehimoret për sterhim të përkohëshëm në raste emergjente
- 5. Kapacitet mjeksore Publike dhe private,**
- 6. Infrastruktura Shkollore,**
- 7. Infrastruktura teknologjike dhe e komonikacionit,**
- 7.1. Infrastruktura rrugore në Komunën e Vushtrisë,
- 7.2. Rrejtja e rrugëve,
- 7.3. Transporti hekurudhor,
- 7.4. Transpori ajror,
- 8. Sistemi Elektroenergjetik,**
- 8.1. Lartëpërquesit dhe Trafostacionet,
- 8.2. Gas sjellësi dhe Naftësjellësi,
- 8.3. Telekomunikimi,
- 8.4. Pompat e derivateve të naftës dhe deponitë e karburanteve ,
- 8.5. Gjendja e mjedisit
- 9. Vlerësimi i Rrezikshmërisë nga Fatkeqësit natyrore dhe fatkësive tjera,**
- a) Metodologjia e Vlerësimit të rrezikut
- b) Procedura e vlerësimit të rrezikut,
- 9.1. Vlerësimi i rrezikshmëris nga Vërshimet,
- 9.2. Vlerësimi i rrezikshmëris nga Thatësit,
10. Vlerësimi i rrezikshmëris nga Fatëkeqësitë Tekniko-teknologjike,
- 10.1 Vlerësimi i rrezikshmëris nga zjarret në objekte banimi dhe zjarre fushore,
11. Masat preventive nga Vërshimet,
- 11.1 Masat preventive nga Thatësit,
- 11.2 Masat preventive nga zjarret nëpër deponit e lëndëve lehtëndeze dhe objekteve të rendësis së veçant dhe zjarreve fushore
- 12. Mbështetja financiare në raste emergjente**

# Mbështetja Ligjore

Plani për Vlerësimin e rrezikut në territorin e Komunës së Vushtrrisë mbështetet në nenin 62.8 në Statutin e Komunës ,nenin 5 pika 5.2 të “Ligjit për Mbrojtje kundër Zjarrit nr,02/L-41”, nenit 31,pikat, 5,9 , nenit 38 pika 38.3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësit Natyrore dhe Fatkeqësit Tjera dhe Udhëzimit Administrativ nr 19/2008,neneve 3,4,dhe 5.

## Hyrje

Hartimi i vlerësimit të rrezikut për territorin e Komunës së Vushtrrisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera shërben si udhëzues për identifikimin e shkallës së rrezikshmërisë nga faktorët potencial, planifikimin e masave parandaluese për pengimin dhe zvogëlimin e dëmeve në raste të fatkeqësive eventuale, përfshirja dhe trajnimi i të gjitha strukturave dhe shërbimeve gjegjëse komunale me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në raste të fatkeqësive – katastrofave si dhe angazhimin e forcave për mbrojtje dhe shpëtim me qëllim të ndihmës, vet ndihmës, shpëtimit, evakuimit dhe strehimit të rrezikuarve dhe zvogëlimin e dëmeve materialo-teknike, sigurimin e kushteve për institucionet Komunale dhe atyre të cilat veprojnë në territorin e Komunës për veprimtari ekonomike, për kalimin nga gjendja normale e jetës dhe punës në një situatë emergjente.

### 1.1 Fusha e përgjegjesisë së bartësit të Planifikimit

Bartës i përgjegjësive për hartimin e Planit për Vlerësimin e Rrezikut në Vushtrri është Drejtoria për Mbrojtje dh Shpëtim e cila është përgjegjëse për menaxhimin e emergjencave të nivelit Komunal, vënien e standardeve të kryerjes së punëve lidhur me Gatishmërinë Civile dhe Reagimit Emergjent në territorin e vet dhe koordinimin e të gjitha subjekteve relevante për reagim në Situata Emergjente, varësisht nga karakteri dhe përmasat e fatkeqësisë .

Kjo Drejtori planifikon që të merr masa të nevojshme për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera si dhe përcjell aktivitetet e subjekteve relevante dhe involvuese në rastë të fatëkeqësive dhe të cilët do të mbështesin **shërbimet emergjente** në rast fatkeqësive.

## 1.2 Pozita dhe karakteristikat e territorit të Komunës së Vushtrrisë


### Pozita dhe Sipërfaqja totale e Komunës së Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë, ka një sipërfaqe prej 344 km<sup>2</sup> ose 34.440 , ha, me një lartësi mbidetare prej 508 m pika më e ulët dhe 1.283 Vesekovc pika më e lartë. Vushtrria shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore, dhe bënë pjesë në grupin e komunave të mesme të vendit.

Komuna e Vushtrrisë shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës , në luginën e Sitnicës, 30 km nga Prishtina. Territori i saj , shtrihet në veri të Rrafshit të Kosovës , që lidhë pjesën qendrore dhe jugore të kosovës me pjesën veriore.

Territori i Komunës së Vushtrrisë rrethohet, në veri me komunën e Mitrovicës dhe verilindje me vargëmalet e Kopaonikut deri në malet e Gërdeq ndërsa në jug me rrafshin e Kosovës, Komunën e Kastriotit në perendim me malin e Qyqavicës, Komunën e Drenasit dhe Komunën e Skenderajit

### Pozita e Vushtrrisë në Kosovë



Harta nr.1. Pozita e Vushtrrisë në Kosovë



### 1.3 Gjendja e resurseve ujore-lumore

Për gjatë territorit të Komunës së Vushtrrisë kalon lumi Silnica si dhe lumi LLab të cilët bashkohen në fshatin Lumadh dhe shtrihet në vijat: Prilluzhë, Lumëmadh, Mihaliq, Dërvar, Stanovc i poshtëm , Pestovë, Nedakofc ,Vushtrri, Dobërllukë, Smrekovnicë , në gjatësi prej 25 km .


Degët e lumit të Silnicës janë ; lumi Tërstena, lumi i Studimesë, lumi i Nevolanit, lumi i Dumnicës, lumi i Sllakovcit, Podranqa dhe disa prrocka më të vogla .

Theksojmë se lumi Tërstena ka sasi më të madhe të ujit sidomos në stinën e vjeshtës dhe të pranverës dhe kalon në mesë të qytetit, mirpo më 2009 është ndërtuar shtrati i këtij lumi dhe tani rreziku paraqitet më i vogël për vërshime. Problem dhe rrezik i v[rsimit të këtij lumi paraqet ekskluzivisht pjesa e pa përfunduar e argjinaturës nga fshati Pestovë deri në fshati Nadakovc, si dhe intervenimet ilegale dhe eksploatimi i pa kontrolluar i dheut nga eksploatues ilagal.

Në vitin 2020 ka filluar edhe një fazë e pastrimit dhe rikoperimit të argjinaturave në sfërsi të urës kryesore të lumit Silnica.

Por në periudhat e nxehta të verës disa degë të lumit shterren, ndërsa sasia e ujit në lumin Llab dhe Silnicë zvoglohet, por megjithate sasia e ujit në lumenj mvaret nga të rreshunat atmosferike.


#### Rrjeti Hidrografik i Komunës së Vushtrrisë



Harta nr.2 Lumenjet në Vushtrri

## 1.4 Malet dhe bjeshkët në Komunën e Vushtrrisë

Territori i Komunës së Vushtrrisë është i pasur me male dhe fusha, rrethohet në veri me vargmalet e Kopaonikut në lindje me pjesën jugore të vargmeleve të Kopaonikut me malin e Gërdeqit, në jug me rrafshin e Kosovës dhe në perëndim me malin e Qyqavicës. Sipërfaqja totale e pyjeve është: rrethë 110 km<sup>2</sup>



Harta nr.3 Shtirja e Maleve në komunën e Vushtrrisë

## 1.5 Karakteristikat Gjeografike-klimatike të komunës së Vushtrrisë

Në Komunën e Vushtrrisë dominojnë terrenet kodrinore malore si dhe pjesët e rrafshita të tokës pjellore në të dy anët e lumit Silnica. Gjeografikisht përfshinë pjesën qendrore të Kosovës (Luginën e Silnicës) dhe kufizohet me vargmalet e Kopaonikut, Gërdeqit, Rrafshin e Kosovës si dhe malin e Qyqavicës.

Klima është e mesme kontinentale dhe mesatarja e temperaturave vjetore sillet rreth 10,5 gradë C.

Muaji me i nxehte është Korriku me temperaturën prej 23-24 gradë C, ndërsa muaji me ftohte muaji Janar prej -8 grad deri në - 14 gradë C

Gjerësia gjeografike 42 (shkallë) 23''

Gjatësia gjeografike 21 (shkallë) 50''

Lartësia Mbidetare 508 - 1280 m.

Pjerrtësia e terrenit 12 - 33 %

Erërat dominante: Në territorin e Vushtrrisë fryn era nga veriu, ndërsa si erë dominante është era verilindore si dhe era e jugut,

Forca e erërave: 2.8 gjegjësisht 3.0 Bofor.

Shpejtësia e erërave: prej 3.0 deri në 8.0 m/sek.

Dominimi i lartë i veprimit të këtyre erërave në qytetin e Vushtrrisë, vërehet në periudhën dhjetor-maj.

Lagështija relative e ajrit gjatë vitit sillet nga 58.5% deri në 83,4%.

Shtypja atmosferike Brenda vitit sillet nga 947-949 mb

Të reshurat atmosferike brenda vitit

sillen nga 617-650 ml/m<sup>2</sup> ( sipas të dhënave IHMK)

#### **Erozionet natyrore**

Janë prezente në terrenet malore te malet e Çiçavicës, Kopaonikut -erozioni vertikal.

#### **Erozionet Artificiale**

Në mihjet sipërfaqësore në fsh. Bivolak, Strofc, Gllavotin ku bëhet nxerja e thëngjillit nga ana e qytetrve.

#### **Termetet**


Territori i komunës është në zonën sizmike prej 7 shkallëve të MCS deri në 8 shkallë të MCS.

Për zonat mikro- sizmike nuk ka të dhëna. Zona sizmike kryesisht është ajo verilindore.

Vushtrrija nuk ka të dhëna se ndonjëherë është goditë ngandonjë tërmet me përmasa shkatruese por tërmete të intensitetit më të vogël.

Kjo dukuri ka qenë më e theksuar veqanërisht gjat vitit 2012,2013 dhe fillimi i vitit 2014 ku ka pasë disa tërmete të intensitetit deri në 4.8 shkallë të Rihterit. Epiqendra ka qenë veqanërisht në veri lindje të Vushtrrisë në fsh. Vesekovc dhe në fshatrat për rreth e që përveq dameve të vogla materiale nuk është shënuar të ketë dëme në njerëz.

**Harta. 4: Harta e zonave maksimalisht të rrezikuara nga tërmetet në Kosovë dhe gjatësia dhe gjerësia gjeografike Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës**



## 2. Struktura demografike e Komunës së Vushtrisë

### 2.1 . Numri i Popullësis

Në Komunën e Vushtrisë numri i tërësishëm i banorve është rrethë **70.000**, ndërsa dendësia për 203.49 banorë për Km<sup>2</sup> është 203.49 banore, ose 2.04 banore për Ha. Prandaj shtimi natyrorë vjetorë është më i madh se ai i Kosovës, ku këtë e vërteton edhe vlerësimi i punuar nga KK. Vushtrri, që po e paraqesim në tab.

Tab. 4: Vlerësimi i numrit të banorëve sipas viteve

Viti	Numri i Banorëve	Shkalla vjetore e shtimit natyrorë
1981	65671	2.3%
1982	67181	2.3%
1983	68726	2.3%
1984	70307	2.3%
1985	71924	2.3%
1986	73578	2.3%
1987	75270	2.3%
1988	76641	2.3%
1989	78404	2.3%
1990	80207	2.3%
1991	82052	2.3%
1992	83939	2.3%
1993	85860	2.3%
1994	87835	2.3%
1995	89855	2.3%
1996	91922	2.3%
1997	93936	2.3%
1998	96077	2.3%
1999	98287	2.3%
2000	100548	2.3%
2001	102861	2.3%
2002	105227	2.3%
2003		
2004		
2005		
2006		
2007		
2008	<b>105000</b>	
2009		
2010		
2011	<b>70000</b>	2,3%

Si bazë e llogaritjeve të mëtutjeshme është marrë vlera prej 70000 banorë me shkallën vjetore të rritjes natyrore prej Sn=2.3%

Vlerësohet se në vetë qytetin e Vushtrrisë jetojnë mbi 30.000 banorë. Pra, në komunë jashtë qytetit jetojnë rreth 40.000 banorë.

Vështruar nga përbërja gjinore, popullatën e Vushtrrisë e përbëjnë: **49,0%** meshkuj dhe **51.0%** femra. Komuna është e banuar me shumicë nga shqiptarët ka edhe nacionalitete tjera si Sërbë, Rom, ashkali, Turqë.

## 2.2 Grup moshat e Popullsisë

Komuna e Vushtrrisë ka një popullatë kryesisht të re, ku në përqindje sipas moshave janë:

- Struktura e popullsisë sipas moshës:
- **-(0-15) (35.3 %),**
- **-(16-65) (59.9 %) dhe**
- **-mbi 66 vjet (4.8 %).**




Fig. 5: Zhvillimi i grup moshave

Burimi: Statistikat Vitale të Kosovës 2002 - 2003 (ESK 2004), kalkulimet IWU për barazim të balancës së migrimit.

## 2.3 Numri i të punësuarve, i të pa punësuarve dhe i pensionistve

Neve si Komunë kemi një bashkëpunim të mirë me Zyrën Komunale për punësim dhe Qendrën për punë sociale, prandaj të dhënat e marrura nga këto dy qendra do ti paraqesim në formë tabelare.

Nr.	Numri i të punësuarve	Nr.i të papunësuarve	Nr.i pensionistve
1	8543	22484	4357
<b>Gjithësejt.</b>	8543	22484	4357

## 2.4 Vendbanimet e Komunës së Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë përbëhet prej 67 vendbanimeve me 64 zona kadastrale, ku prej tyre: 64 fshatra, 1 qendre urbane, me gjithësejt 15,485 objekte të banimit prej të cilave 3903 janë të pa banuara. Ndërsa objekte banimi mbi 12 m. janë përafërsisht 90.


Distanca e fshatrave nga qyteti i Vushtrrisë është prej 3-21 km.

### EMËRTIMET E VENDBANIMEVE , DISTANCA NË KILOMETRA NGA QYTETI NË FSHATRA DHE NUMRI I EKONOMIVE FAMILJARE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

Nr.	Zona	Distanca në Km nga Qyeti	Banorë	Ekonomi Familjare Rezidente	Ekonomi Familjare Jo-rezidente	Biznese Aktive	Biznese jo-aktive	Institucione
1	Akrashticë	7 km	1113	234	46			2
2	Balincë	7 km	323	66	7	1	1	1
3	Banjskë	5 km	891	247	52	4	1	5
4	Beçiq	14 km	227	33	27	1		3
5	Beçuk	19 km	487	67	58	1		2
6	Begaj	3 km	1261	269	21	2	1	
7	Bivolak	17 km	730	115	50			1
8	Boshlan				6			
9	Brusnik	8 km	404	83	11			1
10	Bukosh	5 km	1171	243	21	3	1	4
11	Ceceli	14 km	357	61	31			3
12	Dalak	4 km	786	166	22	2		
13	Dobërrlluk	4 km	1629	365	79	17	8	1
14	Druar	9 km	965	180	41	1	2	2
15	Duboc	12 km	493	73	55			2
16	Dumnicë e Eperme	15 km	284	30	38			1
17	Dumnicë e Llugës	12 km	656	129	20		1	3
18	Dumnicë e Poshtme	9 km	1371	243	42	7	2	2
19	Galicë	14 km	234	51	17			1
20	Gllavatin	16 km	391	81	14			3
21	Gojbulë	4 km	588	242	57	1	3	2
22	Gracë	13 km	424	213	11	8		2
23	Gumnishtë	18 km	65	1	47			
24	Hercegovë	10 km	423	101	6			
25	Karaqë	7 km	192	23	15			
26	Kollë	8 km	554	84	25			
27	Kunovikë	19 km	13	1	3			
28	Kurillovë	19 km	14	2	9		2	1
29	Liqej	7 km	318	72	4			
30	Lumadh	10 km	404	117	36	7	5	3
31	Mariq	5 km	404					
32	Maxhunaj	7 km	2035	531	64	8	6	6
33	Mihaliq	12 km	1241	285	19	2		
34	Miraqë	5 km	10	1	4			
35	Nedakovc	4 km	268	53	9	3		
36	Novolan	6 km	1366	285	60	5		3
37	Oshlan	11 km	488	116	16	1	1	1

38	Pantinë	7 km	1422	314	52	2	1	5
39	Pasomë	8 km	744	140	26	2		3
40	Pestovë	6 km	842	263	18	8	6	2
41	Prelluzhë	14 km	558	692	179	4	23	6
42	Reznik	8 km	1366	266	75	3	3	2
43	Ropicë	9 km	763	144	12			1
44	Samadrexhë	11 km	1321	297	47		2	1
45	Svaraçak i epërm	6 km	353					
46	Sfraçak i Poshtëm	4 km	522	158	41	8	2	1
47	Shalë	12 km	541	85	30		3	1
48	Shlivovicë	9 km	14	2	14		1	
49	Shtitaricë	4 km	788	179	19	1		2
50	Skoqan	11 km	5		3			
51	Skromë	13 km	114	11	15	2		3
52	Sllakovcë	17 km	263	41	12		1	
53	Sllatinë	4 km	491	140	33		1	1
54	Smrekonicë	6 km	1646	384	59	3		5
55	Stanoc i Epërm	11 km	2051	559	51	21		4
56	Stanoc i Poshtëm	12 km	1736	365	63	19	13	2
57	Stroc	9 km	865	128	63	1		
58	Studime e Eperme	9 km	335	62	18			2
59	Studime e Poshtme	4 km	777	169	34			2
60	Taraxhë	7 km	54	7	2			
61	Tërllabuq	7 km	125	10	17			
62	Vemicë	6 km	612	131	24			2
63	Vesekovc	21 km	40	2	10			
64	Vilancë	8 km	387	63	12	1		1
65	Zagorë				3			
66	Zhilivodë	21 km	18	61	48			1
67	Vushtrri		496					
Totali				9648	2181	149	90	102

Harta.5. Vendbanimet dhe shtrirja e popullsisë në Komunën e Vushtrrisë.



Komuna ka një shpërndarje natyrore të vendbanimeve. Shumica e vendbanimeve gjenden në rrafshinë dhe janë zhvilluar përgjatë akseve rrugore çka e pengon zhvillimin e mëtutjeshëm. Vushtria është qendër lidhëse i të gjitha vendbanimeve komunale.

Nuk ka vendbanime të pa depërtueshme për shkak të kushteve topografike vetëm në rastet e vërshimeve apo borës .

### **3. Të mirat materiale kulturore dhe të ambientit**

#### **3.1. Vlerat e Trashëgimisë Kulturore**

Vushtria karakterizohet me trashëgimi me vlera të larta kulturore Kalaja, Ura e vjetër e Gurit, Hamami, shumë Xhamia si dhe kullat dhe lokalitetet arkeologjike të cilat për fat të keq nuk janë mbrojtur ligjërisht,të cilat po i paraqesim në form tabelare.

#### **1949**

1. VUSHTRRI -KËSHTJELLA “KALAJA” KULLA E VJETËR, **Shek. XIV,Nr.v. E.K. 858/49**

2.VUSHTRRI -URA E VJETËR E GURIT **Shek. XIV-XVI, Nr.v. E.K. 859/49 1955**

3. VUSHTRRI -PËRMENDORE MBIVARRORE (NISHAN) E MUSTAF BEUT NË XHAMINË E GAZI ALI BEUT, **1538 (sipas Hixhrit 958) Nr.v. E.K.641/55**

4. VUSHTRRI -SHTËPIA E BADIVUKIT NË rr. B. Kidriçit, nr. 62-64, **Shek. XIX. Nr.v. E.K. 1097/55**

5. VUSHTRRI -SHTËPIA - rr. B.Kidriçit, nr.46 **Shek. XIX, Nr.v. E.K. 1098/55**

6. VUSHTRRI -SHTËPIJA E QAMILILOVIÇIT - rr. e Maçvanska, nr.33, **Shek. XIX, Nr.v. E.K. 1099/55**

#### **1964**

7. SAMADREXHË -KISHA SAMADREXHË-KISHA E Shën LLAZARIT, **shek. XIV, e Renovuar 1932, nr.v. E.K. 02-381/64**

#### **1965**

8. GOJBULË -MBETURINAT E KISHËS SË SHËN PREMTES, **shek.XVI, Nr.v. E.K.02-593/64**

#### **1966**

9. VUSHTRRI -XHAMIA E GAZI ALI BEUT, **(1444) Nr.v. E.K. 02-985/66**

#### **1967**

10. VELIKA REKË -**SHPATË MESJETARE**, PRONË E MILLOMIR BOGOVCIT, **1389 Nr.v. E.K. 201/67**

#### **1968**

11. VUSHTRRI - HAMAMI I VJETËR, **shek. XV, Nr.v. E.K. 02-628/68**

#### **1970**

12. DUBOC -MBETURINAT MESJETARE TË KOMPLEKSIT NË KODRËN ÇEÇAN



**Shek. V-VI, Nr.v. E.K. 371/701971**

**13. STANOVC I POSHTËM -MBETURINAT E LOKALITETIT ANTIK NË POTEZIN “LIGATA”, Shek. III-IV, Nr.v.E.K. 236/71**

**14. BANJICË -LOKALITET ARKEOLOGJIK, “SELISHTE” –ÇERMINIÇ”,  
PARAHISTORI DHE ANTIKË, Nr.v.E.K. 23/71**

**15. NOVOSELLË -LOKALITET ARKEOLOGJIK, “GORNJI JORGOVAN”,  
Shek. X-XV, Nr.v. E.K. 236/71**

**16. SAMADREXHË -“QYTEZA” (“GRADINA”–vr B.V.) Shek. II-XIV, nr.v. E.K. 249/71**

**1988**

**17. STROFC -“QYTEZA” PARAHISTORI ANTIKE DHE MESJETË, Nr.v. E.K.0301-133/8818. VRNICË -LOKALITET ARKEOLOGJIK NË POTEZIN “SELISHTE ” –TË SHTËPIA**



*Palestra sportive ne Vushtrri*



URA E GURIT



BANTO PUB LIKE (Hamam i)



**KALAJA**

Kalaja e Vushtrisë

Foto: Mirdita Xhonjari, 2001



*Kulla e Azem Bejtë Galicës në Galicë*



*Shtëpia e Mahmut Agë Gjinollit në Vushtrri*



*Shtëpi e vjetër qytetare në Vushtrri*

### 3.2.Trashëgimia Natyrore

Komuna Vushtrrisë është e pasur edhe me trashigimin natyrore,që paraqet një vlerë shumë të çmueshme për këtë trevë,të cilat po ë paraqesim në formë tabelare.

- Malet e pjesës verilindore të Komunës duke filluar nga Gërdeqi e deri në Vesekovc.
- Malet e Qyqavicës në përendim.
- Fushat pjellore të cilat përfshihen në tër hapsirën e pjesës qëndrore të Komunës.

### 3.3. Parqet nacionale,parqet natyrore rezervatet dhe sipërfaqet pujore

Komuna Vvushtrrisë nuk posedon me parqe nacionale,parqe natyrore dhe rezervate që janë të emertuara nga niveli qndëror apo Kuvendi i komunës ndërsa është e begtshme me sipërfaqe të maleve dhe pyje të mbuluara me drunj ahisht, bung dhe lloje tjera që paraqet një bukuri të rrall, ku në të ardhëmen me një zhvillim ekonomik mund të shërbejn si parqe ntyrore dhe nacionale. Malet më të theksuar në Komunë janë vargmalet e Kopaonikut, Gërdeqit, Qyqavicës.

Tab. 8 Shfrytëzimi i tokës në komunë

Nr.Rendor	Shfrytëzimi i tokës	Sipërfaqja (ha)
1	Shtëpi – ndërtesa	77,81
2	Oborre	295,09
3	Hekurudhë	38,61
4	Rrugë	0,10
5	Rrugë private	2,91
6	Lumë	697,77
7	Përrua	18,22
8	Jaz	1,76
9	Kanal	0,18
10	Madem Guri	0,28
11	Varrezë	62,41
12	Xhami	0,07
13	Shkollë	0,01
14	Pishinë	0,13
15	Greminë	13,61
16	Gurishte	27,23
17	Kanal-Transhe	0,12
18	Mulli uji	0,02
19	Jopjellore	87,84
20	Rrugë e pakategorizuar	964,16
21	Aeroport	5,14
22	Ara	16 022,15
23	Kopsht	45,49
24	Pemishte	630,13
25	Vreshta	27,63
26	Livadhe	1 447,03
27	Kulloso	3 583,28
28	Male	10 431,27
<b>GJITHSEJT:</b>		<b>34 480,43</b>

### 3.4. Objektet për furnizim me ujë

Qytetarët e komunës së Vushtrrisë furnizohen me ujë të pijshëm nga Fabrika e Ujit e Ndërtuar në fsh. Balinc me kapacitet prej 450 m kub uji në sekond. Prej kësaj fabrike vjen në Vushtri në një rezervar me vëllim 10.000 m<sup>3</sup>,si dhe në rezervarët tjerë ndimës si ai në Taragjë dhe Bequk prej nga bëhet shpërndarja në tërë qytetin dhe shumicën e fshatrave të Komunës së Vushtrrisë me përjashtim të atyre me lartësi më të madhe mesatare për të cilat Komuna është në proces të rregullimit të sistemit të pompimit të cilat do të mundësojnë furnizimin me uji të të gjitha fshatrave.Si alternativë pjesa më e madhe e fshatrave rurale me ujë të pishëm furnizohet nga pusët (bunarët).. Numri i puseve në teritorin e komunës është përafërsisht 5700 në disa raste uji në këto puse është i pa pishëm. Për destinim për shuarjen e zjarrit përdoren edhe lumejtë Silnica dhe LLabi si dhe një numër hidrantesh që gjinden në qytet, ku janë 8 të vendosur dhe ato në:

- 1.Rr. "Dëshmorët e Kombit" (Afër kryqëzimit me rr "Tiranës"
- 1.Rr. "Dëshmorët e Kombit" (Afër kryqëzimit me rr" Mit Sokoli"
- 1.Rr. "Ismajl Qemali " (në kryqëzimin me rr "Marin Barleti")
- 1.Rr." Ismajl Qemali" (në kryqëzimin me Rr " Hagji Zekën")
- 1.Rr "Mic Sokoli " (afër objektit mbi vakëfit)
- 1.Rr "Tiranës (kryqëzimi me rr "V. Gërvalla" te Xhamia)
- 1.Rr. "Jeton Tërstena" Kryqëzimin me Rr"Faruk Beqiri")
- 1.Rr."Wesley Clark" (në hyrje të objektit të ujësjellësit)

Pompa e ujit me kapacitet të lartë nga pusi  
 1.Rr. "Hamit Hyseni"-( Objekti i ujësjellësit)

### VENDBANIMET ME KYQJE NË SISTEMIN E UJËSJELLËSIT.

V E N D B A N I M I	Numri i banorëve	% e qasjes në rrjetin e ujësjellës	Sistemi i ujësjellësit
1. Akrahticë	1.574	100%	UR Mitrovica
2. Banjskë	903	85%	"
3. Begaj	1.600	100%	"
4. Dalak	984	70%	"
5. Dobërllukë	2.350	100%	"
6. Dunica e Poshtme	1.821	8%	"
7. Gojbulë	516	95%	"
8. Gracë	280	Mungon rrjeti	
9. Lumadh	1.625	90%	
10. Mavriq	165	100%	
11. Maxhunaj	1.869	95%	
12. Nedakoc	880	100%	
13. Pantinë	2.431	100%	
14. Pestovë	1.570	10%	
15. Prelluzhë PR.	2.100	100%	
16. Sfaraqak i Poshtëm	1.080	95%	

17. Shtitaricë	1.260	100%	
18. Sllatinë	340	35%	
19. Smrekonicë	2.220	100%	
20. Studime e Poshtme	2.265	100%	
21. Stanoc i Epërm	2.175	40%	
22. Stanoc i Poshtëm	2.400	10% Prishtinë	UR. Prishtina
23. Vushtrri	39.890	100%	UR. Mitrovica
24. Prelluzhë	2.100	100% Prishtinë	UR. Prishtina
25. Bukosh	1.171	100 %	
16. Navalan	1.932	100%	
17. Reznik	1.366	100 %	
18. Bruznik	404	100 %	
19. Vërnice	612	100 %	
20. Mihaliq	1.242	83 %	
21. Druarë	965	87 %	
22. Pestovë	842	100 %	
23. Vilanc	387	100 %	
24. Ropicë	763	100 %	
25. Samadrerxhë	1.321	95 %	
26. Bajskë	763	100 %	
27. Dubovc	493	85 %	
28. Galicë	234	90 %	
29. Dumnicë e poshtme	1379	100 %	
30. Dumnicë e Llugës	656	95%	
<b>Gjithësejtë:</b>	<b>88.929</b>		

### 3.5. Zonat për prodhimtari bujqësore

Komuna e Vushtrrisë ka sipërfaqe prej 17,360 ha tokë bujqësore. Nën sistemin e ujitjes janë 5000 ha nëpërmesë masës së komosacionit si potencial i prodhimtarisë bujqësore.

Zonat për prodhime bujqësore në teritorin e komunës janë gjitha fshatratë dhe qyteti që gjenden në rrafshin e luginës së Silnicës këto janë; fh. Stanovci i ultë, Lumi i madh, Mihaliq, Pestovë, Druar, Mavriq, Nedakovc Vushtrri, Dobrllukë, Pantinë. Popullata në të gjitha këto fshatra dhe në qytet kryesisht merën me bujqësi. Kulturat e preferura që japin rendimente më të larta janë patatja, lakra, gruri dhe të gjitha perime tjera. Disa prodhues për punimin e tokës përdorin teknologjin bashkohore prandaj kanë edhe rendimente të larta, sidomos janë të njohura prodhimet e patates në komunë. Në fshatin Pestovë është ndërtuar një fabrikë “Vipa Qips” për punimin e patates e cila prodhon disa produkte të patatesë.

Në zonat rurale ku shumica e familjeve posedojnë sipërfaqe të tokës me parcela të vogla në disa raste pamundësojnë zbatimin e teknologjisë moderne në prodhimtarinë bujqësore. Edhe në këto fshatra rurale kultivohen të gjitha drithërat dhe perimet. Toka pjellore në dekadë e fundit po nxinet me objekte banimi dhe biznesit, pompa dhe rezervare për karburante gjë që po zvoglohet fondi i tokës bujqësore.

### Struktura e shfrytëzimit të kapacitetit tokësor në Ha

- Ara- kopshte 12.300 ha
- Pemishte 56 ha
- Vreshta 5 ha
- Livadhe 1500 ha
- Kullosa 3.500


### Gjithsejt tokë bujqësore në komunë janë 17.360

Në teritorin e Komunës së Vushtrrisë bazë të projektit strategjik zhvillimor urban është detajizuara një zonë industriale dhe atë;

Zona shtrihet në aksin rrugor Vushtrri-Mitrovicë në fsh. Sllatinë me një sipërfaqe prej 6 ha, për momentin është pa urbanizuar.

Kushtet klimatike janë mjaft të përshtatshme, ku në këtë rajon ka një klimë të mesme kontinentale me dimra të ftohët dhe verë të ngrohtë. Temperatura mesatare vjetore është 11,2°C. Muaji më i ftohët është janari me 9,0 °C, kurse muaji më i ngrohtë është korriku më 22.6 °C. Sasia mesatare e të reshurave është afër 670 mm, kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV-IX) afër 330 mm. Lartësia mbidetare është prej 500-700m, ku rreth 50% të sipërfaqes gjendet në lartësinë mbidetare mbi 700m, e cila lartësi ofron kultivimin e disa kulturave.

Harta nr.7.Harta e Vushtrri që tregon zonat e tokës bujqësore



## 4. Numri i Zonave dhe objekteve Industriale

### 4.1 Lokacionet e zonave dhe objekteve industriale në raport me vendbanimin

Bartëse kryesore e zhvillimit të ekonomisë së Komunës së Vushtrisë ka qenë industria (në veçanti Fabrika për prodhimin e e llamarinës “Llamkos”, e cila pas fazës së privatizimit aktualisht është jashtë funksionit. Por pas mbarimit të luftës janë krijuar Ndërrmarje të reja me kapacitete prodhuese e tregëtare të cilat kanë shënuar rritje të zhvillimit ekonomik por edhe punësime të punëtorve të shumtë.

Një numër i konsideruar i Ndërrmarjeve të reja janë krijuar nga Ish Ndërrmarjet Shoqërore të privatizuara të cilat tani punojnë nën menagjimin e sektorit privat.

Në vazhdim paraqitet tabela e subjekteve më të mdhaja ekonomike në Komunën e Vushtrisë:

<b>Emri i subjektit afarist</b>	<b>Lokacioni</b>	
Fabrika “Vipa Qips”	<b>Vushtrri</b>	
Fabrika “Extra”	<b>Vushtrri</b>	
“Ujësjiellësi”	<b>Vushtrri</b>	
“Uniteti”	<b>Vushtrri</b>	
NP”Emona”SHPK	<b>Vushtrri</b>	
“EMONA Centar”	<b>Vushtrri</b>	
INTEREX	<b>Vushtrri</b>	
ETC	<b>Vushtrri</b>	
NT”UNION”	<b>Vushtrri</b>	
Arjani Compani	<b>Vushtrri</b>	
Qendra Tregtare ETC	<b>Vushtrri</b>	
QT “Viva Fresh Store”	<b>Vushtrri</b>	
NP “QAO BERTO”	<b>Vushtrri</b>	
NP”BINI”	<b>Stanovc</b>	
NP”ALBED”	<b>Vushtrri</b>	
Mulliri”BARILEVA”	<b>Stanovc</b>	
Mulliri”MOLITORIJA”	<b>Nevoln</b>	
NDËRRMARJA KOMUNAKLE PËRPARIMI	<b>Vushtrri</b>	


Tab. 1 Subjektet ekonomike në komunën e Vushtrisë

Në vitin 2010 ka filluar punën Tregu i ri që ka rreth 100 lokale tregëtare- zejtare e që ka punësuar rreth 150 punëtor.

Komuna ka realizuar këtë projekt në partneritet me biznesin privat e cila ka mundur infrastrukturën ligjore për realizimin e këtij projekti.

Po ashtu Komuna ka zhvilluar të gjitha procedurat ligjore për funksionalizimin e parkut të Biznesit në Lumëmadh e cila do të ndërthet në vete rreth 32 biznese.





#### 4.2.1 Strehimoret për strehim të përkohshëm

Në komunën e Vushtrrisë gjenden disa strehimore me dalje të veqantë për raste emergjente mirëpo disa prej tyre pas procesit të privatizimit të disa Ndërmarrjeve Shoqërore iu është ndërruar destinimi .Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, i ka paraparë këto objekte të përkohëshme për strehim emergjentë si në tabelen e më poshtme

#### STREHIMORET KOLEKTIVE ME DALJE JASHTË OBJEKTIT

Objekti ku ndodhet Strehimorja	Lokacioni	Vendi	Vërejtje
Banesat e Kuqe	Rr “ Wesli Clark”	Vushtrri	
SHMU “ ÇAJUPI”	Rr “ Bahri Kuçi”	Vushtrri	
Ish fabrika e tekstit POLET	Rr “Ajet Gërguri”	Vushtrri	
LLAMKOSI	Rr “ Tahir Sinani”	Vushtrri	
Ish shtëpia e Mallrave	Rr “Adem Jashari”	Vushtrri	Jo funksionale

#### SALLAT E MDHAJA PER STREHIM TE PERKOHËSHËM

Objekti ku ndodhet salla	Lokacioni	Vendi	Vërejtje
Salla JETON TËRSTENA	Rr “Tahir Sinani”	Vushtrri	
Gjimnazi “Eqrem Qabej”	Rr “Ajet Gërguri”	Vushtrri	
SHMT “ Lutfi Musiqi”	Rr “Krujës”	Vushtrri	
SHMU “ QAJUPI”	Rr “ Bahri Kuçi”	Vushtrri	
Salla e sporteve		Samadrexhë	
Salla e Edukatës Fizike në SHMU1	Rr.”Dëshmorët e Kombit	Vushtrri	Para funksionalizimit
Salla e ed. Fizike në SHMU2		Vushtrri	ndërtim e sipër

Për momentin të gjitha strehimoret publike janë jashtë përdorimit edhe pse destinimi i tyre është i dyfishtë, tani këto strehimore përdoren për nevoja të ndryshme të bizneseve. Për strehim të qytetarve mund të përdoren edhe strehimore bodrumet e banesave që mund të strehohen 50 familje me gjithsejtë 350 antarë.

Qytetarët e Vushtrrisë në raste emergjente mund të përdorin çdo bodrum apo ndonjë vend që ofron kushte për strehim në objekte afariste në të cilat egzistojn kushte minimale për strehim (fjala është për objekte me bodrum).

Veç kësajë është paraparë edhe evakuimi dhe strehimi i banorëve në raste të veçanta dhe vendosja e tyre në objekte të sigurta si Shkolla, Depo dhe tenda të cilat do të vendosen në hapsirat e përshtatshme për strehim.

#### **g. Kapacitetet për ofrimin e ndihmës për strehim.**



Kapacitetet për ofrimin e ndihmës për strehim të qytetarëve të komunës në raste emergjente janë të pamjaftueshëm, nisur nga fakti se numri i banorëve që jetojnë sidomos në qytet është i madhë me objekte e dedikuar për strehim.

Numri i lokaleve privat për përgaditjen dhe furnizimin me ushqim në kushte normale është i mjaftueshëm, kurse për raste emergjente do të duhej me vendim të posaqëm të Drejtorisë për ekonomi dhe financa të caktohen ndërmarrjet për furnizim dhe përgaditje të ushqimit për qytetarët që do të jenë të rezikuar nga fatkeqësit natyrore. Ndërsa tendat do të vendosen në oborret e ish fabrikës "Polet" "Extra" dhe oborret e disa shkollave si

oborri iShkollës së Mesme Teknike, Shkollës fillore “Mustafë Venhari”, “Ali Kelmendi”, dhe në pjesë tjera të qytetit dhe në fshatra sipasë nevojës .

## 5.Kapacitetet Mjekësore Publike dhe private

Klasifikimi i personelit shëndetësor dhe hapësira në QKMF,QMF,AMF dhe Spitalin „SHEIK ZAYED“do të prezantohet në shtojcat nr. 2,3,4,5,6 dhe7 qe jan pjesë përbërëse e këtij Vlerësimi.

( Tabela 2 ). Punktet e Mjeksisë Familjare

Nr	Punktet e mjekësisë familjare	Numri i punëtoreve
1	Smrekovnicë	1 Mjek 2 Infermier
2	Lum Madh	1 Mjek 4 Infermier
3	Pantin	1 Mjek 2 Infermier
4	Dunicë	1 Mjek 1 Infermier
5	Druar	1 Mjek 1 Infermier
6	Nevolan	1 Mjek 1 Infermier
7	Maxhunaj	1 Mjek 1 Infermier
8	Dubocë	1 Mjek në Duboc dhe Beqiq 1 Infermier
9	Strofcë	1 Mjek 1 Infermier
10	Ashlan	1 Mjek 2 Infermier
11	Samodrezhë	1 Mjek 2 Infermier
12	Skromë	Mjeku dhe Infermierja vijn nga Emergjencia e Vushtrrisë
13	Pasomë	Mjeku vjen nga Smrekonica 1 infermier
14	Ceceli	Mjeku vjen nga Samadrexha 1 infermier
15	Beçiç	1 Mjek në Duboc dhe Beqiq 1 Infermier
16	Zhilivodë	1 Mjek nga Ministria e Shënd. 1 Infermier

(Tab.nr 3.)Profilet mjekësore

Nr	Profili mjeksor	Numri I përgjithshëm
1	Mjek stomatolog	5
2	Mjek në specializim	1
3	Specialistë tjerë	2
4	Mjek i mjekësisë familjare	16

5	Specialist mjekësisë familjare	19
6	Infermier	111
7	Mami	5
8	Teknik dhe asistent të dhëmbëve	3
9	Teknik të rëntgenit	5
10	Punëtorë administrate	10
11	SISH	2
12	Teknik Laborant	6
13	Punëtor Teknik	11
14	Shoferët	8
	Gjithësej	204

**(Tab.4.) Punëtorët sipas njësive organizative. QKMF**

<b>Njësia punues</b>	<b>Numri i punëtoreve</b>	<b>Mjek</b>	<b>Infermier</b>
Stafi udhëheqës	2	1	1
mjekësia Familjare	33	14	19
Recepioni	22	-	22
Emergjenca	26	8	18
Vaksinimi	9	1	8
Stomatologjia	12	6	6
Laboratori	7	1	6
Radiologji	7	-	7
Intervenca	8	-	8
Lidhtorja	4	-	4
Barnatorja	1	-	1
Depoja farmaceutike	1	-	1
Dhoma e Infuzioneve	4	-	4
Këshillimorja	1	-	1
Edukimi I Vazdueshëm	5	1	4
Gjithsej	142	32	110

(Tab.5.) Punëtorët sipas njësisë organizative jo medicina.

Njësia punues	Numri i punëtorëve	Me fakultet	Me shkollë të mesme
Administrata	10	2	8
SISH-ë	2	-	2
Vozitës	8	-	8
Higjiena	7	-	7
Shërbim teknik	4	-	4
Gjithësejtë	31	2	26

(Tab. Nr. 6.) Spitali “Sheik Zayed” Vushtrri

Nr.	Emërtimi dhe lokacioni	Gjithsejtë Punëtor	Vërejtje
1.	Spitali “Sheik Zayed” Vushtrri	130	Mjek spec 24 Tek. Medicinal 94 Tek. Jo medi. 12

(Tab.7) QKMF,QMF,AMF Vushtrri

Nr	Emri dhe lokacioni	Nr.punëtorve	Vërejtje
1	QKMF .Vushtrri	50	Punohet në dy ndërrime
2	QMF1. Vushtrri	123	Dy ndërrime, Emergjencia 2 ndërrime
3	QMF .Smrekonicë	3	Me një ndërrim
4	QMF .Lum Madh	5	Mjeku për çdo ditë
5	QMF .Pantinë	3	Mjeku 3 herë në javë
6	QMF .Dumnicë	2	Mjeku për çdo ditë
7	QMF .Druar	2	Mjeku për çdo ditë
8	QMF .Novolan	2	Mjeku 2 herë në javë
9	QMF .Maxhunaj	2	Mjeku për çdo ditë
10	AMF .Dubovcë	2	Mjeku 2 herë në javë
11	AMF .Beqiç	0	Mjeku 3 herë në javë
12	AMF. Ashlan	2	Mjeku 2 herë në javë
13	AMF .Pasomë	1	Mjeku 2 herë në javë
14	AMF .Samadrexhë	3	Mjeku 3 herë në javë
15	AMF. Ceceli	1	Mjeku 2 herë në javë
16	AMF .Strofc	2	Mjeku për çdo ditë
17	AMF .Skromë	0	Mjeku 2 herë në javë
18	AMF .Zhilivodë	1	Mjeku 1 herë në javë
19	QKMF (Afër Tregut)		Në ndërtim e sipër
<b>Gjithsejtë :</b>		<b>204</b>	

**(Tab. 8) ORDINANCAT PRIVATE**

<b>Emertimi i Ordinancës</b>	<b>Lokacioni</b>	<b>Vendi</b>	<b>Pronari</b>	<b>Nr. Kontaktues</b>
<b>OD “ Diagnostika”</b>	Rr. “ Gjergj Kastrioti”	Vushtrri	Dr Bastri Sejdiu	
<b>OP “ Foshnja”</b>	Rr . “Isa Boletini”	Vushtrri	Dr Ramadon Xhoni	
<b>OS “ Alba Med”</b>	Rr “ Ismajl Qemajli”	Vushtrri	Sabri Tmava	
<b>ORU “Dioni”</b>	Rr “Bedri Pejani”	Vushtrri	Fazli Jetullahu	044/235 034
<b>OM “ Fundeni”</b>	Rr “Gjon Buzuku”	Vushtrri	Sabri Hyseni	
<b>Or d. Reumatologjike</b>	Rr “ Ismajl Qemajli”	Vushtrri	Bajram Ademi	044/360 131
<b>O S “ Sara Dent”</b>	Rr “ Tiranës”	Vushtrri	Gëzim Meniqi	
<b>Advanced Dental Clinic</b>	Rr “ Faruk Beqiri”	Vushtrri	Azem Osmani	
<b>OBS GYN</b>	Rr “ Tiranës”	Vushtrri	Maliqe Feka	
<b>LATA Dent</b>	Rr. “Kadri Zeka “	Vushtrri	Latif Shaqiri	
<b>OP “ Diabeti”</b>	Rr “ Faruk Beqiri”	Vushtrri	Rasim Hyseni	044/ 196 794
<b>OSO “ EMIRA”</b>	Rr “Bedri Pejani”	Vushtrri	Ismet Klinaku	
<b>Orto Gjyshinca</b>	Rr. “ Ismajl Qemajli”	Vushtrri	Bahri Gjyshinca	044/198 888
<b>OKULUS</b>	Rr. “ Ismajl Qemajli”	Vushtrri	Muhamet Zekolli	
<b>O K”Qëndresa”</b>	Rr “ Vllezërit Frashëri”	Vushtrri	Faik Bllata	044/ 147 829
<b>Oo.GJ.O.’Merita”</b>	Sheshi i Lirisë	Vushtrri	Emine Qerkezi	
<b>O.S.” Listeri”</b>	Rr “Krujës”	Vushtrri	Isak Berisha	
<b>O.Gj.O. “Drita”</b>	Fshati Stanovc	Stanovc	Nysret Haradinaj	
<b>O.S.I.K. Ritm iZemres”</b>	Rr “Shehshi i Lirisë”	Vushtrri	Bedri Zahiti	
<b>Laboratori BKD Lab</b>	Rr. “ Gjergj Kastrioti”	Vushtrri	Behkam Barja	
<b>Lab. LIBOHEM</b>	Rr “ Pandeli Sotiri”	Vushtrri	Ibrahim Avdyli	
<b>O.S.GJ. “ OBS-GYN”</b>	Rr “ Tiranës”	Vushtrri	Blerim Feka	
<b>Ord.Radiologjike</b>	Rr “ Tiranës”	Vushtrri	Hysni Gërguri	044/179 790
<b>O.S.GJ.”Nëna”</b>	Rr. “ Gjergj Kastrioti”	Vushtrri	Agim Zahiti	
<b>O.S.GJ “Gjinekologjia”</b>	Rr “Bedri Pejani”	Vushtrri	Bajram Drevinja	

## 6. Infrastruktura shkollore

Procesi edukativo arsimor në Komunën e Vushtrrisë zhvillohet në të gjitha nivelet, prej atij para fillor e deri të ai parauniversitar

Institucionet arsimore:

- 2 Çerdhe me 152 fëmijë
- 32 shkolla fillore me 9.545 nxënës;
- 3 shkolla të mesme me 2.679 nxënës;

Gjendja e tashme:

Edukatore	Fëmijë që janë në Qerdhe	Personeli administrativ		Personeli ndihmës		Gjithsej personel	
Numri		Numri		Numri		Numri	
22	152	7		10		39	

Tabela Numri i shkollave fillore, nxënësit dhe proporcioni nxënës/shkollë në arsimin e obligueshëm

Numri i shkollave	Numri i nxënësve	Proporcioni nxënës/shkollë
A 32	9.545	

Tabela Personeli arsimor në arsimin e obligueshëm sipas pozitës (klasat 1-9) 2008/9

Mësimdhënësit		Personeli administrativ		Personeli ndihmës		Gjithsej personel arsimor	
Numri		Numri		Numri		Numri	
705		62		124		891	

Tabela Numri i shkollave të mesme, nxënësit dhe proporcioni nxënës/shkollë në arsimin e mesëm (klasat X-XII), 2013/2014

Numri i shkollave	Numri i nxënësve	Proporcioni nxënës/shkollë
A - 3	2679	

Tabela Personeli arsimor në arsimin e mesëm sipas pozitës (klasat X-XII) (X-XIII)

Mësimdhënësit		Personeli administrativ		Personeli ndihmës		Gjithsej personel arsimor	
I-IX	X-XIII	Numri		Numri		Numri	
	203	15		11		229	

Institucionet e arsimit të Vushtrrisë sigurojnë arsimim cilësor të gjitha niveleve, i cili do të jetë i pranueshëm për të gjitha moshat e nxënësve në mënyrë që individi ta shfrytëzojë tërë potencialin e vet intelektual në përparimin shkencor e teknologjik dhe socialo ekonomik të vendit.

## Pasqyra tabelare e shkollave fillore dhe të mesme

### Shkolla/ndërtesa edukimi

Nr.	Ndërtesa rruga / fshati	funkcioni / ndërteses	Viti i Ndertimit	Numri i Oreve te punës për dit	Iloji i ndertimit (përshkruaj shkrut)	Nr. i Personelit	Vërejtje
1	Qerdhja,,Foleja"-Vushtri	Ndërtesë për Parashkollore	1985	10	material i fortë	29	
2	Qerdhja për fëmij"-Vushtri	Ndërtesë për Parashkollore	2020	10	material i fortë	13	
3	SHFMU,,Abdyl Frashëri"- 'Druar,Vushtri	Ndërtesë Shkollore	1953	10	material i fortë	16	
4	SHFMU,,Adem Voca"- Sumë,Vushtri	Ndërtesë Shkollore	1981	10	material i fortë	32	
5	SHFMU,,Azem Bejta"- Duboc,Vushtri	Ndërtesë Shkollore	1981	10	material i fortë	15	
6	SHFMU,,Azem Bejta"- Besnik	Ndërtesë Shkollore	2000	10	material i fortë	15	
7	SHFMU,,Andon Zako Çajupi"-Vushtri	Ndërtesë Shkollore	1983	10	material i fortë	63	
8	SHFMU,,Andon Zako Çajupi"-Karaqë	Ndërtesë Shkollore	2000	4	material i fortë/drrasë, llamarin	0	Shkolla është mbyllur
9	SHFMU,,Andon Zako Çajupi"-Lajthizë	Ndërtesë Shkollore			material i fortë	0	mbyllur
10	SHFMU,,Bajram Curri- Dumnicë e Llugës,Vushtri	Ndërtesë Shkollore	2020	10	material i fortë	18	
11	SHFMU,,Bajram Curri- Dumnicë e Epërme	Ndërtesë Shkollore			material i fortë	2	
12	SHFMU,,Bahri Kuqi"- Shtruerë,Vushtri	Ndërtesë Shkollore	1984	10	material i fortë	20	
13	SHFMU,,Latif Berisha"- Doberllukë,Vushtri	Ndërtesë Shkollore	2000	10	material i fortë	21	
14	SHFMU,,Emin Duraku"- Novolan,Vushtri	Ndërtesë Shkollore	1949	10	material i fortë	19	
15	SHFMU,,Enver Hadri"- Smrekonicë,Vushtri	Ndërtesë Shkollore	1987	10	material i fortë	32	
16	SHFMU,,Gjergj Kastrioti Skenderbeu"- Pantinë,Vushtri	Ndërtesë Shkollore	2017	5	material i fortë	22	
17	SHFMU,,Jusuf Gërvalla"- Dumnicë e Poshtme,Vushtri	Ndërtesë Shkollore	1982	10	material i fortë	14	
18	SHFMU,,Liria"- Strofc,Vushtri	Ndërtesë Shkollore	1973	10	material i fortë	22	
19	SHFMU,,Liria"-Beçuk	Ndërtesë Shkollore	2018	10	material i fortë	0	mbyllur




20	SHFMU,,Liria"-Gurakuq	Ndërtesë Shkollore	1947	10	material i fortë	5	
21	SHFMU,,Liria"-Bivolak	Ndërtesë Shkollore	1993	10	material i fortë	6	
22	SHFMU,,Dëshmorët"-Zhilivod	Ndërtesë Shkollore	2012	10	material i fortë	15	
23	SHFMU,,Lumni Surdulli"-Samadrexhë,Vushtrri	Ndërtesë Shkollore	1974	10	material i fortë	21	
24	SHF-Lummadh- në Lummadh,Vushtrri	Ndërtesë Shkollore	2008	10	material i fortë	12	
